



# KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

## K R Y E T A R I

Adresa: Rruga Rruga "Abdi Toptani" Nr. 1 Tiranë. E-mail: [klsh.org.al](mailto:klsh.org.al); web-site [www.klsh.org.al](http://www.klsh.org.al)

Nr. 252 Prot.

Tiranë, më 31.12.2018

### V E N D I M

#### Nr.252, Datë 31.12.2018

#### PËR

#### AUDITIMIN E USHTRUAR NË “ALBPETROL SHA., PATOS, FIER”

#### ME OBJEKT

#### “PËRPUTHSHMËRIE DHE RREGULLSHMËRIE”

#### Për periudhën nga data 01.01.2017 deri më datën 31.07.2018

Nga auditimi i ushtruar në Albpetrol SHA Patos, Fier, rezultoi që veprimtaria ekonomike e financiare nuk përputhet në përgjithësi me kërkesat dhe kriteret e kuadrit rregullator në fuqi në drejtim të planifikimit, miratimit, monitorimit dhe zbatimit të buxhetit. Për periudhën objekt i auditimit u konstatuan të meta e dobësi me pasoja financiare në drejtim të procedurave të prokurimit dhe zbatimit të kontratave për punë publike, dhënien e aseteve me qira, ankandet për shitjen e naftës, si dhe monitorimin e Marrëveshjeve Hidrokarbure.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve me Financime të Huaja, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Drejtorisë së Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë së Auditimit, në mbështetje të nenit 10, 15, 25 dhe 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;

### V E N D O S A:

**I.** Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit me objekt “Auditim përputhshmërie dhe rregullshmërie” të ushtruar në Albpetrol SHA, Patos, Fier, sipas programit të auditimit të miratuar nga Kryetari i KLSH nr. 795/2 prot., datë 13.07.2018, për veprimtarinë nga data 01.01.2017 deri më datën 31.07.2018, me afat auditimi 16.07.2018-19.10.2018.

**II.** Të miratoj rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon:

## OPINIONI I AUDITIMIT

Baza për opinionin e auditimit mbi përputhshmërinë të veprimtarisë së shoqërisë Albpetrol SHA, është mbështetur në: ligjin nr. 154/2014, "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"; Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH-së; Standardet Ndërkombëtare të auditimit "ISSAI 400"; Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH. Nga auditimi mbi përputhshmërinë, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë nga shoqëria Albpetrol SHA të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), u evidentuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale konsistojnë:

Në drejtim të hartimit, ekzekutimit, monitorimit dhe raportimit jo në përputhje me ligjin "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", në drejtim të prokurimit publik jo në përputhje me ligjet që rregullojnë fushën e prokurimeve publike; ligjit "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve", ligjit "Për kërkimin, zhvillimin, prodhimin, trajtimin, transportin dhe shitjen e naftës bruto, gazit dhe rërave bituminoze brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, ligjit "Për ankandin publik", i ndryshuar.

Përgjegjësitë e menaxhimit të shoqërisë Albpetrol SHA janë:

Hartimi, ekzekutimi, monitorimi dhe raportimi i buxheteve të shoqërisë në përputhje me rregullat e statutit dhe rregullores; menaxhimi financiar dhe kontrolli i brendshëm publik në përputhje me rregullat për menaxhimin financiar dhe kontrollit, realizimi i prokurimeve publike në përputhje me rregullat e prokurimeve publike, hartimi dhe përmirësimi i rregullave dhe projekt-akteve ligjore e nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e Albpetrol SHA për përdorimin me ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve buxhetore. Si pasojë e keq menaxhimit janë evidentuar nga audituesit devijime dhe shkelje nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të rëndësishme materiale, ku ndër më kryesoret do të veçonim:

-Në fushën e monitorimit të marrëveshjeve hidrokarbure në vendburimet e naftës dhe gazit.

-Në zhvillimin e ankandëve për shitjen e naftës bruto dhe zbatimin e kontratave përkatëse.

- Në dhënien e aseteve me qera dhe ndjekjen e kontratave lidhur me subjekte të ndryshme.

-Në fushën e prokurimeve publike, kryesisht në përlllogaritjen e vlerës së fondit limit, në hartimin dhe miratimin e kërkesave për kualifikim, në vlerësimin e ofertave pjesëmarrëse, si dhe në zbatimin e kontratave të lidhura.

Përgjegjësitë e audituesit janë:

Grupi i auditimit ka kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik. Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin "Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Përputhshmërisë", pjesë e raportit tonë (faqja 4). Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura me siguri të arsyeshme, por nuk garantojmë që auditimi i kryer në përputhje me këto standarde mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Gjithashtu, besojmë se, dëshmitë dhe evidencat e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat e arsyeshme për arritjen në opinionin e auditimit.

### **Opinionin e auditimit:**

**Baza për konkluzionin/opinionin mbi përputhshmërinë (ISSAI 400<sup>1</sup> dhe 4100<sup>2</sup>):**

<sup>1</sup> ISSAI 400 (Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë) që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë.

<sup>2</sup> ISSAI 4100 "Udhëzimet për auditimin e përputhshmërisë për auditimet që kryhen veçmas nga auditimi i pasqyrave financiare"

Nga auditimi i përputhshmërisë, mbështetur në Standartet ndërkombëtare të auditimit, ISSAI 400, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH-së dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH-së, i kryer në subjektin Albpetrol SHA, u konstatuan devijime dhe shkelje nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të rëndësisë materiale për të cilën *japim opinion kundërshtues*.

## **A. MASA ORGANIZATIVE**

### **1. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi i mëparshëm i KLSH në Shoqërinë Albpetrol SHA., me shkresën nr. 576/44prot., datë 31.12.2017, janë përcjellë rekomandimet përkatëse, janë dhënë 4 propozime për ndryshime apo përmirësime ligjore, 27 masa organizative, 12 masa për shpërblim dëmi në shumën 501,700,000 lekë dhe 4 masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike në shumën 11,365,133 lekë.

Nga auditimi për zbatimin e tyre rezultoi:

Nga 4 propozime për ndryshime apo përmirësime ligjore asnjë masë nuk është zbatuar pasi nuk janë pranuar nga Shoqëria Albpetrol SHA., nga 27 masa organizative 5 rekomandime janë zbatuar, 20 rekomandime janë në proces dhe 2 rekomandime nuk janë zbatuar, nga 12 masa për shpërblim dëmi në shumën 501,700,000 lekë asnjë masë nuk është realizuar, dhe nga 4 masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike në shumën 11,365,133 lekë asnjë masë nuk është realizuar, edhe pse me shkresën nr. 1722/1 prot, datë 22.02.2018, nga Administratori i Shoqërisë Albpetrol SHA., Patos, ka dalë program masash për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit për veprimtarinë e vitit 2016, duke vepruar në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.

Veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi administratorin e shoqërisë z. K.B.(*Trajtuar më hollësisht në pikën 1, të Raportit Përfundimtar*).

### **Rekomandimi:**

Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë Albpetrol SHA, të analizojë në grup pune të veçantë shkaqet, arsyet për moszbatimin e rekomandimeve për përmirësimet ligjore, moszbatimin e rekomandimeve të masave organizative, të lëna nga auditimi i mëparshëm dhe të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore për arkëtimin e shumës 501,700,000 lekë në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi. Gjithashtu të analizohen shkaqet, arsyet për mos përdorimin me efektivitet dhe ekonomicitet të fondeve publike në shumën 11,365,133 lekë në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

**Brenda datës 30.01.2019**

### **2. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi i dokumentacionit të ankandit për shitjen e naftës bruto rezultoi se është lidhur kontrata nr.5384/13, datë 15.09.2017, me objekt “Shitje e produktit hidrokarbur “naftës bruto”, për sasinë 200,000 ton, e lidhur ndërmjet “Albpetrol” SHA, përfaqësuar nga Drejtori Teknik z. A.H. (autorizim përfaqësimi lëshuar nga E.P. ) dhe “ I.” SHA, përfaqësuar në këtë kontratë nga z. D.L., si fitues i ankandit. Kontrata është hartuar pa saktësuar uljen e kostove të transportit të mallit me llogaritjet sikurse janë parashikuar dhe përcaktuar në Dokumentet Standarte të Ankandit, të cilat duhet të zbriten në rastet kur nafta do të shitej në kushtet FOB

dhe në rastet kur shitja do të bëhet në pikat e lëvrimit të shoqërisë, pasi neni 2, pika 2.2, shprehet se: Në pikat e lëvrimit të Albpetrol SHA., çmimi i shitjes do të jetë 71% e çmimit të brent – 4USD/bbl + 0.11 USD/bbl, e cila ka sjellë si pasojë dëm ekonomik për buxhetin e shoqërisë i përcaktuar ky dëm në kapitullin B. Masa për shpërblim Dëmi (*Trajtuar më hollësisht në pikën 8, të Raportit Përfundimtar*).

Veprime këto për të cilat ngarkohet me përgjegjësi ish-Administratori i shoqërisë z. E.P. dhe ish-drejtori teknik z. A.H.

#### **Rekomandimi:**

Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Shoqëria Albpetrol SHA, të krijohet një grup pune i veçantë i cili të analizojë shkaqet, arsyet për hartimin dhe lidhjen e kontratës jo në përputhje me Dokumentet Standarde të Ankandit, dhe të merret masat e duhura administrative dhe ligjore për personat përgjegjës. Gjithashtu, në vijimësi në lidhje me procedurën e ankandeve, të veprohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për hartimin dhe lidhjen e kontratave.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

#### **3. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi i procedurave të blerjeve me vlera të vogla, konstatohet se në 3 raste janë kryer procedura të realizuara si raste emergjente, ndërkohë që duhet të kryeshin si blerje me vlera të vogla me procedurë normale, nëpërmjet sistemit të APP-së. Gjithashtu, janë kryer procedura të blerjeve me vlera të vogla ku konstatohet se, në dy raste janë bërë likuidimet pa u plotësuar me të gjithë dokumentacionin justifikues, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar e kontrollin”, i ndryshuar.

Veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi z.E.P. në cilësinë e nëpunësit autorizues, z. P.B. në cilësinë e nëpunësit zbatues dhe anëtarët e komisionit të blerjeve të vogla (*Trajtuar më hollësisht në pikën 6, të Raportit Përfundimtar*).

#### **Rekomandimi:**

Administratori i Shoqërisë, Drejtorja e Financës, Drejtorja e Prokurimeve, të marrë masa në të ardhmen që, procedurat e blerjeve me vlera të vogla, të cilat nuk janë procedura emergjente, të veprohet në përputhje me kuadrin rregullativ ligjor. Gjithashtu shpenzimet e kryera për këto praktika, të kryen pasi të jetë plotësuar i gjithë dokumentacioni i nevojshëm justifikues, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

#### **4. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi i listëpagesave të muajve mars-korrik 2018 rezultoi se, për vitin 2018 janë paguar dieta për trajtim ushqimor për të gjithë punonjësit në masën 500 lekë ndërkohë që, me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 68, datë 7.2.2018 “Për kufijtë dhe kriteret e përcaktimit të shpërblimit që i përgjigjet pagës së përfutur në natyrë dhe që i shtohet pagës për pushimet vjetore”, pika 2, gërma a), kjo dietë është caktuar në masën 300 lekë. Në lidhje me këtë VKM rezulton se, nga Drejtorja Juridike nuk është marrë asnjë iniciativë për implementimin dhe zbatimin e saj, si dhe vënien në dijeni të Administratorit dhe aparatit të shoqërisë, për përmirësimet ligjore, duke qenë një detyrë funksionale e kësaj drejtorie. Mos zbatimi i VKM nr. 68, ka sjellë shkelje të disiplinës financiare me pasojë dëm ekonomik (*Trajtuar më hollësisht në pikën 3, të Raportit Përfundimtar*).

### **Rekomandimi:**

**4.1.** Këshilli Mbikëqyrës dhe Shoqëria Albpétrol SHA, të marrë masat e duhura, për mos përditësimin e legjislacionit, dhe të ndiqen procedurat administrative për personat përgjegjës, bazuar në Kodin e Punës dhe Rregulloren e brendshme të Shoqërisë.

**4.2.** Administratori i Shoqërisë, Drejtoria Juridike të marrë masat e duhura dhe të kryejë ndryshimet përkatëse në kontratën kolektive, në përputhje me ndryshimet e bëra në zbatim të VKM nr. 68, datë 7.2.2018 “Për kufijtë dhe kriteret e përcaktimit të shpërblimit që i përgjigjet pagës së përfituar në natyrë dhe që i shtohet pagës për pushimet vjetore”

**Menjëherë dhe në vijimësi**

### **5. Gjetje nga auditimi:**

-Shoqëria “Albpétrol” SHA., në kundërshtim me nenet nr.5, 6, 8, 9, 10, 11 të VKM nr. 4, datë 19.06.2017, “Për miratimin e Rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë”, nuk ka kryer:

- ngritjen e komisionit të ekspertizës,
- aprovimin e afateve të ruajtjes së dokumenteve,
- përpunimin tekniko-shkencor të dokumenteve të prapambetura, si dhe përcaktimin e përkatësisë së fondit dhe klasifikimin e dokumenteve sipas fondit,
- ekspertizën e vlerës së ruajtjes si dhe afatin e ruajtjes së dokumentacionit,
- ruajtjen e dokumenteve në përputhje me normativat e përcaktuara, si dhe ato lidhur me temperaturën e ambientit dhe lagështirën.

Për sa më sipër mban përgjegjësi administratori e shoqërisë, z. K.B., ish-administratori z.E.P., dhe drejtori i burimeve njerëzore z. A.V. (*Trajtuar më hollësisht në pikën 14, të Raportit Përfundimtar*).

### **Rekomandimi:**

Administratori i shoqërisë Albpétrol SHA, të marrë të gjitha masat e duhura për ngritjen e komisionit të ekspertizës për materialet e arkivës, aprovimin e afateve të ruajtjes së dokumentave, përcaktimin e përkatësisë së fondit të arkivës dhe klasifikimin e dokumentave sipas fondit, si dhe plotësimin e kushteve normale për ruajtjen e dokumentave në mjediset përkatëse.

**Menjëherë**

### **6. Gjetje nga auditimi:**

-Rregullorja e brendshme e shoqërisë Albpétrol SHA, nr. 1357, datë 22.04.2013, nuk është përditësuar me ndryshimet që ka pasur struktura organizative e shoqërisë ndër vite, duke mos përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë e shtesave të kryera, si dhe nuk ka të përcaktuar delegimin e kompetencave, detyrave si dhe mënyrën e dokumentimit të tyre.

-Shoqëria Albpétrol SHA, nuk ka plotësuar dhe dërguar në ministri pyetësorin e vetëvlerësimit për komponentët e MFK-së, në kundërshtim me Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, miratuar me Urdhrin e Ministrisë të Financave nr. 8980, datë 15.07.2010, Kap V, “Shtojcat”, Shtojca 2 – Pyetësori i vetë-vlerësimit për komponentët e MFK-së.

- Nuk është hartuar dhe miratuar plani strategjik i cili përmban objektivat strategjike, prioritetet e institucionit dhe planet e veprimtimit.
- Nuk është miratuar Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS).
- Nuk është hartuar strategjia e riskut dhe regjistri i riskut, e për pasojë drejtuesit, nuk janë të vetëdijshëm për përgjegjësinë që kanë në menaxhimin e riskut.
- Nuk është krijuar sistem monitorimi për vlerësimin e efektivitetit dhe progresit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm për arritjen e objektivave.

- Nuk ka procedurë të veçantë për mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, ankesave për analizën e tyre, identifikimin e shkaqeve dhe për eliminimin e problemeve të dala gjatë kryerjes së detyrave.
  - Për ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të punonjësve, nuk janë organizuar trajnime për punonjës me tematikë të ndryshme në funksion të pozicioneve të punës dhe vetë njësia nuk ka programe specifike për trajnimin e punonjësve, në kundërshtim me Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. II, pika 2.5.1 “Mjedisi i kontrollit (ose mjedisi i brendshëm i njësisë), paragrafët “Politikat dhe praktikat që lidhen me burimet njerëzore” dhe “Profesionalizmi i stafit”.
  - Nuk është hartuar gjurma e auditimit që ka si qëllim, të ndihmojë menaxhimin për të vlerësuar përshtatshmërinë e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, të identifikojë boshllëqet, etj.
  - Sistemi aktual i komunikimit të institucionit ka nevojë për përmirësim, pavarësisht se informacioni është i mjaftueshëm për zbatimin e detyrave. Nuk ka procedurë të veçantë për mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, ankesave për analizën e tyre, identifikimin e shkaqeve dhe për eliminimin e problemeve të dala gjatë kryerjes së detyrave.
  - Shoqëria nuk ka implementuar në rregulloren e brendshme komponentë të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.
- Për sa më sipër mban përgjegjësi ish-administratori z.E.P. dhe administratori i shoqërisë z. K.B. *(Trajtuar më hollësisht në pikën 13, të Raportit Përfundimtar).*

### **Rekomandimi:**

Shoqëria Albpetrol SHA të marrë masat e duhura për të bërë ndryshimin e rregullores së brendshme në përshtatje me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, si dhe në përputhje me strukturën organike të shoqërisë me qëllim që, të mos ketë ndryshime midis strukturave të përcaktuara sipas organikës me ato të përcaktuara në rregullore, si dhe të përcaktojë delegimin e kompetencave apo të detyrave dhe mënyrën e dokumentimit të tyre, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Administratori i shoqërisë të marrë masa për hartimin dhe miratimin e planit strategjik i cili përmban objektivat strategjike, prioritetet e institucionit dhe planet e veprimit.

Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe administratori i shoqërisë të merren masat e menjëhershme në drejtim të implementimit të ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin, të miratohen rregullat e funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm.

### **Menjëherë**

#### **7. Gjetje nga auditimi:**

-Të dhënat financiare të paraqitura nga drejtoria e programimit lidhur me të ardhurat e realizuara janë të ndryshme nga të dhënat e pasqyrave financiare të hartuara nga shoqëria.

-Veprimet për ndryshimin e të dhënave të programimit pa u bazuar në argumentime e llogaritje të kontrollueshme e të besueshme tregojnë se projekt-programet nuk janë kryer në studime dhe reflektime reale, por kryhen në mënyrë sipërfaqësore.

-Nga shqyrtimi i projekt-programeve të dërguar nga qendrat e prodhimit u konstatua në pjesën më të madhe se, këto programe nuk argumentonin me shpjegime dhe llogaritje të kontrollueshme shpenzimet që kërkonin. Në pjesën më të madhe të projekt-programeve ishin paraqitur tabela me sasi të hekurit, saraçineskave, tubave, llamarinave, profile hekuri, materiale të tjera si dhe shpenzime për riparime, pa pasur detajet se çfarë do të bëhej me këto materiale si dhe cilat objekte do të riparoheshin, si dhe pa situacionet përkatëse.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi nga drejtoria e programimit znj. V.S., drejtori A.S., drejtori i financës P.B., drejtoria e prodhimit, B.L., drejtoria e shërbimeve N.N., drejtoria e marrëveshjeve hidrokarbure D.S., drejtoria e mjedisit, shëndetit e sigurimit teknik, B.G. dhe

drejtorët e qendrave të prodhimit, drejtori i Q.E.M.N.G, Patos, A.A., drejtori i Q.A.SH.N.G. Patos, E.M., drejtori i Q.P.N. Patos, E.M., drejtori i Q.F.M.T. Patos, E.SH., drejtori i Q.SH.GJ. Patos, I.G., drejtori i Q.P.N. Kuçovë, L.C., drejtoi i Q.P.N. Ballsh, E.A., drejtori i Q.M.N. Kuçovë, B.GJ., drejtori i Q.T. Patos, P.I., drejtori i Q.A.R., S.K., drejtori i Q.T.G., Fier, G.G. *(Trajtuar më hollësisht në pikën 4, të Raportit Përfundimtar).*

### **Rekomandimi:**

Nga administratori i shoqërisë Albpetrol sha, të merren masa që dhënat financiare të paraqitura në raportet periodike për Këshillin Mbikëqyrës dhe Ministrinë e Linjës, të jenë të rakorduara me drejtorinë e financës, për në paraqitje më të saktë dhe të besueshme.

Nga shoqëria Albpetrol sha, të merren masa që të ndiqen procedura të kujdesshme në lidhje me planifikimin real të sasive të prodhimit të naftës e gazit, të të ardhurave të tjera, dhe shpenzimeve, të bazuara në të dhëna teknike të verifikuara dhe kontrolluara nga grupe të ndryshme pune, shpenzimet dhe investimet të jenë të argumentuara me situacionet përkatëse në mënyrë që drejtimi i shoqërisë të mund të ndjekë ecurinë e situatës ekonomiko-teknike dhe të ketë mundësi për ndërmarrjen e veprimeve për përmirësimin e rezultatit financiar.

**Menjëherë**

### **8. Gjetje nga auditimi:**

-Nga auditimi i rregullshmërisë dhe saktësisë të shpenzimeve të amortizimit u konstatua se, janë përdorur norma të amortizimit të miratuara me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 24, datë 30.04.2007, të cilat nuk i përshtaten normave menaxheriale të amortizimit të pajisjeve, si dhe realitetit të zhvlerësimit të aktiveve afatgjata materiale, veprime në kundërshtim me SKK nr. 5, Aktivët Afatgjata Materiale dhe Aktivët Afatgjata Jomateriale - i përmirësuar.

-Shoqëria nuk ka miratuar në asamblenë e ortakëve rezultatet financiare të vitit 2017, brenda afatit 6-mujor nga data e mbylljes së vitit financiar dhe depozitimin e vendimit në organet tatimore dhe në Qendrën e Regjistrimit Kombëtar, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, i ndryshuar, "Për tatimin mbi të ardhurat", neni 33/1, Depozitimi i vendimit për miratimin e rezultatit vjetor dhe destinimi i fitimit.

-Standarti Ndërkombëtar i Kontabilitetit 12 "Tatimi mbi të ardhurat" kërkon që, shoqëria të njohë tatime të shtyra, për diferencat midis vlerës kontabël neto të aktiveve afatgjata materiale të rivlerësuar dhe bazës tatimore. Shoqëria nuk ka llogaritur tatimin e shtyrë dhe pas përfundimit të procesit të vlerësimit të aktiveve afatgjata.

-Zëri të drejta ndaj sigurimeve shoqërore në vlerën 116,255,571 lekë është i mbartur si vlerë kontabël nga bashkime që ka bërë shoqëria në vite dhe nuk përfaqëson një të drejtë reale.

Shoqëria nuk ka marrë masa për kalimin në rezultatit financiar të vitit, duke e kaluar në humbje. Për sa më sipër mban përgjegjësi ish administratori i shoqërisë z.E.P. , administratori i shoqërisë z. K.B. , ish shefi i financës z. P.B., përgjegjësja e sektorit të financës znj. ZH.N. *(Trajtuar më hollësisht në pikën 5, të Raportit Përfundimtar).*

### **Rekomandimi:**

Këshilli Mbikëqyrës dhe administratori i shoqërisë të hartojnë pasqyrat financiare të vitit ushtrimor të mbyllur brenda afateve ligjore, për shmangien e penaliteteve, si dhe për vënien në dispozicion të të dhënave të rezultatit financiar aksionerit kryesor të shoqërisë për vendim-marrje. Gjatë hartimit të pasqyrave, normat e amortizimit duhet të jenë reale dhe të besueshme, të llogariten tatimet e shtyra që do të krijohen shoqërisë pas pasqyrimit të rivlerësimit të aseteve afatgjata materiale. Zëri kontabël, të drejta ndaj sigurimeve shoqërore në vlerën 119,255,571 lekë, i cili nuk ekziston realisht të bartet në rezultatit e vitit ushtrimor.

**Në vijimësi**

## 9. Gjetje nga auditimi:

-Shoqëria ka ndryshuar politikën kontabël, lidhur me njohjen e detyrimeve për produktin naftë të kompanive koncesionare. Në vitin 2011 drejtimi i shoqërisë vendosi që detyrimet për produktin naftë të kompanive koncesionare ta konsideronte si gjendje produkti të gatshëm dhe ta përfshinte në rezultatin e vitit ushtrimor. Në vitin 2015, administratori i shoqërisë vendosi pa asnjë aprovim nga Këshilli Mbikëqyrës, të ndryshojë metodën e njohjes si të ardhura dhe u kryen reflektimet respektive në pasqyrat financiare, duke sistemuar gjendjen e produktit pranë të tretëve në zërin “Fitimi i pashpërndarë”, me vlerën negative - 3,813,605,691 lekë, veprime të miratuara nga ekspertët kontabël të shoqërisë.

Në periudhën ushtrimore 2016-2017 nga administratorët e shoqërisë është ndryshuar politika kontabël dhe ka filluar duke i rinjohur si të ardhura, pa një analizë të efekteve dhe vendim të Këshillit Mbikëqyrës. Efekti që kjo politikë ka në pasqyrat financiare është se shoqëria ka raportuar për vitin 2016 një fitim prej 1,532,532,248 lekë, duke pasur të ardhura nga ndryshimi i produktit vlerën 1,285,401,536 lekë, ndërsa për vitin 2017 shoqëria ka raportuar një humbje prej 405,004,815 lekë. Veprimet sa më sipër kanë sjellë ndryshime në rezultatin e shoqërisë, në kundërshtim me SKK1, pika 86, që citon: *“Qëndrueshmëria në politikat kontabël dhe në formatin e paraqitjes së pasqyrave financiare, është e nevojshme për një krahasim objektiv të treguesve të performancës financiare të njësisë ekonomike në vite. Kërkesat standarde për politikat kontabël, formatet e paraqitjes së informacionit financiar si dhe informacioni që duhet paraqitur në pasqyrat financiare, përbëjnë bazën për krahasimin e të dhënave financiare të njësisë të ndryshme ekonomike”*.

-Për vlerësimin e produktit të gatshëm gjendje në fund të vitit, nga hartuesit e pasqyrave financiare, nuk është përdorur çmimi mesatar i realizuar i vitit 2017, metoda e përdorur për periudhën ushtrimore të mëparshme por, çmimet e shitjes sipas 3-mujorit kur është bërë hyrje produkti ose është njohur detyrimi ndaj kompanive koncesionare. Kjo metodë vlerësimi është e ndryshme nga viti ushtrimor 2016, duke sjellë një diferencë në rritje të vlerës së produktit të gatshëm me 143,000,000 lekë, dhe të rezultatit financiar të shoqërisë.

Këto veprime janë në kundërshtim me Standardin Kombëtar i Kontabilitetit Nr.1 “Kuadri i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare”, parimi “Qëndrueshmëria dhe Krahasueshmëria”, pika 85.

Për sa më sipër mban përgjegjësi ish administratori i shoqërisë z.E.P. , administratori i shoqërisë z. K.B. , ish shefi i financës z. P.B., përgjegjësja e sektorit të financës znj. ZH.N. (Trajtuar më hollësisht në pikën 5, të Raportit Përfundimtar).

## Rekomandimi:

Shoqëria duhet të marrë masa për korrigjimin e gabimit të kryer në periudhën 2017, me qëllim paraqitjen reale të situatës financiare të saj. Në hartimin e pasqyrave financiare të përfshihet informacion shpjegues për politikat kontabël të adoptuara për matjen e inventarëve, me qëllim për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, i dobishëm për vendimmarrjen ekonomike të një grupi të gjerë përdoruesish të cilët nuk kërkojnë raporte të veçanta për të përmbushur nevojat e tyre specifike për informacion.

**Në vijimësi**

## 10. Gjetje nga auditimi:

-Shoqëria nuk ka plotësuar regjistrin e aktiveve që ka në pronësi apo posedim, me kërkesat minimale që duhet të përmbajë ky regjistër si, datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia, mbajtjen në



mënyrë shkresore të tij, veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 30.

Për sa më sipër mban përgjegjësi ish administratori i shoqërisë z.E.P. , administratori i shoqërisë z. K.B. , ish shefi i financës z. P.B., përgjegjësja e sektorit të financës znj. ZH.N. *(Trajtuar më hollësisht në pikën 5, të Raportit Përfundimtar).*

#### **Rekomandimi:**

Shoqëria duhet të marrë masa për plotësimin e regjistrimit të aktiveve në mënyrë shkresore, me kërkesat minimale që duhet të përmbajë ky regjistër si, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia, mbajtjen në mënyrë shkresore të tij, si një pjesë e rëndësishme e menaxhimit të aktiveve.

**Në vijimësi**

#### **11. Gjetje nga auditimi:**

-Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe administratori i Albpetrol SHA, nuk janë marrë masat për një vlerësim real dhe të besueshëm për gjendjen e llogarive të arkëtueshme. Në pasqyrat financiare janë paraqitur të drejta që i përkasin periudhave të mëparshme duke iu kaluar dhe afatet e parashkrimit, të drejta për të cilat nuk disponojnë dokumenta ligjore, subjekte që kanë falimentuar etj., *(Trajtuar më hollësisht në pikën 5, të Raportit Përfundimtar).*

#### **Rekomandimi:**

Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe administratori i shoqërisë, të merren masa për një shqyrtim të besueshëm dhe real të llogarive të arkëtueshme dhe për vlerat që i'u përkasin subjekteve që kanë falimentuar, dhe i kanë kaluar afatet e parashkrimit, apo për të cilat nuk disponojnë dokumenta ligjore të kryejnë vlerësimet e duhura dhe të krijojnë provizionet përkatëse dhe sistemimin e tyre sipas SKK 6, Provizionet, Detyrimet dhe Aktivitetet e Kushtëzuara - i përmirësuar.

**Në vijimësi**

#### **12. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore në prokurimet e fondeve publike, lidhjen dhe zbatimin e kontratave, u konstatua se:

-Nuk janë kryer trajnime të stafit për prokurimin publik, në kundërshtim me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 83/2.

-Në të gjitha rastet e audituara, nuk konstatohet të jetë argumentuar dhe dokumentuar vendosja e kriterëve për kualifikim, në kundërshtim me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 61, pika 2.

- Në të gjitha rastet e audituara, nga njësia e prokurimit janë vendosur kriterë diskriminuesë, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 20 dhe neni 46.

- Në të gjitha rastet e audituara, kualifikimi, shpallja fitues e operatorëve ekonomik nga KVO, si dhe lidhja e kontratave, është kryer në mënyrë të padrejtë, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 53, pika 3.

- Në të gjitha rastet e audituara, zbatimi i kontratave për mallra, shërbime dhe punë, është kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 60, pika 1.

-Në 1 rast, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, në dosjen e procedurave të prokurimit, nuk u gjetën deklaratat e konfliktit të interesit, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 64, pika 2.

- Në të gjitha rastet e audituara, në kundërshtim me nenin 68 të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në kushtet kur në raportin përmbledhës mungojnë të dhëna kryesore si, referenca e procedurës së prokurimit dhe përshkrimin e punëve/mallrave/shërbimeve, titullari i AK, bazuar në dispozitën e sipërcituar nënligjore, në kushtet e mungesës së elementëve thelbësorë të sipërpërmendur, nuk duhej të kishte bërë miratimin e këtij raporti përmbledhës (në fuqi në kohën e kryerjes së procedurës).

-Në të gjitha rastet, procedurat e përfunduara nuk ishin të inventarizuara dhe të arkivuara, në kundërshtim me Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”, *(Trajtuar më hollësisht në pikën 7, të Raportit Përfundimtar)*.

### **Rekomandimi:**

Titullari i AK të marrë masa që t'i kushtojë vëmendjen e duhur institucionale procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit nga komisionet e vlerësimit të ofertave, dokumentacionit ligjor dhe administrativ të operatorëve ekonomikë dhe ofertave të ofertuesve, me qëllim rritjen e efikasitetit në shpenzimet publike, duke zhvilluar procedura prokurimi në përmbushje të kriterëve ligjore, kapaciteteve ekonomike, financiare dhe profesionale, në përzgjedhjen e ofertës më të mirë ekonomike, duke siguruar që Autoriteti Kontraktor të pranojë oferta të cilat janë të përballueshme, të qëndrueshme, të pakushtëzuara dhe të plotësimit të nevojave të saj.

### **Vazhdimisht**

### **13. Gjetje nga auditimi:**

Nga shoqëria Albpetrol SHA, nuk janë marrë masat për një vlerësim real dhe të besueshëm për gjendjen e pronave të lëna me qira. Sipërfaqet që shfrytëzojnë qiramarrësit, për objektet e lëna me qira, tejkalojnë hapësirat e përcaktuara në kontratë, për të cilat është rënë dakort midis palëve, veprime në kundërshtim me VKM Nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar *(Trajtuar më hollësisht në pikën 7, të Raportit Përfundimtar)*.

### **Rekomandimi:**

Nga drejtimi i shoqërisë të merren masa për verifikimin e të gjitha pronave të lëna me qira, gjendjen e tyre, si dhe hapësirat reale që shfrytëzohen nga subjektet me të cilat është lidhur kontrata përkatëse.

### **Menjëhere dhe në vijimësi**

### **14. Gjetje nga auditimi:**

Nga Shoqëria Albpetrol SHA nuk është zbatuar shkronja “b” e nenit 1 të ligjit nr. 7598, datë 01.09.1992 “Për krijimin e fondit të veçantë monetar për ish-të dënuarit e të përndjekurit politikë” dhe VKM nr. 392, datë 12.08.1999 “Për administrimin e fondit të veçantë monetar, të krijuar sipas ligjit nr. 7598, datë 01.09.1992 “Për krijimin e fondit të veçantë monetar për ish-të dënuarit e të përndjekurit politikë” derdhur në Institutin e Integritit të ish-të Përndjekurve Politikë për të arkëtuar për llogari të Institutit të Integritit të ish-të Përndjekurve Politikë shumën 1 % të fondit të pagave për vitin 2017. Fondi i pagave sipas të dhënave nga dega e Financës është 1,770,570,055 lekë për vitin 2017 dhe 948,689,092 për 7-mujorin e parë të vitit 2018, pra në total për periudhën objekt auditimi fondi i pagave është 2,719,259,147 lekë dhe shuma që duhet derdhur për llogari të Institucionit të ish-të përndjekurve politikë është 27,192,591 lekë. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 7598, datë 01/09/1992 “Për krijimin e fondit të veçantë monetar për ish-të përndjekurit politikë”, neni 1, pika b), apo VKM nr. 392, datë 12.08.1999 “Për administrimin e fondit të veçantë monetar” *(Trajtuar më hollësisht në pikën 3, të Raportit Përfundimtar)*.

**Rekomandimi:**

Nga ana e Shoqërisë Albpetrol SHA., të merren masat e duhura për përmbushjen e detyrimeve ligjore për derdhjen e kontributeve të detyrueshme për ish të përndjekurit dhe ish të dënuarit politikë, për kryerjen e pagesës brenda afateve të përcaktuara dhe në përputhje me vlerën e përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi për shumën e pa paguar prej 27,192,591 lekë .

**Brenda 6-mujorit të parë 2019.**

**15. Gjetje nga auditimi:**

-Shoqëria ka në detyrimet afatgjata vlerën 2,882,966,924 lekë e cila përbën vlerën e dividendit të papaguar ndaj Buxhetit të Shtetit. Megjithëse shoqëria ka paraqitur pasqyra financiare me fitime ndër vite dhe ka vendosur për kalimin e tyre në disident për tu paguar ndaj aksionerit kryesor, ritmet e pagesës së këtij detyrimi janë shumë të ulëta (*Trajtuar më hollësisht në pikën 5, të Raportit Përfundimtar*).

**Rekomandimi:**

Nga drejtimi i shoqërisë të merren masa me përparësi për shlyerjen e detyrimeve ndaj Buxhetit të Shtetit, për dividendët e pa paguar të periudhave të mëparshme.

**Menjëherë**

**16. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi i zhvillimit të operacioneve hidrokarbure në vendburimin P, rezultatet e arritura gjatë viteve të para të veprimtarisë nga kontraktori, vërtetuan mospërputhje të theksuara të treguesve ekonomiko-financiarë, krahasuar me ato të parashikuara dhe të miratuara në Planin e Zhvillimit. Sistematikisht në treguesit e tyre ekonomikë, janë raportuar të kryera me tejkalim shpenzimet.

Nisur nga këto mospërputhje dhe shpërpjesëtime të vërtetuara gjatë zbatimit të Planit të Zhvillimit të miratuar në vitin 2006, nga ana e kontraktorit, është propozuar amendimi i programit financiar. Pas mbarimit të periudhës së vlerësimit në fund të vitit 2005, kompania kontraktore, paraqiti Planin e Zhvillimit Afatgjatë 25-vjeçar, sipas të cilit faktori R do të ishte më i madh se një në fund të vitit 2011. Pra, gjatë vitit 2012 dhe në vazhdim do të merrte nga aktiviteti i saj 50 % fitim edhe Shteti Shqiptar. Duke parë që treguesit kryesorë të paraqitur në Planin Afatgjatë të Zhvillimit nuk u arritën, në fund të vitit 2008, kompania kontraktore, paraqiti amendimin i cili u miratua nga AKBN dhe METE. Sipas planit të ri, u bë një ndryshim i theksuar i treguesve reale, me ato të planit fillestar të zhvillimit të miratuar në Këshillin e Ministrave.

Ndryshimet e qëllimshme të Planeve të Zhvillimit të MH në funksion të ndikimit në Faktorin R, pasi akoma nuk është arritur që të jetë më i madh se 1, e konsideruar kjo dhe si një dështim në mbikëqyrjen shtetërore të këtyre marrëveshjeve; parregullsi në shpenzime duke përfshirë sponsorizime të pamiratuara në koston e rikuperueshme të operacioneve hidrokarbure; mungesë verifikimi të kontratave; miratimi i planeve të zhvillimit pa i analizuar dhe shqyrtuar si duhet; janë përjashtuar nga TVSH dhe aktivitete të cilat nuk janë të lidhura drejtpërdrejt në operacionet hidrokarbure; parregullsi në përdorimin e holluesit në procesin teknologjik të nxjerrjes së naftës dhe për përjashtimet e Akcizës dhe TVSH-së për këtë qëllim; fiktivitet i proceseve të monitorimit të operacioneve hidrokarbure; pasuritë kombëtare përdoren pa kriter; kanë pasoja negative në ekonomi dhe jetën e qytetarëve të zonave në shfrytëzim.

Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN), me datën 11.06.2009, miratoi një Plan Zhvillimi të ri.

Miratimi nga MIE, AKBN, Komiteti Këshillimor, Këshillit Shkencor dhe “Albpetrol” SHA, i Planit të Zhvillimit të M-H të ndryshuar është në kundërshtim pikën 3/a.1 të nenit 5 të Ligjit nr. 7746, datë 28.7.1993 “Për Hidrokarburet” (kërkim dhe prodhim) dhe interesat e shtetit shqiptar në këtë marrëveshje, pasi nuk ekziston asnjë kusht specifik të cilat kërkojnë një periudhë më të gjatë që të legjitimojë ndryshimin e Planit të Zhvillimit.

Miratimi i Planit të Zhvillimit për vitin 2016, (në skenarin Hight Case, vlera R= 1 arrihet në vitin 2022, ndërsa në skenarin Morket Case kjo arrihet në vitin 2026.) nga AKBN, Komiteti Këshillimor, Këshillit Shkencor dhe “Albpetrol” SHA, janë në kundërshtim pikën 3/a.1 të nenit 5 të Ligjit nr. 7746, datë 28.7.1993 “Për Hidrokarburet” (kërkim dhe prodhim), pasi jo vetëm ka kaluar afati kohor maksimal 7 vjeçar pasi ka filluar Faza e Zhvillimit (pa justifikim), për ndryshimin e Planit të Zhvillimit por dhe jashtë kompetencave ligjore që u jep funksioni/detyra (*Trajtuar më hollësisht në pikën 9, të Raportit Përfundimtar*).

### **Rekomandim:**

**16.1** Albpetrol SHA me bashkëpunim e AKBN, në zbatim të ligjit nr.7746, datë 28.7.1993 “Për Hidrokarburet” (kërkim dhe prodhim), L-M, M-H dhe Planit të Zhvillimit e të marrë të gjitha masat, të bëhen njoftimet përkatëse sipas marrëveshjes për dokumentimin e të gjitha shkeljeve të konstatuara në vite, në mbështetje të nenit 24 të M-H, kërkimin e dorëzimit të fushave në shfrytëzim dhe ndërprerjen e marrëveshjes, pasi synimi fillestar (PZH) efektivitetit i operacioneve hidrokarbure dhe arritjen e koeficientit R mbi 1, veprim i cili do të shoqërohej me marrjen e përfitimit ndërmjet Kontraktorit dhe Qeverisë Shqiptare, me këta tregues ekonomikë nuk mund të realizohen .

**16.2** Albpetrol SHA në bashkëpunim me AKBN, të analizojnë shkaqet dhe të kërkojnë nga Kontraktori zbatimin e Planit të Zhvillimit të vitit 2004, rishikuar në vitin 2009, duke reflektuar dhe zbritur nga Kostot Hidrokarbure shpenzime të pa arsyeshme, pa ekonomikitet, pa eficiencë dhe pa efektivitet, si dhe të regjistrojë në të ardhurat e kontraktorit sasinë e naftës brut të pa deklaruar, rezultuar nga testimi i puseve. Pas këtyre veprimeve të përlogarit vlera e Faktori R , dhe të llogaritet pjesa e fitimit për qeverinë Shqiptare.

**Deri më datë 31.03.2019**

### **17. Gjetje nga auditimi:**

Marrëveshjet hidrokarbure për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimet P, F-K, D, A. Nënshkruar nga “Albpetrol” SHA, më datë 21.08.2013, me kontraktorin, në paragrafi i fundit të nenit 9 ”Renta Minerare”, Pjesa e Albpetrolit, dhe mbulimi i shpenzimeve, shprehet:“Taksa e Rentës Minerare do ti paguhet Qeverisë Shqiptare në kesh në përputhje me ligjin 9975, datë 28.07.2008 “Për Taksat Kombëtare” dhe do të mbulohet nga Kontraktori si pjesë e Mbulimit të Kostove në vlerën 100% të vlerës së saj, është në kundërshtim me ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”,

Kjo pikë e Marrëveshjeve Hidrokarbure, është në kundërshtim me ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar, ka pasoja financiare për Albpetrol SHA dhe Shtetin Shqiptar.

Renta minerare përlogarit mbi vlerën e tatueshme (ose vlerën fiskale) të të ardhurave nga aktiviteti i nxjerrjes, në bazë të ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar. Sipas ligjit për taksat kombëtare, renta minerare nga shitja e naftës dhe gazit përlogarit në masën 10% të vlerës së tatueshme (*Trajtuar më hollësisht në pikën 9të Raportit Përfundimtar*).

### **Rekomandim:**

Albpetrol SHA dhe AKBN, të auditojë llogaritë e kontraktorit, gjithë prodhimin e hidrokarbureve në zbatimin e marrëveshjeve hidrokarbure në vendburimet e P, F, D, A nga e

bërjes efektive të marrëveshjes deri në dorëzimin e vendburimeve. Albpetrol SHA, të njoftojë KLSH, për rezultatet e këtij auditimi, duke llogaritur edhe vlerën e rentës minerare që duhet të paguante kontraktori për të gjithë prodhimin e hidrokarbureve në këta vendburime.

**Deri më datë 31.03.2019**

### **18. Gjetje nga auditimi:**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se raporti të ardhurave me shpenzimet (koeficienti R), në rastin më të mirë, nuk pritët të bëhet mbi 1 deri në vitin 2022. Ky parashikim përbën një devijim të madh nga parashikimet e Marrëveshjes Hidrokarbure dhe Plani Zhvillimit .

Gjatë auditimit ka rezultuar se Plani Zhvillimit Afatgjatë, i cili nuk është bërë për përmirësimin e Marrëveshjes Hidrokarbure në raport me pozitën e shtetit shqiptar, nuk kanë ndikuar në arritjen e Faktorit  $R \geq 1$ , por në të kundërt. Këto ndryshime janë miratuar ndër vite nga të gjitha strukturat e shtetit në nivel qendror. Si pasojë e ndryshimeve të Planeve të Zhvillimit kohë mbas kohe, treguesit ekonomiko-financiar të arritur nga veprimtaritë e kompanive hidrokarbure kanë pasur mospërputhje, krahasuar me parashikimet e miratuara në Planet Afatgjatë të Zhvillimit (PZH), Planet dhe Buxhetet e Punës vjetore (PP&B), duke raportuar të kryera me tejkalim shpenzimet, krahasuar me naftën e nxjerrë, pavarësisht se me rritje, duke iu përafuar Faktori  $R=1$ , por duke mos e arritur asnjëherë. Me qëllim që Faktori R të jetë real, kërkohet që dhe shpenzimet e rikuperueshme të jenë reale, gjë e cila kërkon dhe sigurohet nga një auditim kompetent profesional, me integritet, në kohë si dhe një monitorim perfekt i të gjitha proceseve hidrokarbure që zhvillohen nga kompanitë e që njihen si Costo Recovery (*Trajtuar më hollësisht në pikën 9, të Raportit Përfundimtar*).

### **Rekomandim:**

**18.1** Albpetrol SHA, të ndjekë dhe monitorojë zbatimin e Marrëveshjes Hidrokarbure për zonën P, por edhe për zona të tjera. Për devijime nga parashikimet në Marrëveshjen Hidrokarbure, të bëhen njoftimet përkatëse sipas marrëveshjes, duke lënë kohën e nevojshme për përmirësimin e situatës, me synim përmirësimin e efektivitetit të operacioneve hidrokarbure dhe arritjen e koeficientit R mbi 1, veprim i cili do të shoqërohej me marrjen e përfitimit ndërmjet Kontraktorit dhe Qeverisë Shqiptare, në të kundërt kërkimin e dorëzimit të fushave në shfrytëzim dhe ndërprerjen e marrëveshjes.

Nga ana e Albpetrol të auditohen llogaritë e kontraktorit duke filluar nga raporti i katërt i vitit 2014 e në vazhdim, duke zbritur Kostot Hidrokarbure të regjistruara në kundërshtim me Marrëveshjen Hidrokarbure.

**18.2** Të analizohen shpenzimet e realizuara për hapjen e puseve të reja të cilët nuk janë aktiv, rritja e shpenzimeve të paraqitura nga kontraktori duke filluar nga viti 2013, shpenzime të cilat janë rritur me arsyetimin e rritjes së prodhimit, rritje e cila është shumë e vogël në krahasime rritjen e prodhimit.

**Deri më datë 31.03.2019**

### **19. Gjetje nga auditimi:**

Gjatë zbatimit të Marrëveshjes Hidrokarbure në vendburimin P, nuk është arritur faktori  $R \geq 1$ . Nga viti 2004-2017 (dhe Janar-Korrik 2018 më i vogël se 1), Faktori R ka variuar nga 0.550 në vitin 2004 në 0.9565 për vitin 2017. Duke u gjendur përpara këtij fakti që  $R \leq 1$ , Qeveria shqiptare, nga viti 2008, miratoi ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për taksat Kombëtare”, që mundësoi implementimin e Rentës Minerare, ku kompanitë e hidrokarbureve në zhvillim paguajnë 10 % të shitjeve brenda dhe jashtë vendit në favor të buxhetit të shtetit. Vlera që arkëtohet në buxhetin e shtetit është njëkohësisht e njohur për kompaninë si “Cost Recovery”, që do të thotë këtë vlerë të konvertuar në sasi naftë e ka pronë të saj kompania. Në dukje krijohet përshtypja që shteti përfiton nga Renta Minerare, por në fakt në raste të tilla kjo ka ndikuar ndër vite, në mos arritjen e Faktorit  $R \geq 1$ , gjë do të sillte të ardhura të tjera shumë më

të larta për shtetin shqiptar e të pa ngarkuar me “Cost Recovery”. Duke qenë se, në vazhdimësi koeficienti R rezulton më i vogël se 1, si pasojë e të cilit nuk krijohen kushte për të përfituar nga qeveria shqiptare, përveç sa u trajtua më sipër, shfrytëzimi i këtyre burimeve naftëmbajtëse për një përfitim të papërfillshëm do të sjellë pasojë për këtë sektor në të ardhmen, duke marrë edhe në konsideratë faktin se këto burime nuk janë të pashtershme (*Trajtuar më hollësisht në pikën 9, të Raportit Përfundimtar*).

**Rekomandim:**

Albpetrol SHA, të marrë masa për realizimin e një studimi mbi sasitë e naftës bruto të disponueshme në zonën e marrëveshjes dhe paraqitjen e termave për shfrytëzimin sa më optimal të tyre. Të rritet monitorimi dhe inspektimet përgjatë kohës së realizimit të operacioneve hidrokarbure, duke bërë orientimet për ndërhyrje dhe hapje të puseve të reja sipas përcaktimeve në marrëveshjen hidrokarbure.

Nga ana e MEI dhe AKBN, të merren masa për të vendosur instrumente monitorimi të efektshme dhe të kërkojë rivlerësimin objektiv të Planit të Zhvillimit, operacioneve teknike dhe të marrë masa për rritjen e profesionalizimit në realizimin e auditimeve financiare lidhur me kostot që përfshihen në aktivitetin hidrokarbur, për t'i vënë në efikasitet marrëveshjet e lidhura, me qëllim të një vlerësimi të saktë të Faktorit R, me synim mos shmangien e detyrimeve financiare ndaj shtetit. Në çdo rast të përcaktohet niveli i përgjegjësisë së individëve të përfshirë në këtë proces në mënyrë që t'i pritët rruga informalitetit të këtyre monitorimeve ku interesat e shtetit shihen të fundit.

**Menjëherë dhe vazhdimisht**

**20. Gjetje nga auditimi:**

Gjatë zbatimit të marrëveshjeve hidrokarbure në vendburimet P, D, të zonës P, V, K, gjatë viteve të shfrytëzimit të zonave naftëmbajtëse, kontraktorët kanë krijuar detyrime në likuidimin e sasisë së naftës pjesë e Albpetrol SHA, nga PPE&PPA sipas marrëveshjeve hidrokarbure dhe për shërbimet e kryera nga Albpetrol SHA. Detyrimet janë krijuar në periudha kur çmimi i naftës bruto ka qenë disa herë më i lartë se çmimi aktual i naftës bruto (përfshihet “TOG” nga konstatimi i sipërcituar).

Detyrimet kanë ardhur duke u akumuluar dhe si rrjedhojë e ndryshimit të Kontraktorit në marrëveshjen për zonat C-M, G-K, B-H. Një pjesë e detyrimeve nuk garantohej për shlyerje. Vjelja e detyrimeve përbën risk për Albpetrol SHA, i cili vjen si pasojë e mundësisë së dështimit të kontraktorëve për vazhdimësinë e të zbatimit të marrëveshjeve hidrokarbure. Pavarësisht përpjekjeve të Albpetrol për vjeljen e detyrimeve, nuk janë bërë njoftimet për thyerje të marrëveshjeve dhe marrje të masave sipas tyre, njoftime sipas të cilave kontraktorët do të viheshin nën presion në kohën e duhur për shlyerjen e detyrimeve, ose dorëzimin e zonave të shfrytëzimit sipas marrëveshjeve (*Trajtuar më hollësisht në pikën 9, të Raportit Përfundimtar*).

**Rekomandim:**

Albpetrol SHA, të marrë masa për marrjen e detyrimeve të krijuara nga kontraktorët për pjesën naftë bruto dhe gaz, sipas marrëveshjeve dhe për shërbimet e kryera nga “Albpetrol” Sha. Në rast të mos shlyerjes dhe vazhdimit të akumulimit më tej të detyrimeve, të bëhen njoftimet sipas përcaktimeve në marrëveshjet hidrokarbure për thyerje të marrëveshjeve dhe të merren masat përkatëse sipas afateve që përcaktohet në to, me synim vjeljen e detyrimeve të cilat do të përmirësojnë treguesit ekonomiko-financiar të Shoqërisë.

**Menjëherë dhe vazhdimisht**

## **21. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi i zbatimi të Marrëveshjes-Hidrokarbure për vendburimin P, rezulton se kontraktori, ka marrë kredi në tre banka ndërkombëtare “Raiffeisen Bank” Sha, “Korporata Ndërkombëtare Financiare” (IFC) dhe “Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim” (EBRD), veprime të konsideruara nga kontraktori si në përputhje me Marrëveshjen Hidrokarbure, në bazë të të cilave ka hipotekuar interesat e këtyre Marrëveshjeve. AKBN ka dhënë miratimin, ndërsa Albpetroli SHA, nuk e ka dhënë miratimin e tij. Në Korrik 2015 Albpetrol SHA, ka njoftuar kontraktorin se është në shkelje të Marrëveshjes Hidrokarbure. Në zbatim të LM & MH, AKBN-së i transferohen pronësia mbi të gjitha asetet kostot e të cilave janë rekuperuar, megjithatë ky i fundit ka të drejtë t’i përdorë këto asete gjatë kohëzgjatjes së LM-së. AKBN dhe Albpetroli SHA, kanë shfaqur shqetësimin e tyre se këto asete janë hipotekuar pavarësisht se pronësia i kaluar AKBN-së.

Mosmarrëveshja e hipotekimit të interesave është edhe mosmarrëveshje mbi transferimin e aseteve. Sipas LM & MH, AKBN-së i transferohen pronësia mbi të gjitha asetet kostot e të cilave janë rikuperuar nga kontraktori, megjithatë ky i fundit ka të drejtë t’i përdorë këto asete gjatë kohëzgjatjes së LM-së. AKBN dhe Albpetrol SHA, i kanë shfaqur shqetësimin e tyre se këto asete janë hipotekuar pavarësisht se pronësia i kaluar AKBN-së.

Kontraktori, ka transferuar interesat e Marrëveshjes Hidrokarbure tek këto banka, në kundërshtim të plotë si me Marrëveshjen Hidrokarbure dhe bazën ligjore që operon në fushën hidrokarbure. Nga ana e Albpetrol SHA nuk disponohet informacioni i saktë për sasinë e aseteve të përdorura për kolateral, të cilat janë të përfshira në kostot e operacioneve hidrokarbure, megjithëse për këtë qëllim i ka kërkuar Kontraktorit informacion të detajuar *(Trajtuar më hollësisht në pikën 9, të Raportit Përfundimtar)*.

## **Rekomandim:**

Albpetrol SHA, të kërkojë nga kontraktori, informacion të detajuar mbi asetet e përfshira si vlerë në kostot hidrokarbure të cilat mund të jenë përdorur si kolateral për kreditim, me synim parandalimin e humbjeve në raste të tërheqjes së mundshme të Kontraktorëve nga marrëveshjet hidrokarbure. Albpetrol duhet të marrë vendime konformë përcaktimeve në Marrëveshjes Hidrokarbure, duke zbritur vlerën e këtyre aseteve e cila është përfshirë në koston e operacioneve hidrokarbure, si dhe të rillojarisë vlerën e koeficientit R i cili duhet të rezultojë më i lartë, si pasojë e zvogëlimit të vlerës së koston hidrokarbure.

**Deri më datë 31.01.2019**

**22. Gjetje nga auditimi:** Në Marrëveshjen Hidrokarbure të nënshkruar midis Albpetrol SHA, dhe kontraktorit, neni 21.2. përcaktohet: *“Kontraktori do të bëjë tendera konkurrues për ndonjë shërbim të kryer në përputhje me çështjet e përfshira në një Program Vjetor dhe Buxhet, nëse shërbime të tilla pritjet të kalojnë vlerën 2 milionë USD. Albpetrol mund të ndjekë hapjen e ofertave për të gjithë tenderat e tillë”*.

Palët vazhdimisht kanë patur mosmarrëveshje lidhur me disa kushte që duhet të plotësoheshin sipas Albpetrol në lidhje me procedurat e tenderave me vlere mbi 2,000,000 USD, në mënyrë që të konsideroheshin si Kosto Hidrokarbure, derisa kjo çështje u dërgua për gjykim në arbitrazh. Midis “Albpetrol” SHA, dhe kontraktorit, fillimisht janë mbajtur disa takime dhe komunikime ku është diskutuar mbi një mënyrë zgjidhje të përbashkët për këtë çështje. Zgjidhja e çështjes mendohet se është arritur vetëm në vitin 2018, kur kontraktori implemetoi një “C online system” për këtë qëllim, i cili u aprovua edhe nga Albpetrol SHA. Në momentin e hartimit të këtij dokumenti, ky sistem është akoma në proces testimi *(Trajtuar më hollësisht në pikën 9, të Raportit Përfundimtar)*.

### **Rekomandim:**

Albpetrol SHA, të marrë masa për të asistuar në të gjitha procedurat e tenderimit që zhvillohen nga kontraktori, për vlerën mbi 2 milionë USD sipas përcaktimeve në Marrëveshjen Hidrokarbure. Duke qenë se çmimet e aplikuara nga kontraktori për punime dhe shërbime të ndryshme rezultojnë shumë më të larta se tregu, të sugjerohen kompani vendase të cilat kryejnë zbatime kontratash pranë Albpetrol dhe institucione të tjera për ekonomizimin e shpenzimeve që regjistrohen kosto hidrokarbure. Nëpërmjet auditimit, të reflektohen dhe zbriten vlerat e raportuara mbi tregun vendas për shërbime, punime apo mallra të cilat prokurohen nga kontraktori me çmime disa herë më të larta se tregu.

**Vazhdimisht**

### **23. Gjetje nga auditimi:**

Albpetrol SHA, nuk ka kryer asnjëherë dy auditime të librave të llogarisë, regjistrimeve dhe llogarive në një vit fiskal, brenda 12 muajve nga marrja e secilës deklaratë të llogarisë kosto sipas procedurës llogaritëse, asnjëherë nuk ka evidentuar mungesën e dokumentacionit të paraqitur kontratori dhe asnjëherë nuk e ka këshilluar kontraktorët për deklarimin e llogarisë kosto sipas procedurës llogaritëse 3 muaj para kalimit të afatit 12 mujor. Në zbatim të nenit 25 të Marrëveshjes-Hidrokarbure.

Nga ana e D.M.H, për veprimtarinë e kontraktorëve në M-H, gjatë, janë kryer: auditime në lidhje me koston e operacioneve hidrokarbure për zbatimin e marrëveshjeve hidrokarbure për:

-Vendburimet B, G, C “Albpetrol” SHA, me shkresën nr.8084 prot, datë 07.12.2017, ka njoftuar kontraktorin për mosnjohje totale e Kostove Hidrokarbure në zbatim të Marrëveshjeve Hidrokarbure për Zhvillimin dhe Prodhimin e Hidrokarbureve në vendburimet për raportet tremujore (Q1,Q2, Q3 e Q4-2016), pasi Programi i Punës dhe Buxhetit për vitin 2016 paraqitur nga kontraktori nuk është miratuar as nga Albpetrol SHA dhe AKBN për këto vendburime, gjithashtu nuk i është përgjigjur kërkesës për realizimin e auditimit për vendburimet B, C dhe G me gjithë kërkesat “Albpetrol” SHA për vitin 2016 nuk njih si Kosto Hidrokarbure vlerën totale prej **5,138,620 USD**:

-Vendburimin e D ku operon kontraktori për (Q3-2016, Q4-2016), auditimi ka rezultuar me parregullsi në lidhje me paraqitjen e shpenzimeve të përfshira në kostot hidrokarbure, me vlerë **113,298 USD**.

-Vendburimet A, D, P, F, P, D, B :

- auditim në lidhje me koston e operacioneve hidrokarbure të marrëveshjeve hidrokarbure për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbure në vendburimet; A, D, P, F, P, D, B-K (për Q1-Q4 2016) dhe për P-M dhe F-K (për Q1-2016). Auditimi ka rezultuar me parregullsi në lidhje me paraqitjen e shpenzimeve të përfshira në kostot hidrokarbure, me vlerë **41,121 USD**.
- auditim në lidhje me koston e operacioneve hidrokarbure të marrëveshjeve hidrokarbure për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbure në vendburimet; P-M dhe F-K, megjithëse janë konstatuar shkelje dhe është kërkuar dy herë (me shkresat : nr.1269 prot., datë.09.02.2018 e nr.1807, datë 26.02.2018, për paraqitjen e pretendimeve për Q2.Q3 e Q4 2016, nuk është marrë asnjë hap.

Në vendburimin ku operon kontraktori, nga auditimet dhe progres raportet tremujore kanë rezultuar parregullsi në lidhje me paraqitjen e shpenzimeve të përfshira në kostot hidrokarbure, me vlerë **644,501,583 USD**.

- në periudhën Janar-Tetor 2014, është kryer një auditim në lidhje me koston e operacioneve hidrokarbure, për periudhën Tetor-Dhjetor 2012 dhe Janar-Tetor 2013. “Albpetrol” me shkresë nr. 5453/1, datë 14.05.2014, ka njoftuar kontraktorin, në lidhje me mosnjohjen si shpenzime të regjistruara në koston hidrokarbure për periudhën Tetor-Dhjetor 2012 me vlerë **121,326,000 USD**



- “Albpetrol” SHA, me shkresë nr. 5453/2, datë 26.12.2014, ka kërkuar nga kontraktori, zbritjen e vlerës **231,187,463 USD**, për periudhën e zhvillimit të operacioneve hidrokarbure Janar-Shtator 2013. Pavarësisht njoftimit të bërë Kontraktorit, nuk është vepruar akoma për reflektimin e këtyre rezultateve në rishikimin e kostove hidrokarbure.
- Albpetrol” SHA për periudhën Tetor-Dhjetor 2013, dhe Janar-Dhjetor 2014, ka njoftuar kontraktorin, me shkresën nr. 3155 prot., datë 30.04.2018, që për periudhën e sipërcituar **vlera 270,803,147 USD**, nuk njihet si Kosto Hidrokarbure dhe duhet të zbritet nga Llogaria Kosto.
- Në progres raportin e tremujorit të parë 2015, të dërguar në Albpetrol SHA nga kontraktori, është konstatuar se është ngarkuar llogaria kosto me një shumë **21,185,000 USD**, e cila ka lidhje me marrëveshjen për të zgjidhur me kontraktorin. Pas këtij informacioni Albpetrol SHA, i ka kërkuar kontraktorit që duhet të provojë dhe justifikojë çdo kosto që rëndon në llogarinë kosto hidrokarbure. Për këtë arsye nuk do të njohë asnjë kosto dhe shpenzim pa dokumentacion justifikues.

Albpetrol SHA, është mjaftuar vetëm me konstatimet e auditit, pa marrë hapat e mëtejshëm, siç është mos pranimi i raporteve, pa zbritur vlerën e mësipërme të përfshirë nga Kontraktorët si shpenzime në operacionet hidrokarbure. Nga sa më sipër rezulton se kontraktori ka përfshirë një sërë shërbimesh si kosto hidrokarbure pa paraqitur asnjë dokumentacion për justifikimin e realizimit të tyre. Ky fakt tregon shmangie të theksuara nga përcaktimet e marrëveshjeve hidrokarbure nga ana e Kontraktorit si dhe punë aspak efikase të strukturave të Albpetrol SHA, në monitorimin hap pas hapi të zbatimit të këtyre marrëveshjeve (*Trajtuar më hollësisht në pikën 9, të Raportit Përfundimtar*).

#### **Rekomandim:**

Albpetrol SHA, të mos mjaftohet vetëm në identifikimin e vlerave që nuk njeh si Kosto Hidrokarbure, të marrë masa për zbritjen e vlerave nga kostoja e operacioneve hidrokarbure, si shpenzime të pajustificuara nga ana e kontraktorit, duke bërë rillogaritjen e koeficientit R, për çdo vendburim pas zbritjes së vlerave të mësipërme.

Në auditimet pasuese, mos paraqitja e dokumentacionit nga kontraktori duhet të konsiderohet si thyerje e Marrëveshjes Hidrokarbure.

Albpetrol SHA duhet të ndjekë me rigoroze zbatimin e programeve vjetore si dhe monitorime të vazhdueshme gjatë zbatimit të marrëveshjeve, në mënyrë që veprimet e mundshme abuzive të kontraktorëve të reflektohen që në momentin e paraqitjes së raporteve mujore apo 3 mujore.

#### **Menjëherë dhe në vazhdimësi**

#### **24. Gjetje nga auditimi:**

Spektori i Monitorim-Supervizimit pranë Drejtorisë së Marrëveshjes Hidrokarbure (“SMSMH”), në zbatim të Rregullores së Brendshme si dhe bazuar në nenin 12, artikulli 8, të Marrëveshjes Hidrokarbure, “Për Zhvillimin dhe Prodhimin e Hidrokarbureve në vendburimin P”, lidhur midis shoqërisë Albpetrol SHA, dhe kontraktorit, ka përpiluar një relacion mbi ujin e prodhuar së bashku me naftën, ujin e prodhuar nga pusët e konvertuar për prodhim të ujit teknik, dhe destinacionin e përdorimit të këtyre ujërave.

-Nga 37 puse gjithsej që kontraktori ka përdorur për prodhimin e ujit teknologjik, vetëm 12 prej tyre rezultojnë me leje të miratuara nga Këshilli i Basenit Ujor Seman. “3 puse rezultojnë pa leje.

-Por edhe 12 pusët të cilët tani rezultojnë të pajisur me leje fillimisht janë shfrytëzuar pa leje për prodhimin e ujit teknologjik, për një periudhë që ka variuar nga 21 deri në 30 muaj.

-Pusi 470-P, vazhdon të jetë në inventarin e “Albpetrol” SHA, nga ana tjetër, prej muajit Shkurt 2015, shfrytëzohet nga ana e kontraktorit për prodhimin e ujit teknologjik.

“Albpetrol” SHA, nuk ka mundur të ushtrojë autoritetin që i jep M-H dhe L-M si palë, për vlerësimin dhe zhvillimin e zonave të kontratave, duke pranuar dhe miratuar në vazhdimësi, të gjitha aktivitetet e realizuara nga kontraktori, të cilat në përgjithësi kanë qenë nga viti në vit me devijime të theksuara nga Marrëveshja Hidrokarbure dhe planet përkatëse të zhvillimit, si dhe monitorimi është larg të qenit efikas (*Trajtuar më hollësisht në pikën 9, të Raportit Përfundimtar*).

#### **Rekomandim:**

Albpetrol SHA në bashkëpunim me AKBN të ushtrojë autoritetin që i jep M-H dhe L-M si palë, për vlerësimin dhe zhvillimin e zonave të kontratave, duke monitoruar dhe audituar në vazhdimësi, të gjitha aktivitetet e realizuara nga kontraktori, të marrin masat për njoftimin e Kontraktorit, në kushtet e devijimit material në përputhje me nenin 8, Pika 8.3 të marrëveshjes hidrokarbure, si dhe pikën 7. 2. iii, c, të licencë marrëveshjes dhe zbatimin e ligjit nr. 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore” për pajisjen lejeve administrative të lëshuar nga organet e administrimit dhe menaxhimit të burimeve ujore, për shfrytëzimin e puseve të ujit në zonën e kontratës.

*Menjëherë dhe në vazhdimësi*

#### **25. Gjetje nga auditimi:**

Gjatë periudhës të “Testimit” të puseve, Gusht 2017 deri në Dhjetor 2017, u vendosën puse përkatës në “Testim” për më shumë se një herë në muajt e ndryshëm. Nga vrojtimi i tyre u konstatua se për çdo “Testim”, rezultuan debite të ndryshme të naftës bruto.

Nisur nga ky fakt, Sektori analizoi të dhënat e rregjimit të puseve dhe konstatoi se në muajin përkatës rregjimi i puse është i ndryshëm, si dhe është rritur sasia e ujit (uji i cili vjen si rezultat i prodhimit të naftës).-shtojca 6 me treguesit kryesor të analizës sipas puseve përkatës.

Gjithashtu Sektori bëri një krahasim të “testimit”, me “Testimin” e kryer në vitin 2015, rezultoi se debite e naftës së matur në të dyja periudhat janë të ndryshme. Në fakt pusët e “Testuar” kanë rënie të prodhimit të naftës.

Sasia 193.30 m<sup>3</sup> naftë bruto e prodhimit të deklaruar në Progres Raport, (për periudhën Gusht 2017 deri më Dhjetor 2017), e cila përbën devijim të prodhimit të raportuar përbën një prodhim të vjetor rreth 9.5 % të prodhimit të përgjithshëm. Ky veprim ka shkaktuar pasoja të financiare për shtetin dhe bazuar në nenin 24, pika 24.2.1, të Marrëveshjes Hidrokarbure “Mbyllja” si dhe nenin 24, pika 24. 1. a të Licencë Marrëveshjes “E drejta e AKBN për t’a përfunduar marrëveshjen”, ka kryer raportime fallco, pra devijim material. Nga ana e “Albpetrol” SHA dhe AKBN nuk është bërë njoftimi përkatës për korrigjim dhe për përfundim të marrëveshjes sipas përcaktimeve të mësipërme në Marrëveshje Hidrokarbure dhe Licencë-Marrëveshje.

Sa më sipër për vitin 2017, duhet të merreshin masat për reflektimin në të ardhurat e kontraktorit të diferencës së naftës në sasinë rreth 9.5 % të prodhimit të naftës bruto.

“Albpetrol” SHA, dhe AKBN, duhet të kishin ndjekur hapat ligjorë sipas përcaktimeve në Marrëveshjen Hidrokarbure dhe në Licencë Marrëveshje për korrektimin e sasive të naftës sipas rezultateve të testimit, si dhe të bëheshin paralajmërimet përkatëse për devijim material dhe ndërprerje të marrëveshjes, në përputhje me nenin 24, pika 24.2.1 të Marrëveshjes Hidrokarbure “Mbyllja” si dhe nenin 24, pika 24. 1. a të Licencë Marrëveshjes “E drejta e AKBN për t’a përfunduar marrëveshjen” ku përcaktohet: “AKBN ka të drejtën të përfundojë këtë Licencë-Marrëveshje, në rast se ndonjëra nga palët që përbëjnë të licencuarin dorëzon me dijeni në AKBN deklarata fallco të cilat përbëjnë një konsideratë material për përfundimin dhe/ose ekzekutimin e kësaj Licencë-Marrëveshje. Nga ana e Albpetrol SHA, dhe AKBN duhet të merrte masat e duhura për njoftimin e kontraktorit për thyerjen e

marrëveshjes dhe mbylljen e marrëveshjes dhe nëse kontraktori nuk reflektonte mbi devijimet, mbylljen e saj, sipas përcaktimeve të mësipërme (*Trajtuar më hollësisht në pikën 9, të Raportit Përfundimtar*).

#### **Rekomandim:**

Nga Këshilli Mbikëqyrës të shqyrtohet efektiviteti i investimet e kryera nga viti 2013 e në vazhdim në DMH, organika e personelit e Drejtorisë së Marrëveshjeve Hidrokarbure, në raport me organikën totale të administratës dhe në veçanti për sektorët e dubluar (si juridik, ekonomik etj), rezultateve të arritura nga kjo drejtori, si dhe të merret vendimi përkatës.

*Deri më datë 31.03.2019*

#### **26. Gjetje nga auditimi:**

Në zbatim të M-H nga “Albpetrol” SHA konstatohet një qëndrim inferioriteti, paaftësie apo dëshire në vijueshmërin e monitorimit/supervizimin dhe auditimin, pamvarësisht disfavorit të formulimit të kushteve të marrëveshjes, nuk është vepruar në mënyrë rigoroze në zbatimin të Marrëveshjes Hidrokarbure si “Palë” në zbatim të: paragrafit 7 të parathënies: *Kontraktori do të bashkohet me Albpetrolin në kryerjen e Operacioneve Hidrokarbure dhe bëhet palë në Licensë Marrëveshje, dhe për qëllime që lidhen me atë*, pra Kontraktori bëhet palë në Operacionet Hidrokarbure, jo pronar i vendburimit.

Në interpretimin të pikës 1.11, 1.26, 1.40, 1.41 e 1.54 , e në zbatim të Licensë Marrëveshje të datës 7 Qershor, 2004, “Albpetrol“ SHA, drejton Operacionet Hidrokarbure në Zonën e Kontratës. Pra në vendburimin e P deri në Pikën e Lëvrimt/Matjes “Albpetrol” SHA nuk duhet thjesht të inspektojë/auditojë/vëzhgojë por është palë në kryerjen e Operacioneve Hidrokarbure, dhe nëse Kontraktori në mënyrë të përsëritur ka kryer një shkelje materiale të detyrave dhe detyrimeve të tij themelore sipas kësaj Marrëveshje Hidrokarbure dhe është këshilluar, me synimin e “Albpetrol” SHA, për mbylljen e kësaj Marrëveshje Hidrokarbure. Ky njoftim i mbylljes nga “Albpetrol” SHA do ti jepet vetëm nëse Kontraktori me marrjen e njoftimit që veprimtaria e tij është në shkelje materiale dhe nuk korrigjon ose nuk është angazhuar të korrigjojë në mënyrë substanciale këtë shkelje brenda gjashtë (6) muajsh. (pika 2.1 e nenit 24), (*Trajtuar më hollësisht në pikën 9, të Raportit Përfundimtar*).

#### **Rekomandim:**

Albpetrol SHA si palë në Marrëveshjen Hidrokarbur e Licencë Marrëveshje në kryerjen e Operacioneve Hidrokarbure, kur Kontraktori kryen shkelje materiale të detyrave dhe detyrimeve të tij themelore sipas Marrëveshje Hidrokarbure e L-M, dhe është këshilluar për këto shkelje, të njoftojë kontraktorin që veprimtaria e tij është në shkelje materiale dhe nuk korrigjon ose nuk është angazhuar të korrigjojë në mënyrë substanciale këtë shkelje brenda gjashtë (6) muajsh. i mbylljes së Marrëveshjes-Hidrokarbure nga Albpetrol SHA.

*Menjëherë dhe në vazhdimësi*

#### **27. Gjetje nga auditimi:**

Nga raportimet e bëra nga kontraktori pranë AKBN, rezulton se i pasqyron asetet që ka në përdorim si asete të vetat në kundërshtim me nenin 17.2 të Licencë-Marrëveshjes.

Në lidhje me korrigjimin e aseteve të rikuperuara në pasqyrat financiare si dhe në raportimet e tjera, kontraktori propozon që të vendoset një shënim në pasqyrat financiare për asetet të cilat janë pronë e shtetit shqiptar, por nuk pranon t'i çregjistrojë ato nga pasqyrat e veta financiare.

-Sa më sipër, kërkohet mendim nëse kontraktori po vepron në kundërshtim të pikës 17.2 të Licencë-Marrëveshjes dhe për pasojë a është në konsumim të pikës 24.1 të Licencë-Marrëveshjes.

-Në rast të mospërmbushjes së detyrimit të mësipërm kontraktual nga kontraktori, informohet se AKBN do të veprojë në përputhje me nenin 24.1 “E drejta e AKBN për t’a përfunduar” pika (a) “*dorëzon me dijëni në AKBN deklarata fallco të cilat përbëjnë një konsideratë materiale për përfundim dhe/ose ekzekutimin e kësaj Licencë-Marrëveshje*”.

Me shkresën nr.199 prot., datë 10.01.2018, “Albpetrol” SHA i përgjigjet kontraktorit, në lidhje marrjen e miratimit me shkrim për vendosjen e asetëve si kolateral dhe i drejtohet AKBN, për dijëni MIE. Kontraktori shpjegon se kompania “Mëmë” kërkon të marrë një kredi për një shumë 110 (njëqind e dhjetë) milion dollarë amerikanë, dhe se kontraktori do të garantojë kredihënësinë nëpërmjet hipotekimit të inventarit dhe të drejtat e tij në zbatim të M-H (në këtë rast kontraktori i referohet termit; në zbatim të “A.A.”, dhe se këtë kredi që kërkon të marrë do ta shfrytëzojë për të paguar një kredi ekzistuese që e ka marrë prej datës ... (të cilës i referohet si “...”), dhe se kredia ekzistuese “...”, është përdorur për të paguar një kredi tjetër të marrë më parë nga kontraktori:

Kontraktori, ka përcjellë pranë shoqërisë “Albpetrol” SHA, me nr... prot., datë ... (Njoftim), ku njofton se ka nënshkruar kontratën me “...” Ltd më datë ... (Contract Assignment), sipas të cilës i kalon të gjitha të drejtat, benefitet, interest qoftë të tashme apo të ardhshme, pasurore apo kontraktuale të lindura nga Marrëveshja Hidrokarbure dhe Licensë Marrëveshja (Trajtuar më hollësisht në pikën 9, të Raportit Përfundimtar).

***Menjëherë dhe në vazhdimësi***

### **Rekomandim:**

Albpetrol SHA, të kërkojë nga kontraktori, ashtu dhe nga kontraktorët e tjerë të cilët zbatojnë marrëveshje hidrokarbure, informacion të detajuar mbi asetet e përfshira si vlerë në kostot hidrokarbure të cilat mund të jenë përdorur si kolateral për kreditim, me synim parandalimin e humbjeve në raste të tërheqjes së mundshme të Kontraktorëve nga marrëveshjet hidrokarbure. “Albpetrol” SHA, duhet të marrë vendime konformë përcaktimeve në marrëveshjet hidrokarbure, duke zbritur vlerën e këtyre asetëve e cila është përfshirë në koston e operacioneve hidrokarbure, si dhe të rillojarisë vlerën e koeficientit R i cili duhet të rezultojë më i lartë, si pasojë e zvogëlimit të vlerës së kostos hidrokarbure.

## **B1. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**

### **1. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Rehabilitimi i sistemit të injektimit të ujërave në St.Dek. , pusët dhe grupet e vendburimit C dhe Sek.Dek. , të QPN Ballsh”, me fond limit 63,673,380 lekë pa TVSH, datë zhvillimi tenderi 27.11.2017, sipas Urdhërit të Prokurimit të titullarit të autoritetit kontraktor nr. 7224 Prot., datë 30.10.2017, është konstatuar se, vlera prej 1,725,092 lekë përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të kompanisë “Albpetrol SHA. Kjo vlerë ka ardhur si rezultat i përlllogaritjes gabim të vlerës së fondit limit, në kundërshtim kjo me nenin 28 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 59 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe VKM Nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”, ku personat përgjegjës janë ish Administratori i institucionit Z.E.P., në cilësinë e personit përgjegjës që ka bërë miratimin e vlerës së fondit limit, si dhe Ing. B. Q., Ing. B. L., A. H., Ing. A.S., P.B., Ing. A. B., Ing. R. G., Ing. V. P. në cilësinë e personave përgjegjës të cilët i kanë propozuar titullarit të AK marrjen e vendimit për miratimin e vlerës së fondit limit, si dhe kanë bërë përlllogaritjet përkatëse (Trajtuar më hollësisht në pikën 7, të Raportit Përfundimtar).

**Rekomandimi:**

Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës prej 1,725,092 lekë, përkatësisht nga personi/at përgjegjës, të cilët kanë shkaktuar dëm ekonomik ndaj buxhetit të kompanisë Albpetrol SHA. si rrjedhojë e përlllogaritjes gabim të vlerës së fondit limit.

**Menjëherë**

**2. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Blerje lëndë djegëse me përmbajtje squfuri jo më tepër se 1% ndaj peshës”, me fond limit 74,889,746 lekë pa TVSH, datë zhvillimi tenderi 10.04.2017, sipas Urdhërit të Prokurimit të titullarit të autoritetit kontraktor nr. 364 Prot., datë 13.03.2017, është konstatuar se, vlera prej 7,841,010 lekë përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të kompanisë “Albpetrol SHA. Kjo vlerë ka ardhur si rezultat i përlllogaritjes gabim të vlerës së fondit limit, në kundërshtim kjo me nenin 28 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 59 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe mbi parregullsinë e konstatuar në këtë përlllogaritje (sqsuar hollësishtë më sipër), ku personat përgjegjës për shkaktimin e dëmit të mësipërm ekonomik janë A. C., L. Xh., A. M., në cilësinë e anëtarëve të grupit të përlllogaritjes së vlerës së fondit limit (*Trajtuar më hollësishtë në pikën 7, të Raportit Përfundimtar*).

**Rekomandimi:**

Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës prej 7,841,010 lekë, përkatësisht nga personi/at përgjegjës, konkretisht nga anëtarët e komisionit të përlllogaritjes së vlerës së fondit limit të cilët kanë shkaktuar dëm ekonomik ndaj buxhetit të kompanisë Albpetrol SHA si rrjedhojë e përlllogaritjes gabim të vlerës së fondit limit, edhe si pasojë e parregullsisë së ndjekur në përlllogaritjen e tij. Drejtimi i AK, të ngrejë një grup pune të veçantë për evidentimin e të gjithë personave përgjegjës.

**Menjëherë**

**3. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Blerje lëndë djegëse me përmbajtje squfuri jo më tepër se 1% ndaj peshës”, me fond limit 74,889,746 lekë pa TVSH, datë zhvillimi tenderi 10.04.2017, sipas Urdhërit të Prokurimit të titullarit të autoritetit kontraktor nr. 364 Prot., datë 13.03.2017, për kontratën nr. 364/11 Prot., datë 21.04.2017, me marzh fitimi 37%, si dhe në vlerë absolute 30.087 lekë/kg, është konstatuar se, vlera prej 22,120,571 lekë përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të kompanisë “Albpetrol SHA, Kjo vlerë ka ardhur si rezultat i mos zbatimit të kontratës, në kundërshtim me kushtet e rëna dakort midis palëve, si dhe malli i marrë në dorëzim nuk plotëson specifikimet teknike, pjesë e kontratës dhe dokumenteve të tenderit, dhe e përfituar padrejtësisht nga kontraktori (*Trajtuar më hollësishtë në pikën 7, të Raportit Përfundimtar*).

**Rekomandimi:**

Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës prej 22,120,571 lekë, përkatësisht nga kontraktori “R.” SHPK, si rrjedhojë e mos zbatimit të kushteve të kontratës së rënë dakort midis palëve dhe specifikimeve teknike.

**Menjëherë**

#### **4. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Blerje lëndë djegëse me përmbajtje squfuri jo më tepër se 1% ndaj peshës” shtesë kontrate, me fond limit 14,928,002 lekë pa TVSH, datë zhvillimi tenderi 24.10.2017, sipas Urdhërit të Prokurimit të titullarit të autoritetit kontraktor nr. 1488 Prot., datë 23.10.2017, për kontratën nr. 1588/5 Prot., datë 24.10.2017, me marzh fitimi 37%, si dhe në vlerë absolute 30.087 lekë/kg, është konstatuar se, vlera prej 17,913,602 lekë përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të kompanisë “Albpetrol SHA Kjo vlerë ka ardhur si rezultat i mosdokumentimit të përlogaritjes së vlerës së fondit limit, në kundërshtim kjo me nenin 28 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 59 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, mosargumentimin dhe mosdokumentimin e përdorimit të procedurës me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, si dhe marrjen e mallit në kundërshtim me kushtet e kontratës dhe specifikimet teknike (sqaruar hollësisht në material), ku personat përgjegjës janë, Znj. M. L., Z. E. L., Znj. L. M., Ing. B. L. dhe Ing. B. Q., si dhe z. E.A. në cilësinë e personit përgjegjës që ka bërë miratimin e vlerës së fondit limit dhe ka nënshkruar kontratën midis palëve, si dhe edhe z.E.P. në cilësinë e Administratorit të shoqërisë Albpetrol SHA, si dhe kontraktori lidhur me mospërmbushjen e detyrimeve kontraktuale për mallin e dorëzuar, lidhur me dëmin ekonomik të shkaktuar ndaj buxhetit të kompanisë *(Trajtuar më hollësisht në pikën 7, të Raportit Përfundimtar)*.

#### **Rekomandimi:**

Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës prej 17,913,602 lekë, përkatësisht nga kontraktori “R.” SHPK, i cili ka shkaktuar dëm ekonomik ndaj buxhetit të kompanisë Albpetrol SHA, si rrjedhojë e dorëzimit të mallit në kundërshtim me kushtet e kontratës dhe specifikimet teknike, pjesë e kontratës së nënshkruar midis palëve dhe dokumenteve të tenderit.

**Menjëherë**

#### **5. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Blerje lubrifikante”, me fond limit 19,418,500 lekë pa TVSH, datë zhvillimi tenderi 20.07.2018, sipas Urdhërit të Prokurimit të titullarit të autoritetit kontraktor nr. 5347 Prot., datë 26.06.2018, për kontratën me vlerë 20,684,400 lekë me TVSH, është konstatuar se, vlera prej 675,600 lekë përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të kompanisë “Albpetrol SHA Kjo vlerë ka ardhur si rezultat i përlogaritjes gabim të vlerës së fondit limit, në kundërshtim kjo me nenin 28 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 59 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar *(Trajtuar më hollësisht në pikën 7, të Raportit Përfundimtar)*.

#### **Rekomandimi:**

Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës prej 675,600 lekë, përkatësisht nga të gjithë personat përgjegjës, të cilët kanë shkaktuar dëm ekonomik ndaj buxhetit të kompanisë Albpetrol SHA si rrjedhojë e përlogaritjes gabim të vlerës së fondit limit. Drejtimi i AK, të ngrejë një grup pune, si dhe të bëjë evidentimin e të gjithë personave përgjegjës, të cilët kanë bërë përlogaritjen dhe miratimin e vlerës së fondit limit.

**Menjëherë**

## **6. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Blerje tubo pompe kompresori”, me kontratë furnizimi mallrash nr. 697/14 prot., datë 25.09.2017, me vlerë kontrate 31,845,672 lekë, me afat lëvrimiti malli brenda 60 ditëve nga data e lidhjes së kontratës, është konstatuar se, vlera prej 350,295 lekë përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të kompanisë “Albpetrol SHA. Kjo vlerë ka ardhur si rezultat i mos mbajtjes së penalteteve sipas kushteve të kontratës, për dorëzimin e mallit me vonesë, në kundërshtim kjo me kushtet e rëna dakord midis palëve (*Trajtuar më hollësisht në pikën 7, të Raportit Përfundimtar*).

### **Rekomandimi:**

Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës prej 350,295 lekë, përkatësisht nga kontraktori “V.” SHPK, i cili ka shkaktuar dëm ekonomik ndaj buxhetit të kompanisë Albpetrol SHA si rrjedhojë e mos mbajtjes së penalteteve dhe dorëzimit të mallit me vonesë, në kundërshtim me kushtet e kontratës.

**Menjëherë**

## **7. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Blerje lëndë djegëse solar”, me fond limit 93,913,750 lekë pa TVSH, datë zhvillimi tenderi 13.02.2018, sipas Urdhërit të Prokurimit të titullarit të autoritetit kontraktor nr. 243 Prot., datë 11.01.2018, për kontratën Nr. 243/11 prot., datë 19.03.2018 me marzh fitimi 23% ose 19.98 lekë, është konstatuar se, vlera prej 6,439,800 lekë përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të kompanisë Albpetrol SHA, Kjo vlerë ka ardhur si rezultat i përlogaritjes gabim të vlerës së fondit limit, në kundërshtim kjo me nenin 28 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 59 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar (*Trajtuar më hollësisht në pikën 7, të Raportit Përfundimtar*).

### **Rekomandimi:**

Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës prej 6,439,800 lekë, përkatësisht nga të gjithë personat përgjegjës, të cilët kanë shkaktuar dëm ekonomik ndaj buxhetit të kompanisë Albpetrol SHA. si rrjedhojë e përlogaritjes gabim të vlerës së fondit limit. Titullari i AK, të ngrejë një grup pune, si dhe të bëjë evidentimin e të gjithë personave përgjegjës, të cilët kanë bërë përlogaritjen dhe miratimin e vlerës së fondit limit në kundërshtim me ligjin.

**Menjëherë**

## **8. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Blerje lëndë djegëse solar”, me fond limit 93,913,750 lekë pa TVSH, datë zhvillimi tenderi 13.02.2018, sipas Urdhërit të Prokurimit të titullarit të autoritetit kontraktor nr. 243 Prot., datë 11.01.2018, për kontratën Nr. 243/11 prot., datë 19.03.2018 me marzh fitimi 23% ose 19.98 lekë, është konstatuar se, vlera prej 19,561,342 lekë përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të kompanisë “Albpetrol SHA Kjo vlerë ka ardhur si rezultat i mos zbatimit të kushteve të kontratës, si dhe marrjes në dorëzim të mallit i cili nuk është sipas specifikimeve teknike, nuk plotësohen pothuajse të gjitha specifikimet teknike, në kundërshtim kjo me nenin 23, 60 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe kontratën e nëshkruar midis palëve dhe specifikimeve teknike, ku personat përgjegjës janë, K.B.në cilësinë e titullarit të AK, i

cili ka lidhur kontratën midis palëve, Z. D. H., Znj. A. D., dhe Z. A. M. në cilësinë e personave përgjegjës të cilët kanë marrë në dorëzim mallin, Z. E. M. në cilësinë e Drejtorit të QASHNG që ndjek edhe kontratën, si dhe të gjithë personat përgjegjës të Drejtorisë së Financës, të cilët kanë bërë pagesat për faturat e mësipërme, dhe kontraktori (*Trajtuar më hollësisht në pikën 7, të Raportit Përfundimtar*).

**Rekomandimi:**

Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës prej 19,561,342 lekë, përkatësisht nga kontraktori “R.” SHPK, i cili ka shkaktuar dëm ekonomik ndaj buxhetit të kompanisë Albpetrol SHA si rrjedhojë e mos zbatimit të kushteve të kontratës dhe specifikimeve teknike, pasi nuk është dorëzuar malli i prokuruar dhe për të cilin është shpallur fitues.

**Menjëherë**

**9. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi i ushtruar për zbatimin e kontratës së lidhur me objekt: “Remont sistemi elektrik të sondave elektrike QPN Patos dhe QPN Kucovë”, sipas kontratës së nënshkruar 3181/11 Prot., datë 20.07.2018, me vlerë 15,048,000 lekë, është konstatuar dëm ekonomik në vlerën 481,536 lekë, si rezultat i mos mbajtjes së penalteteve, sipas kontratës së nënshkruar midis palëve, ku personat përgjegjës janë Z. K.B.në cilësinë e titullarit të AK, si dhe personit përgjegjës që ka nënshkruar kontratën midis palëve, i gjithë grupi i marrjes në dorëzim dhe kolaudit të mallit konkretisht A. Z., J. K., H. Gj., D. H., A. C., kontraktori, si dhe personat përgjegjës të Drejtorisë së Financës të cilët kanë bërë pagesën dhe kontraktori (*Trajtuar më hollësisht në pikën 7, të Raportit Përfundimtar*).

**Rekomandimi:**

Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës prej 481,536 lekë, përkatësisht nga kontraktori “A. E.” SHPK, i cili ka shkaktuar dëm ekonomik ndaj buxhetit të kompanisë Albpetrol SHA si rrjedhojë e mos zbatimit të kushteve të kontratës dhe specifikimeve teknike, si dhe mos mbajtjes së penalteteve.

**Menjëherë**

**10. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Blerje lëndë e parë dhe materiale ndihmëse për fonderinë në QMN Kucovë”, sipas kontratës së lidhur nr. 2613/11 prot., datë 21.06.2018, është konstatuar se, vlera prej 5,109,600 lekë përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të kompanisë “Albpetrol SHA Kjo vlerë ka ardhur si rezultat i mos zbatimit të kushteve të kontratës, si dhe marrjes në dorëzim të mallit i cili nuk është sipas specifikimeve teknike, në kundërshtim kjo me nenin 23, 60 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe kontratën e nënshkruar midis palëve dhe specifikimeve teknike, ku personat përgjegjës janë, z. K.B.në cilësinë e titullarit të AK, si dhe të gjithë anëtarët e grupit të kolaudit dhe marrjes në dorëzim të mallit konkretisht M. B., K. F. dhe B. R., dhe kontraktori (*Trajtuar më hollësisht në pikën 7, të Raportit Përfundimtar*).

**Rekomandimi:**

Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës prej 5,109,600 lekë, përkatësisht nga kontraktori “A.” SHPK, i cili ka shkaktuar dëm ekonomik ndaj buxhetit të kompanisë Albpetrol SHA, si rrjedhojë e mos zbatimit të kushteve të kontratës dhe specifikimeve



teknike, si dhe nuk ka dorëzuar në AK mallin e prokuruar, për të cilën ka nënshkruar kontratën përkatëse.

**Menjëherë**

### **11. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Blerje prokate çeliku”, me fond limit 10,862,200 lekë pa TVSH, datë zhvillimi tenderi 11.04.2018, sipas Urdhërit të Prokurimit të titullarit të autoritetit kontraktor nr. 4916 Prot., datë 08.06.2018, për kontratën nr. 2456 Prot., datë 16.03.2018, është konstatuar se, vlera prej 2,268,360 lekë përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të kompanisë Albpetrol SHA. Kjo vlerë ka ardhur si rezultat i vlerësimit të gabuar të ofertave pjesëmarrëse, në kundërshtim kjo me nenin 53/3 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku personat përgjegjës janë B. L., V. Sh., D. F. në cilësinë e anëtarëve të KVO, si dhe K.B.në cilësinë e titullarit të AK, i cili ka bërë edhe miratimin e raportit përmbledhës (*Trajtuar më hollësisht në pikën 7, të Raportit Përfundimtar*).

### **Rekomandimi:**

Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës prej 2,268,360 lekë, përkatësisht nga të gjithë personat përgjegjës, të cilët kanë shkaktuar dëm ekonomik ndaj buxhetit të kompanisë Albpetrol SHA, si rrjedhojë e vlerësimit të gabuar të ofertave pjesëmarrëse.

**Menjëherë**

### **12. Gjetje nga auditimi:**

Për periudhën 01.01.2017 deri më 31.07.2018, kanë përfutuar shpërblim për titullin doktor i shkencave, master shkencor dhe master profesional, 10 punonjës në shumën totale 1,388,500 lekë. Këto pagesa janë përfutuar padrejtësisht, në kundërshtim me VKM nr. 545, datë 11.08.2011 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve...” duke i shkaktuar buxhetit të shoqërisë dëm ekonomik në shumë prej 1,388,500 lekë. Nga administratori aktual është nxjerrë vendim për ndërprerjen e këtyre shpërblimeve dhe kthimin e tyre nga punonjësit përfitues.

Veprim i cili ngarkon me përgjegjësi ish administratorin e shoqërisë z. E.P. (*Trajtuar më hollësisht në pikën 3, të Raportit Përfundimtar*).

### **Rekomandimi:**

Nga administratori i Shoqërisë Albpetrol SHA, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i shumës 1,388,500 lekë nga punonjësit përfitues.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

### **13. Gjetje nga auditimi:**

Janë dhënë shpërblime për anëtarët e Këshillit Tekniko-Shkencor i Albpetrol SHA, sipas vendimit të Administratorit nr. 365, datë 02.12.2013, z. E.P.. Pagesa të tilla të kryera në periudhën janar 2017-korrik 2018 për këshillat teknike bien në kundërshtim me Ligjin nr. 10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, dhe shuma prej 2,558,636 lekë përbën dëm ekonomik për buxhetin e shoqërisë. Këto shpërblime janë konstatuar si shkelje e disiplinës financiare edhe nga auditimet e mëparshme të KLSH dhe janë lënë dëm ekonomik për zhdëmtim nga përfituesit.

Veprim i cili ngarkon me përgjegjësi administratorin e shoqërisë z. E.P. (*Trajtuar më hollësisht në pikën 3, të Raportit Përfundimtar*).

**Rekomandimi:**

Nga administratori i Shoqërisë Albpetrol SHA, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykitimit për arkëtimin e shumës 2,558,636 lekë nga punonjësit përfitues.

**Menjëherë**

**14. Gjetje nga auditimi:**

Në lidhje me zbatimin e kontratës së ankandit për shitjen e naftës nga e cila sasia totale e shitur është 194,750,789 litra ose 194,750.8 ton. Nga kjo sasi e shitur 10,223.8 ton është shitur për eksport, ndërsa pjesa tjetër prej 184,527 ton është shitur për tregun e brendshëm. Referuar Dokumenteve Standarte të Ankandit dhe llogaritjes së formulës për shitjen e naftës konstatohet se, nga faturat e shitjes i janë zbritur tarifa e magazinimit 0.995 USD/bbl, tarifa e sigurimit në stokim dhe lëvizje 0.493USD/bbl, tarifa e ngrohjes për transport në anije 0.275USD/bbl dhe paga e operatorit për shkarkim në port 0.0068USD/bbl, pra në total 1.7698USD/bbl. Bazuar në sasinë totale të shitur për tregun e brendshëm janë zbritur shuma 2,054,104 USD (184,527\*1.7698USD/bbl). Në fakt siç u përmend dhe më sipër, nafta bruto është tërhequr nga shoqëria “ I.” SHA në pikat e lëvrimin në stacionet brenda Albpetrolit (Zharëz, Usojë, Visokë dhe Gorisht) dhe është transportuar për përpunim në tregun e brendshëm. Çmimit të fiksuar në ankand dhe në kontratën e shitblerjes prej 71 % e çmimit Brent, nuk duhet ti zbriteshin kostot e planifikuara të (transportit, magazinimit, stokimit, etj), nga stacionet e Albpetrolit deri në pikat e përpunimit por këtij çmimi duhet ti zbriteshin, vetëm kostot faktike të transportit nga stacionet e Albpetrolit.

Pra, për sasinë e shitur në tregun e brendshëm nga data 16.09.2017 deri në datën 26.09.2018 prej 184,527 Ton janë zbritur me të padrejtë shpenzime transporti në vlerën 2,054,104 USD të cilat nuk janë arkëtuar si të ardhura në llogaritë e Albpetrolit nga shitja e naftës, por janë përfituar padrejtësisht nga shoqëria blerëse “ I.” SHA.

Këto veprimet apo mosveprime bien në kundërshtim me Ligjin nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, neni 98, Ligjin nr.10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, nenet: 2, pikën 2 te nenit 3, pikën 9 të nenit 4, dhe pikën 1 të nenit 8. Përgjegjësia bie mbi Administratorin e Albpetrol SHA, z.E.P. dhe z. A.H. i cili ka nënshkruar kontratën e shitblerjes me shoqërinë blerëse “ I.” SHA pasi në këtë kontratë nuk është përcaktuar që, shpenzimet e magazinimit, stokimit, ngrohjes, ngarkimit, etj, do të zbriten nga çmimi i kontratave, në ato raste kur këto shpenzime do të kryhen faktikisht.

Veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi ish-Administratorin e Albpetrol SHA, z. E.P., z. A.H., dhe anëtarët e komisionit të shitjes së naftës (*Trajtuar më hollësisht në pikën 8, të Raportit Përfundimtar*).

**Rekomandimi:**

Shoqëria Albpetrol SHA në bashkëpunim me Këshillin Mbikëqyrës dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, të marrë masat e duhura duke ngritur grup pune të veçantë dhe të analizojë shkaqet, arsyet, për zbritjen e kostove të shpenzimeve të magazinimit, stokimit, ngrohjes dhe ngarkimit, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore për arkëtimin e shumës 2,054,104 USD, të përfituar padrejtësisht nga shoqëria “ I. SHA”, përkatësisht nga të gjithë personat përgjegjës të mësipërm.

**Menjëherë**

**15.Gjetje nga auditimi:**

-Albpetrol SHA gjatë vitit 2016-2017 i ka shitur produktin hidrokarbur, naftë bruto shoqërisë P. R. O. SHA, bazuar në kontratën me nr. 7805/15, datë 17.12.2016.

Në nenin nr. 5, "Të drejtat dhe detyrimet e kontraktuesit", pika 1, të kësaj kontrate, citohet se "Kontraktuesi duhet të paguajë detyrimin për blerjen e naftës bruto për sasi të përkatëse sipas grafikut të lëvrimin të përcaktuar në Aneksin nr.1, bashkëlidhur kësaj kontrate dhe të rënë dakord midis palëve, me transfertë bankare, në CASH, me letër krediti të parevokueshme, para fillimit të lëvrimin të secilës sasi." Në aneksin nr.1 janë përcaktuar afatet e tërheqjes së mallit, për gjatë periudhës së kontratës janë parashikuar të tërhiqen 14,000 ton naftë bruto në muaj, për dymbëdhjetë muaj sasinë totale prej 167,000 ton. Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se, blerësi në 5 muajt e parë ka tërhequr 67 % të sasisë së programuar. Lidhur me pagesat e kryera në shoqërinë Albpetrol SHA, u konstatua se kontraktuesi përveç një periudhe 1 javore në janar 2017, nuk e ka zbatuar asnjëherë kushtin e mësipërm të kontratës për pagesën e detyrimit para lëvrimin të secilës sasi. Për muajin shkurt detyrimi i shoqërisë P. R. O. SHA, ka qenë mesatarisht 450,000,000 lekë, për muajt e tjerë duke shkuar nga 719,000,000 lekë, në 1,042,000,000 lekë, dhe në fund të muajit dhjetor 2017, 51,000,000 lekë. Saldo debitore e shoqërisë deri më datën 19.10.2018 është rreth 25,000,000 lekë.

Theksojmë se, kontraktuesi e kishte tërhequr të gjithë sasinë e kontraktuar brenda muajit të nëntë, pra me faturën e fundit nr. 150, datë 14.09.2017, ishte lëvruar sasia prej 170,344 ton naftë dhe saldo debitore ndaj Albpetrol SHA ishte 434,000,000 lekë.

Të gjitha sasi të shitura janë kryer me urdhëra të administratorit, duke caktuar grupin e punës nga drejtoria e shitjes i përbërë nga znj. A. S., z. P. Dh., z. B. S., e znj. E. V..

Veprimet e grupit të punës për shitjen e naftës janë në kundërshtim me nenin nr.5.1, të kontratës dhe kanë krijuar rrisht për likuiditetin e shoqërisë si dhe mungesë të lëvrimin të fondeve nga kontraktori.

Mos kryerja e likuidimit të sasive të lëvruara të naftës është e parashikuar në pikën 5.10 të kontratës ku citohet se: "Në rast të mos kryerjes së pagesës sipas afateve të përcaktuara në këtë kontratë apo në rast të mos tërheqjes së sasisë së mallit sipas mënyrës (siç parashikohet në Aneksin nr.1), blerësi është dakord me penalitetet ditore që do të llogariten sipas Ligjit nr. 48/2014, "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare".

Bazuar në ligjin Nr.48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet Kontraktore e tregtare" Neni 5: "Llogaritja e Kamatëvonesës.... përqindja është 9.25 %.

Nga llogaritje të përafërta për një pjesë të detyrimit, interesat shkojnë rreth 40,200,000 lekë. Kjo vlerë përbën dëm ekonomik për shoqërinë.

Nga drejtoria e financës nuk janë llogaritur penalitetet sipas kushteve të kontratës.

Përgjegjësi për sa më sipër mban ish administratori i shoqërisë z.E.P. , si dhe anëtarët e komisionit të shitjes së naftës i përbërë nga znj. A. S., z. P. Dh., z. B. S., e znj. E. V., P.B. (Trajtuar më hollësisht në pikën 8, të Raportit Përfundimtar).

### **Rekomandimi:**

- Nga Këshilli Mbikëqyrës të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës prej 40,200,000 lekë. Nga auditi i brendshëm i shoqërisë të merren masa për llogaritjen e plotë të gjithë penaliteteve, të kontraktorit "P. R. O." SHA, për mos pagesat e faturave të blerjeve të naftës brenda afatit, si dhe nxjerrjen e përgjegjësive përkatëse, dhe masat për arkëtimin e tij.

**Menjëherë**

### **16. Gjetje nga auditimi:**

-Albpetrol SHA gjatë viteve 2017-2018 i ka shitur produktin hidrokarbur, naftë bruto shoqërisë I. SHA, bazuar në kontratën me nr. 5384/13, datë 15.09.2017. Në aneksin nr.1 të kësaj kontrate janë përcaktuar dhe afatet e tërheqjes së mallit, për gjatë periudhës së kontratës janë parashikuar të tërhiqen 17,000 ton naftë bruto në muaj. Nga verifikimi i dokumentacionit

të vënë në dispozicion u konstatua se blerësi në periudhën 16.02.2018 deri më 15.09.2018 nuk ka përmbushur detyrimet për tërheqjen e sasive sipas kontratës.

Shoqëria I. SHA nuk ka zbatuar kontratën për sasi të përcaktuara mes palëve. Mos tërheqja e sasive të kontraktuara ka shkaktuar vështirësi në likuiditetin financiar të shoqërisë Albpetrol SHA

Në pikën 5.9 të kontratës citohet se: “Në rast të mos kryerjes së pagesës sipas afateve të përcaktuara në këtë kontratë apo në rast të mos tërheqjes së sasisë së mallit sipas mënyrës (siç parashikohet në Aneksin nr.1), blerësi është dakord me penalitetet ditore që do të llogariten sipas Ligjit nr. 48/2014, “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”.

Përqindja e vendosur nga Këshilli Mbikqyrës i Bankës së Shqipërisë në mbledhjen e fundit të vitit 2017 për normat e interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjella të riblerjes (REPO dhe REPO të anasjella) është 1.25 %. Kësaj përqindje i shtohen dhe tetë pikë duke pasur një përqindje prej 9.25 %. Sasi të mëposhteme janë vlerësuar me çmimin mesatar të periudhës dhe duke llogaritur interesat ditore del vlera totale prej 55,326,000 lekë e cila përbën dëm ekonomik për shoqërinë.

Përgjegjësitë për mos llogaritjen e penaliteteve mban drejtoria e financës (*Trajtuar më hollësisht në pikën 8, të Raportit Përfundimtar*).

### **Rekomandimi:**

- Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës 55,326,000 lekë, nga Kontraktori “ I.” SHA, për mos respektimin e afateve të tërheqjes së sasive të naftës.

**Menjëherë**

### **17. Gjetje nga auditimi:**

Deri në fund të muajit Qershor 2018, (sipas të dhënave të Albpetrol SHA), detyrimet e Kontraktorëve të Marrëveshjeve Hidrokarbure ndaj Albpetrol SHA, janë në vlerën **28,890,345 USD**, detajuar si më poshtë:

**a.** Kontraktori, ka krijuar detyrime nga ndarja e prodhimit pjesë e “Albpetrol” SHA, deri me datë 31.07.2018, sasia e naftës bruto që është krijuar për likuidim është në sasinë 30,880.55 ton (referuar çmimit të shitjes së naftës nga kontraktori në tremujorin e parë 2018, është 351.54 USD/ton), llogaritet afërsisht në shumën **10,855,748.55 USD**, që është vlera monetare për pjesa PPE&PPA që i takon “Albpetrol” SHA, sipas M-H. (*Ku sasi 28,781.67 ton, përfaqson zbritjen e holluesit për PPE&PPA nga BPAL, dhe 2,098.88 ton pjesa PPE&PPA që i takon “Albpetrol” SHA, sipas M-H*).

**a.1.** Deri më datë 31.08.2018, kontraktori, nuk ka likuiduar “Albpetrol” SHA detyrimet e prapambetur financiare në vlerën **620,233 USD** në bazë dhe për zbatimin të Marrëveshjes Hidrokarbure. që lidhet me TVSH mbi Taksën e Rentës Minerare për PPE- në periudhën Gusht 2008-Nëntor 2010.

**b.** K.” SHA i detyrohet “Albpetrol” SHA, deri më 31 Gusht 2018, në total vlerë **9,018,955.14 USD** për; sasinë e kondesatit prej 1,664.78 ton kondesat (*detyrimi progresiv*) llogaritet afërsisht në shumën me vlerë afërsisht 399,547.20 USD,, dhe sasinë e gazit kondesat prej 17,238,815.88 Nm3 (*vendburimi Delvina*) me vlerë 8,619,407.94 USD, që janë vlerat monetare për pjesa PPE&PPA që i takon “Albpetrol” SHA, sipas M-H.

**c.** “T.” Ltd. ka krijuar detyrime nga ndarja e prodhimit pjesë e “Albpetrol”.SHA, deri me datë 31.07.2018, sasia e naftës bruto që është krijuar për likuidim është 13,542.12 ton (detyrimi progresiv) llogaritet afërsisht në shumën **4,760,596.87 USD**, (*nga të cilat -4,956.61 ton naftë detyrime nga vendburimi C-M; -25,387.58 ton naftë bruto detyrime nga vendburimi G-K dhe*

16,802.07 ton naftë bruto marrë më tepër nga detyrime nga vendburimi Ballsh Hekal), që është vlera monetare për pjesa PPE&PPA që i takon “Albpetrol” SHA, sipas M-H. .

**d.** “T” SHA ka krijuar detyrime nga ndarja e prodhimit pjesë e “Albpetrol”.SHA, deri me datë 31.07.2018, sasia e naftës bruto që është krijuar për likuidim është 5,440.93 ton naftë bruto (*detyrimi progresiv*) llogaritet afërsisht në shumën **1,912,704.53 USD**. (*detyrime nga vendburimi C-M; G-K dhe B H*), që është vlera monetare për pjesa PPE&PPA që i takon “Albpetrol” SHA, sipas M-H.

**e.** “P” SHA i detyrohet “Albpetrol” SHA, deri më 31 Gusht 2018, në total vlerë **1,076,847.63 USD** për; sasinë e gazit 795,914.71 Nm<sup>3</sup> gas (*detyrime nga vendburimi Frakull*) llogaritet afërsisht në shumën me vlerë afërsisht 397,957.36 USD dhe sasinë e naftës bruto prej 1,925.50 ton (*detyrime nga vendburimi Amonicë*) llogaritet afërsisht në shumën me vlerë 678,890.27 USD, që janë vlerat monetare për pjesa PPE&PPA që i takon “Albpetrol” SHA, sipas M-H.

**ë.** A” SHA ka krijuar detyrime nga ndarja e prodhimit pjesë e “Albpetrol”.SHA, deri me datë 31.07.2018, sasia e naftës bruto që është krijuar për likuidim është 1,581.33 ton naftë bruto (*detyrimi progresiv*) llogaritet afërsisht në shumën **555,907.78 USD** (*për vendburimin B-H*), që është vlera monetare për pjesa PPE&PPA që i takon “Albpetrol” SHA, sipas M-H.

**f.** “Sh” ka krijuar detyrime nga ndarja e prodhimit pjesë e “Albpetrol”.SHA, deri me datë 31.07.2018, sasia e naftës bruto që është krijuar për likuidim është 135.62 ton naftë bruto (*detyrimi progresiv*) llogaritet afërsisht në shumën **44,675.85 USD** (*për vendburimi K*), që është vlera monetare për pjesa PPE&PPA që i takon “Albpetrol” SHA, sipas M-H.

**h.** “F” SHA ka krijuar detyrime nga ndarja e prodhimit pjesë e “Albpetrol”.SHA, deri me datë 31.07.2018, sasia e naftës bruto që është krijuar për likuidim është 119.39 ton naftë bruto (*detyrimi progresiv*) llogaritet afërsisht në shumën **41,970.36 USD** (*nga të cilat për vendburimin P-M 114.30 ton dhe për vendburimin F K 5.09 ton*), që është vlera monetare për pjesa PPE&PPA që i takon “Albpetrol” SHA, sipas M-H., (*Trajtuar më hollësisht në pikën 9, të Raportit Përfundimtar*).

### **Rekomandim:**

“Albpetrol” SHA, të kërkojë në rrugë administrative duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme ligjore dhe të gjitha shkallët e gjykimit për vjeljen e detyrimit nga kontraktorët në marrëveshjet hidrokarbureme vlerë **28,890,345.20 USD**, për detyrimet e prapambetura të PPE&ASP (dhe TVSH për BPAL), detyrim i akumuluar gjatë periudhave të zbatimit të marrëveshjeve hidrokarbure në vendburimet respektive.

Në rast të mos shlyerjes dhe vazhdimit të akumulimit më tej të detyrimeve (për marrëveshjet në funksion), të bëhen njoftimet sipas përcaktimeve në marrëveshjet hidrokarbure për thyerje të marrëveshjeve dhe të merren masat përkatëse sipas afateve që përcaktohet në to, me synim vjeljen e detyrimeve të cilat do të përmirësojnë treguesit ekonomiko-financiar të Shoqërisë.

**Deri më datë 31.03.2019**

### **18. Gjetje nga auditimi:**

Në total, deri në datë 31.12.2017, kontraktorët e marrëveshjeve hidrokarbure i detyrohen “Albpetrol” SHA, për shërbime në total shumën **172,593,039 lekë** si më poshtë:

**a.** “K” SHA për detyrime të faturuara për shërbime dhe punime agregati, detyrim i faturuar papaguar për energjinë elektrike, detyrim i papaguar për llogari të: Q.M.N. Kuçovë, Q.F.M.T. Patos, Q. Gjeofizike Patos, Q.A.SH.N.G, Q.E.M.N.G etj, në zbatim të Marrëveshjes Hidrokarbure i detyrohet “Albpetrol” SHA, shumën **107,157,258 lekë**.

**b.** “T” SHA për detyrime të faturuara për shërbime dhe punime agregati, detyrim i faturuar papaguar për energjinë elektrike, detyrim i papaguar për llogari të: Q.M.N. Kuçovë, Q.F.M.T.

Patos, Q. Gjeofizike Patos, Q.A.SH.N.G, Q.E.M.N.G etj, në zbatim të Marrëveshjes Hidrokarbure i detyrohet “Albpetrol” SHA, shumën **56,765,536 lekë**.

c. “P” SHA për detyrime të faturuara në “Albpetrol” Sh.a., për shërbime dhe punime agregati, detyrim i faturuar papaguar për energjinë elektrike, detyrim i papaguar për llogari të: Q.M.N. Kuçovë, Q.F.M.T. Patos, Q. Gjeofizike Patos, Q.A.SH.N.G, Q.E.M.N.G etj, në zbatim të Marrëveshjes Hidrokarbure i detyrohet “Albpetrol” SHA, shumën **8,542,710 lekë**.

d. “D” SHA i detyrohet “Albpetrol” SHA, për detyrime të faturuara në “Albpetrol” Sh.a për shërbime dhe punime agregati, detyrim i faturuar papaguar për energjinë elektrike, detyrim i papaguar për llogari të: Q.M.N. Kuçovë, Q.F.M.T. Patos, Q. Gjeofizike Patos, Q.A.SH.N.G, Q.E.M.N.G etj, në zbatim të Marrëveshjes Hidrokarbure i detyrohet “Albpetrol” SHA, shumën **127,535 lekë** (*Trajtuar më hollësisht në pikën 9, të Raportit Përfundimtar*).

#### **Rekomandim:**

Albpetrol SHA, të kërkojë në rrugë administrativo ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme ligjore dhe të gjitha shkallët e gjykimit për vjeljen e detyrimit nga kontraktorët në marrëveshjet hidrokarbureme vlerë **172,593,039 lekë**, për detyrimet e shërbimeve të realizuara nga Albpetrol SHA, dhe të pa likjuar kontraktorët në marrëveshjet hidrokarbure. Në rast të mos shlyerjes dhe vazhdimit të akumulimit më tej të detyrimeve (për marrëveshjet në funksion), të bëhen njoftimet sipas përcaktimeve në marrëveshjet hidrokarbure për thyerje të marrëveshjeve dhe të merren masat përkatëse sipas afateve që përcaktohet në to, me synim vjeljen e detyrimeve të cilat do të përmirësojnë treguesit ekonomik-financiar të Shoqërisë.

**Deri më datë 31.03.2019**

## **B.2 TË ARDHURA TË MUNGUARA PËR SHOQËRINË (DËM EKONOMIK)**

### **1. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi i procedurës së dhënies me qira të objektit: “Salla e pompave, ish remonti kapital Marinëz”, është konstatuar se, vlera prej 2,561,400 lekë përbën të ardhur të munguar me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të kompanisë “Albpetrol SHA. Kjo vlerë ka ardhur si rezultat i mos arkëtimit të sipërfaqes reale të dhënë me qira, sipas kontratës të lidhur midis palëve nr. 690 Prot., datë 25.01.2018, ku personat përgjegjës janë ish Administratori i institucionit Z.E.P., i gjithë grupi i punës i cili i ka dorëzuar asetin qiramarrësit konkretisht A. N., E. T., A. P., V. K., L. T.. Gjithashtu, përgjegjësi mban edhe S.K., si personi përgjegjës në cilësinë e ish titullarit të QAR Patos si dhe Drejtorit Aktual të Administrimit dhe Kontrollit të Pronës në Albpetrol SHA dhe qiramarrësi (*Trajtuar më hollësisht në pikën 12, të Raportit Përfundimtar*).

#### **Rekomandimi:**

Të kërkohe në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës prej 2,561,400 lekë, përkatësisht nga qiramarrësi dhe personi përgjegjës i cili ka lidhur kontratën, të cilët kanë shkaktuar mos arkëtimin e vlerës së mësipërme, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të kompanisë Albpetrol SHA si rrjedhojë e dhënies me qira të një sipërfaqe prej 100 m<sup>2</sup>, ndërkohë që në fakt rezulton se kontraktori shfrytëzon të tërë sipërfaqen e mundshme. Strukturat drejtuese të shoqërisë të caktojnë një grup pune, për analizën e arsyeve dhe përgjegjësive të dëmit të shkaktuar, duke bërë njëkohësisht edhe evidentimin e të gjithë personave përgjegjës, si dhe të merren vendimet përkatëse.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

## **2. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi i procedurës së dhënies me qira të objektit: “Salla e pompave, ish remonti kapital Marinëz”, është konstatuar se, vlera prej 1,992,200 lekë përbën të ardhur të munguar me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të kompanisë “Albpetrol SHA Kjo vlerë ka ardhur si rezultat i mos arkëtimit të sipërfaqes reale të dhënë me qira, sipas kontratës të lidhur midis palëve nr. 3213 Prot., datë 08.05.2018, ku personat përgjegjës janë ish Adiministratori i institucionit Z.E.P. , si dhe i gjithë grupi i punës i cili i ka dorëzuar asetin qiramarrësit. Gjithashtu, përgjegjësi mban edhe S.K., si personi përgjegjës në cilësinë e ish titullarit të QAR Patos si dhe Drejtorit aktual të Administrimit dhe Kontrollit të Pronës në Albpetrol SHA dhe qiramarrësi (*Trajtuar më hollësisht në pikën 12, të Raportit Përfundimtar*).

### **Rekomandimi:**

Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës prej 1,992,200 lekë, përkatësisht nga qiramarrësi dhe personi përgjegjës i cili ka lidhur kontratën, të cilët kanë shkaktuar mos arkëtimin e vlerës së mësipërme, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të kompanisë Albpetrol SHA si rrjedhojë e dhënies me qira të një sipërfaqe prej 100 m2, ndërkohë që në fakt rezulton se kontraktori shfrytëzon të tërë sipërfaqen e mundshme. Strukturat drejtuese të shoqërisë të caktojnë një grup pune, për analizën e arsyeve dhe përgjegjësive të dëmit të shkaktuar, duke bërë njëkohësisht edhe evidentimin e të gjithë personave përgjegjës, si dhe të merren vendimet përkatëse.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

## **3. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi i procedurës së dhënies me qira të objektit: “Teto e traktorëve, ish QPN Marinëz”, është konstatuar se, vlera prej 2,095,500 lekë përbën të ardhur të munguar me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të kompanisë “Albpetrol SHA Kjo vlerë ka ardhur si rezultat i mos arkëtimit të sipërfaqes reale të dhënë me qira, sipas kontratës të lidhur midis palëve nr. 3854 Prot., datë 03.05.2018, ku personat përgjegjës janë Adiministratori i institucionit Z. K.B. , si dhe i gjithë grupi i punës i cili i ka dorëzuar asetin qiramarrësit. Gjithashtu, përgjegjësi mban edhe S.K., si personi përgjegjës në cilësinë e ish titullarit të QAR Patos si dhe Drejtorit Aktual të Administrimit dhe Kontrollit të Pronës në Albpetrol SHA si dhe qiramarrësi (*Trajtuar më hollësisht në pikën 12, të Raportit Përfundimtar*).

### **Rekomandimi:**

Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës prej 2,095,500 lekë, përkatësisht nga qiramarrësi dhe personi përgjegjës i cili ka lidhur kontratën, të cilët kanë shkaktuar mos arkëtimin e vlerës së mësipërme, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të kompanisë Albpetrol SHA si rrjedhojë e dhënies me qira të një sipërfaqe prej 200 m2, ndërkohë që në fakt rezulton se kontraktori shfrytëzon të tërë sipërfaqen e mundshme. Strukturat drejtuese të shoqërisë të caktojnë një grup pune, për analizën e arsyeve dhe përgjegjësive të dëmit të shkaktuar, duke bërë njëkohësisht edhe evidentimin e të gjithë personave përgjegjës, si dhe të merren vendimet përkatëse (*Trajtuar më hollësisht në pikën 12, të Raportit Përfundimtar*).

**Menjëherë dhe në vijimësi**

## **4. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi i procedurës së dhënies me qira të objektit: “Teto e traktorëve, ish QPN Marinëz”, është konstatuar se, vlera prej 10,058,400 lekë përbën të ardhur të munguar me

pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të kompanisë “Albpetrol SHA Kjo vlerë ka ardhur si rezultat i mos arkëtimit të sipërfaqes reale të dhënë me qira, sipas kontratës të lidhur midis palëve nr. 7094 Prot., datë 25.10.2017, ku personat përgjegjës janë ish Adiministratori i institucionit Z.E.P. , si dhe i gjithë grupi i punës i cili i ka dorëzuar asetin qiramarrësit. Gjithashtu, përgjegjësi mban edhe S.K., si personi përgjegjës në cilësinë e ish titullarit të QAR Patos si dhe Drejtorit aktual të Administrimit dhe Kontrollit të Pronës në Albpetrol SHA si dhe E. C., A. P., E. T., V. Gj., E. C. në cilësinë e personave përgjegjës të cilët kanë dorëzuar objektin jo sipas kushteve të kontratës dhe qiramarrësi *(Trajtuar më hollësisht në pikën 12, të Raportit Përfundimtar)*.

#### **Rekomandimi:**

Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës prej 10,058,400 lekë, përkatësisht nga qiramarrësi dhe personi përgjegjës i cili ka lidhur kontratën, të cilët kanë shkaktuar mos arkëtimin e vlerës së mësipërme, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të kompanisë Albpetrol SHA si rrjedhojë e dhënies me qira të një sipërfaqe prej 200 m2, ndërkohë që në fakt rezulton se kontraktori shfrytëzon të tërë sipërfaqen e mundshme. Strukturat drejtuese të shoqërisë të caktojnë një grup pune, për analizën e arsyeve dhe përgjegjësive të dëmit të shkaktuar, duke bërë njëkohësisht edhe evidentimin e të gjithë personave përgjegjës, si dhe të merren vendimet përkatëse.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

#### **5. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi i procedurës së dhënies me qira të objektit: “Teto”, që ndodhet në Patos, është konstatuar se, vlera prej 1,044,000 lekë përbën të ardhur të munguar me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të kompanisë “Albpetrol SHA Kjo vlerë ka ardhur si rezultat i mos arkëtimit të sipërfaqes reale të dhënë me qira, sipas kontratës të lidhur midis palëve nr. 2732 Prot., datë 23.03.2018, ku personat përgjegjës janë Administratori i institucionit Z. K.B. , si dhe i gjithë grupi i punës i cili i ka dorëzuar asetin qiramarrësit. Gjithashtu, përgjegjësi mban edhe S.K., si personi përgjegjës në cilësinë e Drejtorit aktual të Administrimit dhe Kontrollit të Pronës në Albpetrol SHA qiramarrësi, si dhe A. C. në cilësinë e ish Drejtorit të QFMT Patos dhe E. B. Drejtorit të QFMT Patos *(Trajtuar më hollësisht në pikën 12, të Raportit Përfundimtar)*.

#### **Rekomandimi:**

Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës prej 1,044,000 lekë, përkatësisht nga qiramarrësi dhe personi përgjegjës i cili ka lidhur kontratën, të cilët kanë shkaktuar mos arkëtimin e vlerës së mësipërme, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të kompanisë Albpetrol SHA si rrjedhojë e dhënies me qira të një sipërfaqe prej 60 m2, ndërkohë që në fakt rezulton se kontraktori shfrytëzon të tërë sipërfaqen e mundshme. Strukturat drejtuese të shoqërisë të caktojnë një grup pune, për analizën e arsyeve dhe përgjegjësive të dëmit të shkaktuar, duke bërë njëkohësisht edhe evidentimin e të gjithë personave përgjegjës, si dhe të merren vendimet përkatëse *(Trajtuar më hollësisht në pikën 12, të Raportit Përfundimtar)*.

*Menjëherë dhe në vijimësi*



## **6. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi i procedurës së dhënies me qira të objektit: “Teto”, që ndodhet në Patos, është konstatuar se, vlera prej 3,654,000 lekë përbën të ardhur të munguar me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të kompanisë “Albpetrol SHA Kjo vlerë ka ardhur si rezultat i mos arkëtimit të sipërfaqes reale të dhënë me qira, sipas kontratës të lidhur midis palëve nr. 6769 Prot., datë 13.10.2016, ku personat përgjegjës janë ish Administratori i institucionit Z.E.P. , si dhe i gjithë grupi i punës i cili i ka dorëzuar asetin qiramarrësit. Gjithashtu, përgjegjësi mban edhe S.K., si personi përgjegjës në cilësinë e Drejtorit aktual të Administrimit dhe Kontrollit të Pronës në Albpetrol SHA qiramarrësi, si dhe A. C. dhe E.SH. në cilësinë e ish Drejtorit të QFMT Patos dhe E. B. Drejtorit të QFMT Patos (*Trajtuar më hollësisht në pikën 12, të Raportit Përfundimtar*).

## **Rekomandimi:**

Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës prej 3,654,000 lekë, përkatësisht nga qiramarrësi dhe personi përgjegjës i cili ka lidhur kontratën, të cilët kanë shkaktuar mos arkëtimin e vlerës së mësipërme, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të kompanisë Albpetrol SHA si rrjedhojë e dhënies me qira të një sipërfaqe prej 60 m<sup>2</sup>, ndërkohë që në fakt rezulton se kontraktori shfrytëzon të tërë sipërfaqen e mundshme. Strukturat drejtuese të shoqërisë të caktojnë një grup pune, për analizën e arsyeve dhe përgjegjësive të dëmit të shkaktuar, duke bërë njëkohësisht edhe evidentimin e të gjithë personave përgjegjës, si dhe të merren vendimet përkatëse.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

## **7. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi i procedurës së dhënies me qira të objektit: “Një pjesë të tetosë së qymyrit”, është konstatuar se, vlera prej 1,020,000 lekë përbën të ardhur të munguar me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të kompanisë “Albpetrol SHA Kjo vlerë ka ardhur si rezultat i mos arkëtimit të sipërfaqes reale të dhënë me qira, sipas kontratës të lidhur midis palëve nr. 2530 Prot., datë 19.03.2018, ku personat përgjegjës janë Administratori i institucionit Z. K.B. , si dhe i gjithë grupi i punës i cili i ka dorëzuar asetin qiramarrësit, Xh. H. në cilësinë e Përgjegjësit Material, P. F. në cilësinë e shefit të sektorit. Gjithashtu, përgjegjësi mban edhe S.K., si personi përgjegjës në cilësinë e Drejtorit aktual të Administrimit dhe Kontrollit të Pronës në Albpetrol SHA qiramarrësi, si dhe A. C. në cilësinë e Drejtorit të QSHGJ dhe I. G. në cilësinë e ish Drejtorit në QSHGJ Patos (*Trajtuar më hollësisht në pikën 12, të Raportit Përfundimtar*).

## **Rekomandimi:**

Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës prej 1,020,000 lekë, përkatësisht nga qiramarrësi dhe personi përgjegjës i cili ka lidhur kontratën, të cilët kanë shkaktuar mos arkëtimin e vlerës së mësipërme, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të kompanisë Albpetrol SHA si rrjedhojë e dhënies me qira të një sipërfaqe prej 200 m<sup>2</sup>, ndërkohë që në fakt rezulton se kontraktori shfrytëzon të tërë sipërfaqen e mundshme. Strukturat drejtuese të shoqërisë të caktojnë një grup pune, për analizën e arsyeve dhe përgjegjësive të dëmit të shkaktuar, duke bërë njëkohësisht edhe evidentimin e të gjithë personave përgjegjës, si dhe të merren vendimet përkatëse.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

## **8. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi i procedurës së dhënies me qira të objektit: “Një pjesë të tetosë së qymyrit”, është konstatuar se, vlera prej 3,570,000 lekë përbën të ardhur të munguar me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të kompanisë “Albpetrol SHA. Kjo vlerë ka ardhur si rezultat i mos arkëtimit të sipërfaqes reale të dhënë me qira, sipas kontratës të lidhur midis palëve nr. 4267 Prot., datë 06.06.2016, ku personat përgjegjës janë ish Administratori i institucionit Z.E.P. , si dhe i gjithë grupi i punës i cili i ka dorëzuar asetin qiramarrësit, S. R. në cilësinë e Përgjegjës Material. Gjithashtu, përgjegjësi mban edhe S.K., si personi përgjegjës në cilësinë e Drejtorit aktual të Administrimit dhe Kontrollit të Pronës në Albpetrol SHA qiramarrësi, si dhe A. C. në cilësinë e Drejtorit të QSHGJ dhe I. G. në cilësinë e ish Drejtorit në QSHGJ Patos (*Trajtuar më hollësisht në pikën 12, të Raportit Përfundimtar*).

### **Rekomandimi:**

Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës prej 3,570,000 lekë, përkatësisht nga qiramarrësi dhe personi përgjegjës i cili ka lidhur kontratën, të cilët kanë shkaktuar mos arkëtimin e vlerës së mësipërme, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të kompanisë Albpetrol SHA si rrjedhojë e dhënies me qira të një sipërfaqe prej 200 m2, ndërkohë që në fakt rezulton se kontraktori shfrytëzon të tërë sipërfaqen e mundshme. Strukturat drejtuese të shoqërisë të caktojnë një grup pune, për analizën e arsyeve dhe përgjegjësive të dëmit të shkaktuar, duke bërë njëkohësisht edhe evidentimin e të gjithë personave përgjegjës, si dhe të merren vendimet përkatëse.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

## **9. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi i procedurës së dhënies me qira të objektit: “Salla e re e pompave, ish sektori III remont dinamik Sheqishte”, është konstatuar se, vlera prej 2,153,500 lekë përbën të ardhur të munguar me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të kompanisë “Albpetrol SHA Kjo vlerë ka ardhur si rezultat i mos arkëtimit të sipërfaqes reale të dhënë me qira, sipas kontratës të lidhur midis palëve nr. 3582 Prot., datë 24.04.2018, ku personat përgjegjës janë Administratori i institucionit Z. K.B. , si dhe i gjithë grupi i punës i cili i ka dorëzuar asetin qiramarrësit. Gjithashtu, përgjegjësi mban edhe S.K., si personi përgjegjës në cilësinë e Drejtorit aktual të Administrimit dhe Kontrollit të Pronës në Albpetrol SHA qiramarrësi, si dhe L. T. në cilësinë e Drejtorit të QAR Patos (*Trajtuar më hollësisht në pikën 12, të Raportit Përfundimtar*).

### **Rekomandimi:**

Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës prej 2,153,500 lekë, përkatësisht nga qiramarrësi dhe personi përgjegjës i cili ka lidhur kontratën, të cilët kanë shkaktuar mos arkëtimin e vlerës së mësipërme, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të kompanisë Albpetrol SHA si rrjedhojë e dhënies me qira të një sipërfaqe prej 200 m2, ndërkohë që në fakt rezulton se kontraktori shfrytëzon të tërë sipërfaqen e mundshme. Strukturat drejtuese të shoqërisë të caktojnë një grup pune, për analizën e arsyeve dhe përgjegjësive të dëmit të shkaktuar, duke bërë njëkohësisht edhe evidentimin e të gjithë personave përgjegjës, si dhe të merren vendimet përkatëse.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

## **10. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi i procedurës së dhënies me qira të objektit: “Salla e re e pompave, ish sektori III remont dinamik Sheqishte”, është konstatuar se, vlera prej 5,288,400 lekë përbën të ardhur të

munguar me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të kompanisë “Albpetrol SHA. Kjo vlerë ka ardhur si rezultat i mos arkëtimit të sipërfaqes reale të dhënë me qira, sipas kontratës të lidhur midis palëve nr. 8592 Prot., datë 26.12.2017, ku personat përgjegjës janë ish Administratori i institucionit Z.E.P., si dhe i gjithë grupi i punës i cili i ka dorëzuar asetin qiramarrësit konkretisht E. C., A. N., A. P., E. T., E. C.. Gjithashtu, përgjegjësi mban edhe S.K., si personi përgjegjës në cilësinë e Drejtorit aktual të Administrimit dhe Kontrollit të Pronës në Albpetrol SHA qiramarrësi, si dhe L. T. në cilësinë e Drejtorit të QAR Patos *(Trajtuar më hollësisht në pikën 12, të Raportit Përfundimtar)*.

**Rekomandimi:**

Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës prej 5,288,400 lekë, përkatësisht nga qiramarrësi dhe personi përgjegjës i cili ka lidhur kontratën, të cilët kanë shkaktuar mos arkëtimin e vlerës së mësipërme, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të kompanisë Albpetrol SHA si rrjedhojë e dhënies me qira të një sipërfaqe prej 100 m2, ndërkohë që në fakt rezulton se kontraktori shfrytëzon të tërë sipërfaqen e mundshme. Strukturat drejtuese të shoqërisë të caktojnë një grup pune, për analizën e arsyeve dhe përgjegjësive të dëmit të shkaktuar, duke bërë njëkohësisht edhe evidentimin e të gjithë personave përgjegjës, si dhe të merren vendimet përkatëse.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**11. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi i procedurës së dhënies me qira të objektit: “Zyra e magazinierit”, është konstatuar se, vlera prej 750,000 lekë përbën të ardhur të munguar me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të kompanisë “Albpetrol SHA. Kjo vlerë ka ardhur si rezultat i mos arkëtimit të sipërfaqes reale të dhënë me qira, sipas kontratës të lidhur midis palëve nr. 3437 Prot., datë 17.04.2018, ku personat përgjegjës janë Administratori i institucionit Z. K.B. , si dhe i gjithë grupi i punës i cili i ka dorëzuar asetin qiramarrësit. Gjithashtu, përgjegjësi mban edhe S.K., si personi përgjegjës në cilësinë e Drejtorit aktual të Administrimit dhe Kontrollit të Pronës në Albpetrol SHA qiramarrësi, si dhe A. C. në cilësinë e Drejtorit të QFMT Patos *(Trajtuar më hollësisht në pikën 12, të Raportit Përfundimtar)*.

**Rekomandimi:**

Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës prej 750,000 lekë, përkatësisht nga qiramarrësi dhe personi përgjegjës i cili ka lidhur kontratën, të cilët kanë shkaktuar mos arkëtimin e vlerës së mësipërme, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të kompanisë Albpetrol SHA si rrjedhojë e dhënies me qira të një sipërfaqe prej 35 m2, ndërkohë që në fakt rezulton se qiramarrësi shfrytëzon të tërë sipërfaqen e mundshme. Strukturat drejtuese të shoqërisë të caktojnë një grup pune, për analizën e arsyeve dhe përgjegjësive të dëmit të shkaktuar, duke bërë njëkohësisht edhe evidentimin e të gjithë personave përgjegjës, si dhe të merren vendimet përkatëse.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**12. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi i procedurës së dhënies me qira të objektit: “Grupi IV, sektori II, ish QPN Marinëz”, është konstatuar se, vlera prej 1,113,600 lekë përbën të ardhur të munguar me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të kompanisë “Albpetrol SHA. Kjo vlerë ka ardhur si

rezultat i mos arkëtimit të sipërfaqes reale të dhënë me qira, sipas kontratës të lidhur midis palëve nr. 3853 Prot., datë 03.05.2018, ku personat përgjegjës janë Administratori i institucionit Z. K.B. , si dhe i gjithë grupi i punës i cili i ka dorëzuar asetin qiramarrësit. Gjithashtu, përgjegjësi mban edhe S.K., si personi përgjegjës në cilësinë e Drejtorit aktual të Administrimit dhe Kontrollit të Pronës në Albpetrol SHA qiramarrësi, si dhe L. T. në cilësinë e Drejtorit të QAR Patos *(Trajtuar më hollësisht në pikën 12, të Raportit Përfundimtar)*.

**Rekomandimi:**

Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës prej 1,113,600 lekë, përkatësisht nga qiramarrësi dhe personi përgjegjës i cili ka lidhur kontratën, të cilët kanë shkaktuar mos arkëtimin e vlerës së mësipërme, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të kompanisë Albpetrol SHA si rrjedhojë e dhënies me qira të një sipërfaqe prej 200 m2, ndërkohë që në fakt rezulton se qiramarrësi shfrytëzon të tërë sipërfaqen e mundshme. Strukturat drejtuese të shoqërisë të caktojnë një grup pune, për analizën e arsyeve dhe përgjegjësive të dëmit të shkaktuar, duke bërë njëkohësisht edhe evidentimin e të gjithë personave përgjegjës, si dhe të merren vendimet përkatëse.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**13. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi i procedurës së dhënies me qira të objektit: “Grupi IV, sektori II, ish QPN Marinëz”, është konstatuar se, vlera prej 6,960,000 lekë përbën të ardhur të munguar me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të kompanisë “Albpetrol SHA. Kjo vlerë ka ardhur si rezultat i mos arkëtimit të sipërfaqes reale të dhënë me qira, sipas kontratës të lidhur midis palëve nr. 5602 Prot., datë 09.08.2016, ku personat përgjegjës janë ish Administratori i institucionit Z.E.P., si dhe i gjithë grupi i punës i cili i ka dorëzuar asetin qiramarrësit konkretisht E. C., G. R., E. T., E. C., N. G.. Gjithashtu, përgjegjësi mban edhe S.K., si personi përgjegjës në cilësinë e Drejtorit aktual të Administrimit dhe Kontrollit të Pronës në Albpetrol SHA qiramarrësi, si dhe L. T. në cilësinë e Drejtorit të QAR Patos *(Trajtuar më hollësisht në pikën 12, të Raportit Përfundimtar)*.

**Rekomandimi:**

Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës prej 6,960,000 lekë, përkatësisht nga qiramarrësi dhe personi përgjegjës i cili ka lidhur kontratën, të cilët kanë shkaktuar mos arkëtimin e vlerës së mësipërme, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të kompanisë Albpetrol SHA si rrjedhojë e dhënies me qira të një sipërfaqe prej 200 m2, ndërkohë që në fakt rezulton se qiramarrësi shfrytëzon të tërë sipërfaqen e mundshme. Strukturat drejtuese të shoqërisë të caktojnë një grup pune, për analizën e arsyeve dhe përgjegjësive të dëmit të shkaktuar, duke bërë njëkohësisht edhe evidentimin e të gjithë personave përgjegjës, si dhe të merren vendimet përkatëse.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**14. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi i procedurës së dhënies me qira të objektit: “Zyrat e ish remontit Marinëz”, është konstatuar se, vlera prej 350,000 lekë përbën të ardhur të munguar me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të kompanisë “Albpetrol SHA Kjo vlerë ka ardhur si rezultat i mos arkëtimit të sipërfaqes reale të dhënë me qira, sipas kontratës të lidhur midis palëve nr. 993 Prot., datë 05.02.2018, ku personat përgjegjës janë Administratori i institucionit Z. K.B. , si dhe i gjithë grupi i punës i cili i ka dorëzuar asetin qiramarrësit. Gjithashtu, përgjegjësi mban

edhe S.K., si personi përgjegjës në cilësinë e Drejtorit aktual të Administrimit dhe Kontrollit të Pronës në Albpetrol SHA, qiramarrësi, si dhe L. T. në cilësinë e Drejtorit të QAR Patos *(Trajtuar më hollësisht në pikën 12, të Raportit Përfundimtar)*.

**Rekomandimi:**

Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës prej 350,000 lekë, përkatësisht nga qiramarrësi dhe personi përgjegjës i cili ka lidhur kontratën, të cilët kanë shkaktuar mos arkëtimin e vlerës së mësipërme, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të kompanisë Albpetrol SHA si rrjedhojë e dhënies me qira të një sipërfaqe prej 150 m<sup>2</sup>, ndërkohë që në fakt rezulton se qiramarrësi shfrytëzon të tërë sipërfaqen e mundshme. Strukturat drejtuese të shoqërisë të caktojnë një grup pune, për analizën e arsyeve dhe përgjegjësive të dëmit të shkaktuar, duke bërë njëkohësisht edhe evidentimin e të gjithë personave përgjegjës, si dhe të merren vendimet përkatëse.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**15. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi i procedurës së dhënies me qira të objektit: “Zyrat e ish remontit Marinëz”, është konstatuar se, vlera prej 600,000 lekë përbën të ardhur të munguar me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të kompanisë “Albpetrol SHA. Kjo vlerë ka ardhur si rezultat i mos arkëtimin të sipërfaqes reale të dhënë me qira, sipas kontratës të lidhur midis palëve nr. 675 Prot., datë 01.02.2017, ku personat përgjegjës janë ish Administratori i institucionit Z.E.P. , si dhe i gjithë grupi i punës i cili i ka dorëzuar asetin qiramarrësit. Gjithashtu, përgjegjësi mban edhe S.K., si personi përgjegjës në cilësinë e Drejtorit aktual të Administrimit dhe Kontrollit të Pronës në Albpetrol SHA të gjithë personat përgjegjës të kësaj Drejtorie, qiramarrësi, si dhe L. T. në cilësinë e Drejtorit të QAR Patos *(Trajtuar më hollësisht në pikën 12, të Raportit Përfundimtar)*.

**Rekomandimi:**

Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës prej 600,000 lekë, përkatësisht nga qiramarrësi dhe personi përgjegjës i cili ka lidhur kontratën, të cilët kanë shkaktuar mos arkëtimin e vlerës së mësipërme, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të kompanisë Albpetrol SHA si rrjedhojë e dhënies me qira të një sipërfaqe prej 150 m<sup>2</sup>, ndërkohë që në fakt rezulton se qiramarrësi shfrytëzon të tërë sipërfaqen e mundshme. Strukturat drejtuese të shoqërisë të caktojnë një grup pune, për analizën e arsyeve dhe përgjegjësive të dëmit të shkaktuar, duke bërë njëkohësisht edhe evidentimin e të gjithë personave përgjegjës, si dhe të merren vendimet përkatëse.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**16. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi i procedurës së dhënies me qira të objektit: “Salla e pompave, grupi 40”, është konstatuar se, vlera prej 1,338,000 lekë përbën të ardhur të munguar me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të kompanisë “Albpetrol SHA. Kjo vlerë ka ardhur si rezultat i mos arkëtimin të sipërfaqes reale të dhënë me qira, sipas kontratës të lidhur midis palëve nr. 8362 Prot., datë 15.12.2017, ku personat përgjegjës janë ish Administratori i institucionit Z.E.P. , si dhe i gjithë grupi i punës i cili i ka dorëzuar asetin qiramarrësit. Gjithashtu, përgjegjësi mban edhe S.K., si personi përgjegjës në cilësinë e Drejtorit të Administrimit dhe Kontrollit të Pronës në Albpetrol SHA, qiramarrësi, si dhe L. T. i në cilësinë e Drejtorit të QAR Patos *(Trajtuar më hollësisht në pikën 12, të Raportit Përfundimtar)*.

**Rekomandimi:**

Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës prej 1,338,000 lekë, përkatësisht nga qiramarrësi dhe personi përgjegjës i cili ka lidhur kontratën, të cilët kanë shkaktuar mos arkëtimin e vlerës së mësipërme, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të kompanisë Albpetrol SHA si rrjedhojë e dhënies me qira të një sipërfaqe prej 90 m<sup>2</sup>, ndërkohë që në fakt rezultoi se qiramarrësi shfrytëzoi të tërë sipërfaqen e mundshme dhe qiramarrësi. Strukturat drejtuese të shoqërisë të caktojnë një grup pune, për analizën e arsyeve dhe përgjegjësive të dëmit të shkaktuar, duke bërë njëkohësisht edhe evidentimin e të gjithë personave përgjegjës, si dhe të merren vendimet përkatëse.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**17. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi i procedurës së dhënies me qira të objektit: “Salla e pompave, grupi 40”, është konstatuar se, vlera prej 3,211,200 lekë përbën të ardhur të munguar me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të kompanisë “Albpetrol SHA. Kjo vlerë ka ardhur si rezultat i mos arkëtimin të sipërfaqes reale të dhënë me qira, sipas kontratës të lidhur midis palëve nr. 8580 Prot., datë 24.11.2015, ku personat përgjegjës janë ish Administratori i institucionit Z.E.P. , si dhe i gjithë grupi i punës i cili i ka dorëzuar asetin qiramarrësit. Gjithashtu, përgjegjësi mban edhe S.K., si personi përgjegjës në cilësinë e Drejtorit të Administrimit dhe Kontrollit të Pronës në Albpetrol SHA qiramarrësi, si dhe L. T. në cilësinë e Drejtorit të QAR Patos *(Trajtuar më hollësisht në pikën 12, të Raportit Përfundimtar)*.

**Rekomandimi:**

Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës prej 3,211,200 lekë, përkatësisht nga qiramarrësi dhe personi përgjegjës i cili ka lidhur kontratën, të cilët kanë shkaktuar mos arkëtimin e vlerës së mësipërme, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të kompanisë Albpetrol SHA si rrjedhojë e dhënies me qira të një sipërfaqe prej 90 m<sup>2</sup>, ndërkohë që në fakt rezultoi se qiramarrësi shfrytëzoi të tërë sipërfaqen e mundshme dhe qiramarrësi. Strukturat drejtuese të shoqërisë të caktojnë një grup pune, për analizën e arsyeve dhe përgjegjësive të dëmit të shkaktuar, duke bërë njëkohësisht edhe evidentimin e të gjithë personave përgjegjës, si dhe të merren vendimet përkatëse.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**18. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi i objektit të ndodhur në Divjakë Lushnje, është konstatuar se, vlera prej 2,500,200 lekë përbën të ardhur të munguar me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të kompanisë “Albpetrol SHA Kjo vlerë ka ardhur si rezultat i mos arkëtimin të sipërfaqes të administruar, ku personat përgjegjës janë Administratori i institucionit Z. K.B. , si dhe S.K., si personi përgjegjës në cilësinë e Drejtorit të Administrimit dhe Kontrollit të Pronës në Albpetrol SHA si dhe personi/at përgjegjës i cili shfrytëzoi këtë pronë *(Trajtuar më hollësisht në pikën 12, të Raportit Përfundimtar)*.

**Rekomandimi:**

Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës prej 2,500,200 lekë, përkatësisht nga personi përgjegjës, i cili ka shkaktuar mos arkëtimin e vlerës së mësipërme, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të kompanisë Albpetrol SHA si rrjedhojë mos marrjes së masave dhe mos veprimit lidhur me pronën e mësipërme, ndërkohë që në fakt, rezultoi se në këtë pronë magazinoheshin materiale ndërtimore. Strukturat drejtuese të shoqërisë të caktojnë një grup

pune, për analizën e arsyeve dhe përgjegjësive të dëmit të shkaktuar, duke bërë njëkohësisht edhe evidentimin e të gjithë personave përgjegjës, si dhe të merren vendimet përkatëse.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

### **19. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi i kryer në dosjet e Njesisë së Auditit të Brendshmëm të shoqërisë, në periudhën maj-gusht 2017, rezultoi problematika lidhur me diferencën në mungesë e sasisë së naftës së raportuar me atë gjendje në sasinë 353.4 ton me vlerë 11,027,000 lekë në QPN Kuçovë, e konstatuar gjatë marrjes në dorëzim të detyrës nga drejtori i ri i qendrës, z. Gj.M., me urdhrin nr. 4542 prot, datë 04.07.2017, dhe e verifikuar nga auditimi i brendshëm në raportin përfundimtar të kryer dhe evaduar nga titullari i shoqërisë për zbatim me urdhrin nr. 7192 prot, datë 27.10.2017, por si problematikë e bërë me dije në organet drejtuese të shoqërisë që në maj të vitit 2016 nga ish-kryeinxhinieri i qendrës në atë periudhë z. Gj. M..

Nga ballafaqimi me z. Gj. M., u konstatua se administratori i shoqërisë e ka thirrur në një mbledhje për të cilën nuk është mbajtur protokoll nga asistentja administrative, në të cilën i ka parashtruar arsyet e mos firmosjes së bilancit të naftës.

Me shkresën nr. 3048 prot, datë 06.05.2016, administratori i shoqërisë z.E.P. , pas marrjes së proces verbaleve dhe bilancit të naftës të QPN Kuçovë, të pa firmosura nga kryeinxhinieri i qendrës dhe në cilësinë e kryetarit të grupit të kontrollit ia ka dërguar departamenteve përkatëse pa marrjen e veprimeve të duhura për verifikimin e situatës.

Mos veprimet e titullarit të shoqërisë në periudhën 2016 janë në kundërshtim me:

Ligjin nr.10 296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, kreu II, neni 8, Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit ku citohet “Titullarët e njësive publike, të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, përgjigjen për vendosjen e përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësive publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet.”

Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pika 75, ku citohet “Titullari i njësisë publike, kur ka dyshime për mashtrime, abuzim e, keqpërdorime, vjedhje apo grabitje të aktiveve apo të një pjese të tyre, ose qoftë edhe për të vërtetuar saktësinë e veprimeve ligjore për një periudhë kohore, mund të urdhërojnë kryerjen e inventarizimeve të plota ose të pjesshme të tyre, pa kufizim në numër, jashtë afateve të parapara të inventarizimit të aktiveve.”

Pa asnjë indicie nga ana e shoqërisë, Drejtoria Vendore e Policisë, Berat, me shkresën nr. 20554/1 prot, datë 20.07.2017, i ka kërkuar informacion Q.N.P., Kuçovë lidhur me sasinë e naftës së prodhuar në vitin 2016 dhe janar-qershor 2017 si dhe nëse ka pasur problematika lidhur me sasinë e naftës së prodhuar dhe të raportuar, si dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Berat ka kërkuar informacion lidhur me çështjen sa më sipër.

Vlera e naftës së munguar 11,027,000 lekë përbën e ardhur ekonomike e munguar për shoqërinë Albpetrol (*Trajtuar më hollësisht në pikën 13, të Raportit Përfundimtar*).

### **Rekomandimi:**

Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe administratori të merren masat e menjëhershme për nxjerrjen e përgjegjësive personale për sasinë e naftës së munguar si dhe arsyet e mos shqyrtimit të çështjes që në maj të vitit 2016 nga ish-administratori, kur ishte ngritur si problem nga kryeinxhinieri i QPN-së.

**Menjëherë**

## **20. Gjetje nga auditimi:**

- Shoqëria ka paraqitur në zërin të drejta të arkëtueshme, në pasqyrën e pozicionit financiar më datë 31.12.2016 vlerën 3,348,670,119 lekë dhe më datë 31.12.2017 vlerën 2,497,785,582 lekë. Këto vlera përfaqësojnë vlerën përkatëse të sasisë së produktit, që është llogaritur sipas parashikimeve të kontratave hidrokarbure, por që nuk është lëvruar fizikisht në depozitat e Albpetrolit. Drejtimi i shoqërisë është justifikuar se për arsye të mos-pasjes të kapaciteteve magazinuese ose arsye të marrëdhënieve me shoqëritë kontraktore nuk është bërë e mundur tërheqja e produktit nga të tretët. Drejtimi i shoqërisë në këtë situatë duhet të merrte masat për shitjen e të gjithë produktit që është detyruar ta magazinon në shoqëritë kontraktore përkatëse. Si pasojë e këtyre veprimeve apo mosveprimeve nuk kanë hyrë të ardhura nga shitja e naftës bruto në llogaritë e Albpetrol SHA. Bazuar në ligjin Nr.48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet Kontraktore e tregtare" Neni 5, si dhe sipas Buletinit Zyrtar të Bankës së Shqipërisë, për vitin 2016, norma mesatare e REPO-s, është 1.25 %, si dhe për vitin 2017 kjo normë ka ngelur e pandryshuar.

Për vitin 2016, vlera e të ardhurës së munguar të shoqërisë është 309,751,986 lekë dhe për vitin 2017 kjo vlerë është 231,045,166 lekë (*Trajtuar më hollësisht në pikën 5, të Raportit Përfundimtar*).

## **Rekomandimi:**

Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe administratori të merren masat e menjëhershme për marrjen të gjitha detyrimeve që kanë shoqëritë kontraktore të marrëveshjeve hidrokarbure si dhe nxjerrjen e përgjegjësive individuale për mos tërheqjen e sasive të naftës e të gazit nga këto shoqëri.

**Menjëherë**

## **B.3 TË ARDHURA TË MUNGUARA SI RRJEDHOJË E NJË VENDIMI TË PADREJTË NË VITIN 2004, TË CILAT DUHET TË ANALIZOHEN**

### **1. Gjetje nga auditimi:**

Marrëveshja Hidrokarbure "Për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin P" e lidhur me "S" Ltd, është në kundërshtim me ligjin nr.7746, datë 28.7.1993 "Për hidrokarburet" dhe M-H.

Lidhja e M-H në Republikën e Shqipërisë (ku shteti është i vetmi pronar i të gjitha burimeve natyrore), ku AKH, në emër të Ministrisë së Industrisë dhe Energjistikës ka të drejtën ekskluzive për të hyrë në një Licensë Marrëveshje me Albpetrolin për të kryer të gjitha Operacionet Hidrokarbure të përshkruara në këtë Marrëveshje (Albpetroli është palë në Licensë Marrëveshjen e datës 7 Qershor 2004). Kontraktori do të bashkohet me Albpetrolin në kryerjen e Operacioneve Hidrokarbure dhe bëhet palë në Licensë Marrëveshje, dhe për qëllime që lidhen me atë, pasi kanë ekzekutuar Instrumentin e Transferimit me kushtin që kjo Marrëveshje bëhet efektive; realizohen për mungesë financiare dhe teknike. "S" Ltd, është një kontraktor që nuk rezulton që i plotëson këto kërkesa (të kishte kapacitet teknik, financiar, komercial, njerëzor dhe organizativ), pasi nuk kishte kaluar as dy muaj nga regjistrimi në parajsën fiskale ishujt Cayman.

Marrëveshja Hidrokarbure, nënshkruar me "S" Ltd, krahasuar me M-H lidhur në Mars 1994 (me "P" "Llc), pjesa e "Albpetrol" SHA, është (shtetit shqiptar) 15 herë më e vogël nga viti 2004 deri në 30.06.2018, sipas llogaritjes së grupit të auditimit janë afërsisht **439,698,341**



USD<sup>3</sup>, më pak se të ardhurat që kishte “Albpetrol” SHA, po të mos ishte prishur marrëveshja e 1994, apo po të mos ishin ndryshuar kushtet e marrëveshjes në vitin 2004 për ASP nga 15 % në 1% (Trajtuar më hollësisht në pikën 9, të Raportit Përfundimtar).

**Rekomandimi:**

Albpetrol SHA, Këshilli Mbikëqyrës, AKBN dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, të marrin masa, të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për miratimin/nënshkrimin e Marrëveshjes Hidrokarbure me kontraktorin “S” Ltd., ndryshimin e ASP dhe koeficientin e rënies eksponenciale të prodhimit të puseve, krahasuar me marrëveshjen e nënshkruar me “P” Llc. Të analizohet vlera prej **439,698,341 USD**, dhe të nxirren përgjegjësitë e të gjithë personve përgjegjës që kanë marrë pjesë në formulimin, miratimin e nënshkrimin e Marrëveshjes Hidrokarbure me “S” Ltd. Një kopje e raportit të grupit të veçantë të punës ti dërgohet zyrtarisht KLSH. Gjithashtu ky grup të bëjë llogaritjen e saktë të efekteve financiare të M-H (te ardhura te munguara), duke filluar që nga data e nënshkrimit të tyre (ditës efektive) dhe të analizohen, të nxirren përgjegjësitë.

Më tej KLSH do analizojë këtë raport dhe do t'i drejtohet organeve më të larta shtetërore të kompetencës, si dhe atij të prokurorisë, sipas përcaktimit në Ligjin Nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Neni 15.

*Deri më datë 31.05.2019*

## **B.4 DËM EKONOMIK PA MUNDËSI LLOGARITJEJE TË PLOTË NGA GRUPI I AUDITIMIT**

### **1. Gjetje nga auditimi:**

Nga inspektimi i datës 24.05.2018, në vendburimin B-H... “është konstatuar se, operacionet hidrokarbure vazhdojnë të jenë të pezulluara”. Vendburimi operohej, vetëm nga 8 punonjës të “T” Ltd., të cilët nuk kanë marrë pagat më shumë se dhjetë muaj si dhe nuk ju janë paguar kontributet dhe sigurimet përkatëse pranë institucionet përgjegjëse, në vendburim mungon energjia elektrike, gjatë periudhës që pusët kanë qëndruar të ndalur, kanë ndodhur vjedhjet të pajisjeve dhe makinerive të ndryshme. Është sugjeruar që të angazhohet stafi i Drejtorisë Marrëveshjes Hidrokarbure, QAR dhe QPN Fier për monitorimin e përkohshëm të këtij vendburimi.

Nga ana e Albpetrolit nuk është përllogaritur: vlera e pajisjeve dhe makinerive që mungojnë, ditët që mungon energjia elektrike në vendburim, numri i puseve që kanë qëndruar të ndalur dhe prodhimi i munguar.

Rasti tregon shmangie të theksuara nga përcaktimet e Marrëveshjeve Hidrokarbure nga ana e “T” Ltd si dhe punë jo efikase të strukturave të Albpetrol SHA, në monitorimin hap pas hapi të zbatimit të këtyre marrëveshjeve dhe jo inspektimin/konstatimin pas dhjetë muajave të vendburimit B- H (Trajtuar më hollësisht në pikën 9, të Raportit Përfundimtar).

**Rekomandim:**

Albpetrol SHA dhe AKBN të marrin të gjitha masa për auditimin e veprimtarisë të vendburimit Ballsh Hekal nga data 1 Janar 2017 deri më datë 31.05.2018, kur ky vendburim nëpërmjet Instrumentit të Transferimit ka kaluar nga “T” Ltd të “A” SHA.

Të llogaritet, vlera e pajisjeve, makinerive që mungojnë, numri i puseve që kanë qëndruar të ndalur, prodhimi dhe të ardhurat e munguara për buxhetin e shoqërisë. Gjithashtu të

<sup>3</sup> Vlera 439,698,341 USD nuk do të përfshihet në evidencat statistikore të KLSH-së për vitin 2018, për arsye se efektet financiare të kësaj vlere fillojnë që nga viti 2004 dhe kërkohet konfirmimi edhe nga MIE, AKBN dhe Albpetrol (Shih rekomandimin).

analizohet dhe të nxirren përgjegjësitë për shmangient nga zbatimi i Marrëveshjes HK. Një kopje e raportit të auditimit t'i dërgohet KLSH-së.

*Deri më datë 31.03.2019*

## **2. Gjetje nga auditimi:**

Nga testimi i puseve zhvilluar në periudhën Qeshor-Korrik 2018, janë konstatuar probleme që kanë ndikuar negativisht në përfundimin e testimit (probleme teknologjike), largimi të sasisë të fluidit, pa praninë e përfaqësuesve të Albpetrol SHA, dhe në krahasim me deklaratimet e të dhënave në Progres Raport, ka diferenca të konsiderueshme të naftës neto të prodhuar me atë të deklaruar në raportet mujore të prodhimit, të dërguar nga kontraktori "T" SHA.

Për periudhën dy mujore si më sipër, është konstatuar se prodhimi është në sasinë 30.226 ton, ndërsa raportimi për muajin Qeshor-Korrik është 25.267 ton, me diferencë 4.959 ton ose 19.6 %. Në këto kushte, duket qartë edhe pse është konstatuar një devijim material i konsiderueshëm (1/5 e prodhimit e pa raportuar) nga Albpetrol SHA është mjaftuar vetëm me konstatimin e ngjarjes dhe nuk ka vazhduar të supervizonte/monitoronte operacionet hidrokarbure.

Kjo shmangie përbën devijim material si dhe deklarimi i të dhënave jo reale dhe në përputhje me nenin 24, pika 24.2.1, të Marrëveshjes Hidrokarbure "Mbyllja" si dhe nenin 24, pika 24.1 të licencë marrëveshjes "E drejta e AKBN për t'a përfunduar marrëveshjen", duhet të bëheshin njoftimet përkatëse kontraktorit (*Trajtuar më hollësisht në pikën 9, të Raportit Përfundimtar*).

## **Rekomandim:**

Albpetrol SHA në bashkëpunim me AKBN, të ndjekin hapat ligjorë sipas përcaktimeve në Marrëveshjen Hidrokarbure dhe në Licencë Marrëveshje për korrektimin e sasive të naftës sipas rezultateve të testimit, si dhe të bëhen paralajmërimet përkatëse për devijim material dhe ndërprerje të marrëveshjes, në përputhje me nenin 24, pika 24.2.1 të marrëveshjes hidrokarbure "Mbyllja" si dhe nenin 24, pika 24. 1. a të licencë marrëveshjes "E drejta e AKBN për t'a përfunduar marrëveshjen" me "T" SHA.

Drejtoria e Marrëveshjeve Hidrokarbure, të vazhdojë monitorim e prodhimit për të gjitha pusët në dispozicion të kontraktorit në mënyrë të vazhdueshme, si dhe të marrë masa për njoftimin e te gjithë organeve kompetente fiskale dhe jofiskale, për rrethana të cilat mund të konsiderohen vepër penale për veprime abuzive të kontraktorit.

*Deri më datë 31.03.2019*

## **C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICIENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE**

### **1. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: "Blerje veshmbathje për punonjësit", me fond limit 36,658,607 lekë pa TVSH, datë zhvillimi tenderi 21.07.2017, sipas Urdhërit të Prokurimit të titullarit të autoritetit kontraktor nr. 4375 Prot., datë 27.06.2017, është konstatuar se, vlera prej 4,140,780 lekë përbën një vlerë të pajustificuar ndaj buxhetit të kompanisë "Albpetrol SHA. Kjo vlerë ka ardhur si rezultat i përllogaritjes gabim të vlerës së fondit limit, si rezultat i mbajtjes së dy qëndrimeve, në kundërshtim kjo me nenin 28 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, nenin 59 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar (*Trajtuar më hollësisht në pikën 7, të Raportit Përfundimtar*).

**Rekomandimi:**

Nga Administratori i shoqërisë, si dhe Këshilli Mbikëqyrës i Albpetrol SHA, të merren masa për të analizuar shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorim me efektivitet dhe ekonomicitet, si dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, lidhur me vlerën prej 4,140,780 lekë, përkatësisht nga personi/at përgjegjës, të cilët kanë shkaktuar shpenzim të paargumentuar ndaj buxhetit të kompanisë Albpetrol SHA si rrjedhojë e përlllogaritjes gabim të vlerës së fondit limit. Titullari i AK, ka detyrimin ligjor të ngrejë një grup pune të veçantë, si dhe të bëjë evidentimin e të gjithë personave përgjegjës, të cilët kanë bërë përlllogaritjen e vlerës së fondit limit (referuar kjo observacioneve të dërguara, ku pretendohet se përlllogaritja e vlerës së fondit limit është bërë nga Drejtoria e Shërbimeve dhe Funizimit).

**Menjëherë**

**2. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Rehabilitimi i sistemit të injektimit të ujrave në St.Dek.Kash, pusët dhe grupet e vendburimit Cakran Mollaj dhe Sek.Dek.Usojë, të QPN Ballsh”, me fond limit 63,673,380 lekë pa TVSH, datë zhvillimi tenderi 27.11.2017, sipas Urdhërit të Prokurimit të titullarit të autoritetit kontraktor nr. 7224 Prot., datë 30.10.2017, për kontratën nr. 7224/13 Prot., datë 07.02.2018 me vlerë 60,591,900 lekë me TVSH, është konstatuar efekt negativ financiar në vlerën 15,816,156 lekë, si rezultat i përlllogaritjes gabim të vlerës së fondit limit, në kundërshtim kjo me LPP, duke patur parasysh edhe uljen e ofertës fituese nga vlera e fondi limit (*Trajtuar më hollësisht në pikën 7, të Raportit Përfundimtar*).

**Rekomandimi:**

Nga Administratori i shoqërisë, si dhe Këshilli Mbikëqyrës i Albpetrol SHA, të merren masa për të analizuar shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorim me efektivitet dhe ekonomicitet të fondeve publike në vlerën prej 15,816,156 lekë, vlerë e cila ka të bëjë me shkeljet e konstatuara në procedurën e prokurimit të zhvilluar me objekt: “Rehabilitimi i sistemit të injektimit të ujrave në St.Dek.Kash, pusët dhe grupet e vendburimit Cakran Mollaj dhe Sek.Dek.Usojë, të QPN Ballsh”, si dhe të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse ligjore, në mënyrë që të parandalohen raste të tilla në të ardhmen.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**3. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Blerje lubrifikante”, me fond limit 19,418,500 lekë pa TVSH, datë zhvillimi tenderi 20.07.2018, sipas Urdhërit të Prokurimit të titullarit të autoritetit kontraktor nr. 5347 Prot., datë 26.06.2018, për kontratën me vlerë 20,684,400 lekë me TVSH, është konstatuar efekt negativ financiar në vlerën 2,617,800 lekë, si rezultat i përlllogaritjes gabim të vlerës së fondit limit, në kundërshtim kjo me LPP, duke patur parasysh edhe uljen e ofertës fituese nga vlera e fondi limit (*Trajtuar më hollësisht në pikën 7, të Raportit Përfundimtar*).

**Rekomandimi:**

Nga Administratori i shoqërisë, si dhe Këshilli Mbikëqyrës i Albpetrol SHA, të merren masa për të analizuar shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorim me efektivitet dhe ekonomicitet të fondeve publike në vlerën prej 2,617,800 lekë, vlerë e cila ka të bëjë me shkeljet e konstatuara në procedurën e prokurimit të zhvilluar me objekt: “Blerje lubrifikante”, si dhe të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse ligjore, në mënyrë që të parandalohen raste të tilla në të ardhmen.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

#### **4. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Blerje GPS personal dhe GPS automjetesh”, me fond limit 15,635,000 lekë pa TVSH (18,762,000 lekë me TVSH), datë zhvillimi tenderi 05.05.2017, sipas Urdhërit të Prokurimit të titullarit të autoritetit kontraktor nr. 2558 Prot., datë 11.04.2017, për kontratën nr. 2558/11 prot., datë 19.06.2017, është konstatuar efekt negativ financiar në vlerën 15,888,000 lekë, si rezultat i mosfunksionimit të pajisjeve të blera, si dhe moszbatimit të kushteve të kontratës, në kundërshtim kjo me nenin 60 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe kushtet e kontratës së nënshkruar midis palëve (*Trajtuar më hollësisht në pikën 7, të Raportit Përfundimtar*).

#### **Rekomandimi:**

Nga Administratori i shoqërisë, si dhe Këshilli Mbikëqyrës i Albpetrol SHA, të merren masa për të analizuar shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorim me efektivitet dhe ekonomicitet të fondeve publike në vlerën prej 15,888,000 lekë, vlerë e cila ka të bëjë me shkeljet e konstatuara në procedurën e prokurimit të zhvilluar me objekt: “Blerje GPS personal dhe GPS automjetesh”, si dhe të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse ligjore, në mënyrë që të parandalohen raste të tilla në të ardhmen.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

#### **5. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Blerje autovetura”, sipas kontratës së lidhur nr. 7985/16 prot., datë 09.02.2017, është konstatuar efekt negativ financiar në vlerën 2,130,000 lekë. Kjo vlerë ka ardhur si rezultat i mos zbatimit të kushteve të kontratës, si dhe marrjes në dorëzim të mallit i cili nuk është sipas specifikimeve teknike, në kundërshtim kjo me nenin 60 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe kontratën e nënshkruar midis palëve dhe specifikimeve teknike (*Trajtuar më hollësisht në pikën 7, të Raportit Përfundimtar*).

#### **Rekomandimi:**

Nga Administratori i shoqërisë, si dhe Këshilli Mbikëqyrës i Albpetrol SHA, të merren masa për të analizuar shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorim me efektivitet dhe ekonomicitet të fondeve publike në vlerën prej 2,130,000 lekë, vlerë e cila ka të bëjë me shkeljet e konstatuara në procedurën e prokurimit të zhvilluar me objekt: “Blerje autovetura”, si dhe të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse ligjore, në mënyrë që të parandalohen raste të tilla në të ardhmen.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

#### **6. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Shërbime për punime me autosondë”, me fond limit 60,000,000 lekë pa TVSH, datë zhvillimi tenderi 04.07.2018, sipas Urdhërit të Prokurimit të titullarit të autoritetit kontraktor nr. 4916 Prot., datë 08.06.2018, për kontratën nr. 4916/13 Prot., datë 25.07.2018 me vlerë 65,011,680 lekë me TVSH (për të dy lotet), është konstatuar efekt negativ financiar në vlerën 2,763,360 lekë. Kjo vlerë ka ardhur si rezultat i vlerësimit të gabuar të ofertave pjesëmarrëse, në kundërshtim kjo me nenin 53/3 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku personat përgjegjës janë KVO, si dhe titullari i AK (*Trajtuar më hollësisht në pikën 7, të Raportit Përfundimtar*).

#### **Rekomandimi:**

Nga Administratori i shoqërisë, si dhe Këshilli Mbikëqyrës i Albpetrol SHA, të merren masa për të analizuar shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorim me efektivitet dhe ekonomicitet të fondeve publike në vlerën prej 2,763,360 lekë, vlerë e cila ka të bëjë me

shkeljet e konstatuara në procedurën e prokurimit të zhvilluar me objekt: “Shërbime për punime me autosondë”, si dhe të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse ligjore, në mënyrë që të parandalohen raste të tilla në të ardhmen.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

### **7. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi i dokumentacionit të shpenzimeve të bankës të vitit 2017 për vendimet e proceseve gjyqësore, rezultoi se:

**A-**Nga mos ndjekja e procedurave ligjore në ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me ish-punonjësit, Shoqëria Albpetrol SHA., Patos, është paditur në Gjykatë dhe referuar Vendimeve të formës së prerë të Gjykatës së Apelit këto çështje kanë përfunduar duke dëmshpërblyer financiarisht në 403 raste në shumën totale 282,178,837 lekë. Për këto ekzekutime janë paguar edhe shpenzime përmbartimore në shumën 14,239,608 lekë duke rënduar akoma më shumë buxhetin e shoqërisë.

**B-**Gjithashtu është paguar në dy raste shoqëria “E. 13” në shumën 96,411,000 lekë si dëmshpërblim. Në lidhje me këtë dëmshpërblim rezulton se, midis Albpetrol SHA. dhe shoqërisë “E. 13” është lidhur një kontratë nr. 3669/5 prot, datë 22.10.2012 në objekt të së cilës ka qenë tërheqja ose shitja e disa mallrave të mbetura në magazinat e Albpetrol SHA që prej shumë kohësh. Kjo kontratë ka patur si afat 120 ditë për tërheqjen e mallrave. Pas përfundimit të kesaj kontrate, palët kanë rënë dakort që afati i saj të zgjatet edhe për 120 ditë të tjera me anë të amendamentit nr. 403/1 prot, datë 18.02.2013.

Nga ana e shoqërisë “E. 13” janë tërhequr në fillim mallrat të cilat kanë patur interes për të dhe me vonë ka ndërprerë pagesat dhe rrjedhimisht edhe tërheqjen e mallrave, me arsyetimin se nuk kanë qenë në cilësi të mirë. Kjo ka çuar palët edhe në një proces gjyqësor me objekt: Detyrimin e Albpetrol SHA, të përmbushë detyrimin që rrjedh nga kontrata e shitjes nr. 3669/5 prot datë 22.10.2012 në natyrë me mallra pa të meta si dhe dëmshpërblimin për pjesën e porealizueshme të kesaj kontrate në formën e dëmit të shkaktuar dhe fitimit të munguar. Referuar këtij procesi gjyqësor shoqëria e sipërpërmendur ka fituar dhe të drejtën e dëmshpërblimit, pavarësisht se Shoqëria Albpetrol ka ndjekur hapat ligjor për kundërshtimin e kërkesë padisë së bërë nga shoqëria “E.”.

Shuma totale prej 392,829,444 lekë përbën një efekt ekonomik negativ në rezultatin financiar duke qenë një vlerë e konisderueshme shpenzimesh për buxhetin e shoqërisë (*Trajtuar më hollësisht në pikën 6, të Raportit Përfundimtar*).

### **Rekomandimi:**

Këshilli Mbikëqyrës i Albpetrol SHA të analizojë largimet e paligjshme nga puna të punonjësve për mos respektimin e kërkesave të kontratave individuale të punës dhe përcaktimet e Kodit të Punës, të cilat për periudhën e audituar kanë rënduar shpenzimet në shumën 392,829,444 lekë, me qëllim mos rritjen e kostove të shoqërisë, të cilat kanë ndikuar në rezultatin financiar.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

### **8. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi i zbatimit e kontratës me nr. 2088/1 prot, datë 30.04.2015, “Për rivlerësimin e Aktiveve Afatgjata Materiale të Albpetrol SHA. Patos”, me vlerë kontrate 120,000,000 lekë me TVSH, gjatë viteve 2017-2018, janë kryer pagesa në shumën 60,000,000 lekë. Kontrata e mësipërme për këtë shërbim është kryer pa procedurë prokurimi e cila është përmendur si shkelje e legjislacionit të prokurimit në raportet e auditimit të mëparshëm të KLSH. Referuar Dokumenteve standarde të tenderit të publikuara në faqen zyrtare të APP-së, për kontratat e shërbimeve me afat jo më shumë se 12-muaj, duhet të llogariten penalitete sipas formulës ku tarifa ditore do të jetë 2/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës, por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.

Me shkresën nr. 6452 prot, datë 28.09.2018, urdhër nr. 40, nga administratori i shoqërisë, është ngritur grupi i punës për marrjen në dorëzim të materialeve nga ekspertët rivlerësues, për zbatimin e kontratës, i cili përbëhet nga z.V. J., znj.Sh. B., znj.A. P., z.A. Z. dhe znj.E. F.. Bazuar në aktin e marrjes në dorëzim të materialeve të paraqitura nga Ekspertët Rivlerësues, me nr. 6452/1 prot, datë 29.09.2017, rezulton se materialet e këtij shërbimi janë dorëzuar 307 ditë me vonesë. Nga ana e shoqërisë nuk janë mbajtur penaltete për kryerjen me vonesë të shërbimit e cila nga llogaritja është  $120,000,000 * 25\% * 2/1000 * 307 = 18,420,000$  lekë, vlerë e cila duhej ti mbahej si penaltet grupit të ofrimit të shërbimit, e cila përbën efekt financiar negativ për buxhetin e shoqërisë. Ky veprim është në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 10.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, neni 8 (*Trajtuar më hollësisht në pikën 6, të Raportit Përfundimtar*).

#### **Rekomandimi:**

Këshilli Mbikëqyrës i Albpetrol SHA të analizojë në grup pune të veçantë mënyrën e hartimit dhe lidhjes së kontratës së mësipërme, të nxirren përgjegjësitë përkatëse për mos përcaktimin e penalteteve të vonesave, gjithashtu të merren masat që në të ardhmen, lidhja e kontratave të bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi, për të përmbushur objektivat dhe qëllimin e shoqërisë dhe rritjen e treguesve financiarë.

**Menjëherë**

#### **9. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi i zbatimit të strukturës organizative, referuar listëpagesave të muajve korrik-gusht-shtator 2017 rezultoi se është tejkaluar struktura e miratuar duke rritur shpenzimet mujore për shoqërinë në këto 3 muaj në shumën 16,315,492 lekë, shumë e cila përbën efekt financiar negativ për buxhetin e shoqërisë (*Trajtuar më hollësisht në pikën 3, të Raportit Përfundimtar*).

#### **Rekomandimi:**

Nga Administratori i Shoqërisë Albpetrol SHA, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Programimit të merren masat e duhura që, në të ardhmen të respektohet numri i fuqisë punëtore në punë në përputhje me strukturën e miratuar dhe legjislacionin në fuqi, duke synuar një përdorim të fondeve publike me ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet.

**Menjëherë dhe në vazhdimësi.**

#### **10. Gjetje nga auditimi:**

Për periudhën nga data 01.01.2017 deri më datë 31.07.2018, kanë përfutur shpërblim punonjës të drejtorisë së prokurimit në shumën 10,000 lekë secili për 4 punonjës, të cilat janë dhënë në zbatim të vendimit nr. 402, datë 25.10.2007 të administratorit të shoqërisë z.Y. Gj., në keqinterpretim të VKM nr. 476, datë 18.07.2007 "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 371, datë 14.6.2006 të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve të disa institucioneve, në varësi të Këshillit të Ministrave/Kryeministrit", veprim në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar e kontrollin", neni 8, Përgjegjshmëria menaxheriale", mbi bazën e të cilit janë paguar këta punonjës duke i shkaktuar buxhetit të shoqërisë për periudhën objekt auditimi një efekt financiar në shumën 570,000 lekë (*Trajtuar më hollësisht në pikën 3, të Raportit Përfundimtar*).

#### **Rekomandimi:**

Këshilli Mbikëqyrës i Albpetrol SHA të analizojë vendimin e dhënë nga ish-administratori për përfitimet e shpërblimeve të dhëna në shumën 570,000 lekë ndaj punonjësve të drejtorisë së prokurimeve, gjithashtu të merren masat që në të ardhmen të mos jepen pagesa dhe shpërblime të cilat bien në kundërshtim me Legjislacionin në fuqi.

**Menjëherë.**

### **11. Gjetje nga auditimi:**

Nga shqyrtimi i hartimit dhe realizimit të programit të vitit 2017 u konstatua se në pjesën më të madhe këto programe nuk argumentonin me shpjegime dhe llogaritje të kontrollueshme shpenzimet e paraqitura si dhe sasitë e programuara të naftës nuk kishin analiza të plota, të përditësuara dhe të detajuara. Në pjesën e dytë të vitit, në relacionin për ndryshime në programin ekonomik drejtuar Këshillit Mbikëqyrës, nuk është argumentuar ulja e prodhimit dhe është kërkuar që të ulet sasia në programin vjetor.

-Programimi me rezerva, jo i argumentuar dhe i pa bazuar në llogaritje të kontrollueshme e të besueshme ka sjellë që të dhënat financiare-teknike që merr drejtimi i shoqërisë për vendim-marrje, të mos favorizojnë shfrytëzimin maksimal të kapaciteteve të Albpetrol, si dhe mungesën e evidentimit të përgjegjësive konkrete për mos realizimin e të ardhurave në prodhimin e naftës në sasinë 12,742 ton, me vlerë rreth 363,147,000 lekë.

Për sa më sipër mban përgjegjësi ish administratori i shoqërisë z.E.P. dhe drejtori i drejtorisë së programimit z. B.L. *(Trajtuar më hollësisht në pikën 4, të Raportit Përfundimtar).*

### **Rekomandimi:**

Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe administratori i shoqërisë të merren masat e menjëhershme për analizën dhe nxjerrjen e përgjegjësive për mos realizimin e të ardhurave në prodhimin e naftës në sasinë 12,742 ton, me vlerë rreth 363,147,000 lekë.

**Menjëherë.**

### **12. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Blerje transformator fuqie”, për vitin 2017, me fond limit në shumën 9,270,000 lekë pa TVSH, ku kanë marrë pjesë 3 OE, nga komisioni i vlerësimit të ofertave është kryer një vlerësim i padrejtë. Kjo pasi nga pjesëmarrja e 3 operatorëve ekonomikë “E”, me ofertë ekonomike 8,220,000 lekë, “N Shpk”, me ofertë ekonomike 9,075,000 lekë dhe “S Shpk”, me ofertë ekonomike 8,890,000 gjatë vlerësimit të operatorëve ekonomikë rezulton se edhe OE “N. Shpk” nuk ka përmbushur kërkesën teknike për përcaktimin e tipit të bobinës, dhe nuk ka paraqitur kriterin për temperaturën e punës së transformatorit. KVO nuk duhet ta kishte kualifikuar OE “N. Shpk”, pasi nuk ka plotësuar të njëjtat kushte si OE “E.” shpk, dhe kjo procedurë duhet të anulohet. Në këtë rast, nëse do të trajtonte në mënyrë të barabartë duke patur të njëjtën konsideratë midis operatorëve, mund të kualifikonte OE “E.” shpk, me ofertë ekonomike 8,220,000 lekë. Gjithashtu në raportin përmbledhës nuk janë përcaktuar të gjithë elementët e tij, duke vepruar në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1, dhe me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 68. Nga ky vlerësim jo i drejtë diferenca midis OE të shpallur fitues me OE të s’kualifikuar është 1,026,000 lekë me TVSH e cila konsiderohet si efekt financiar negativ për buxhetin e shoqërisë *(Trajtuar më hollësisht në pikën 7, të Raportit Përfundimtar).*

### **Rekomandimi**

Nga Administratori i shoqërisë, si dhe Këshilli Mbikëqyrës i Albpetrol SHA, të merren masa për të analizuar shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorim me efektivitet dhe ekonomikitet të fondeve publike në vlerën prej 1,026,000 lekë, vlerë e cila ka të bëjë me shkeljet e konstatuara në procedurën e prokurimit të zhvilluar me objekt: “Blerje transformator fuqie”, si dhe të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, në mënyrë që të parandalohen raste të tilla në të ardhmen.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

### **13. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Blerje çakull dhe stabilizant”, me fond limit 14,812,500 lekë pa TVSH, datë zhvillimi tenderi 12.06.2017, sipas Urdhërit të Prokurimit të titullarit të autoritetit kontraktor nr. 3329 Prot., datë 11.05.2017, është konstatuar efekt negativ financiar në vlerën 6,523,800 lekë. Kjo vlerë ka ardhur si rezultat i përlllogaritjes gabim të vlerës së fondit limit, në kundërshtim kjo me nenin 28 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 59 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe VKM Nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”, ku personat përgjegjës janë sqaruar hollësisht në material *(Trajtuar më hollësisht në pikën 7, të Raportit Përfundimtar)*.

### **Rekomandimi:**

Nga Administratori i shoqërisë, si dhe Këshilli Mbikëqyrës i Albpetrol SHA, të merren masa për të analizuar shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorim me efektivitet dhe ekonomicitet të fondeve publike në vlerën prej 6,523,800 lekë, vlerë e cila ka të bëjë me shkeljet e konstatuara në procedurën e prokurimit të zhvilluar me objekt: “Blerje çakull dhe stabilizant”, si dhe të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse ligjore ndaj personave përgjegjës. Titullari i AK, ka detyrimin ligjor të ngrejë një grup pune të veçantë, si dhe të bëjë evidentimin e të gjithë personave përgjegjës, të cilët kanë bërë përlllogaritjen e vlerës së fondit limit.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

### **14. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Blerje veshmbathje për punonjësit”, me fond limit 36,658,607 lekë pa TVSH, datë zhvillimi tenderi 21.07.2017, sipas Urdhërit të Prokurimit të titullarit të autoritetit kontraktor nr. 4375 Prot., datë 27.06.2017, për kontratën nr. 4375/13 Prot., datë 13.10.2017 me vlerë 41,795,160 lekë me TVSH, është konstatuar efekt negativ financiar në vlerën 2,195,168 lekë, si rezultat i përlllogaritjes gabim të vlerës së fondit limit, në kundërshtim kjo me LPP, duke patur parasysh edhe uljen e ofertës fituese nga vlera e fondi limit *(Trajtuar më hollësisht në pikën 7, të Raportit Përfundimtar)*.

### **Rekomandimi**

Nga Administratori i shoqërisë, si dhe Këshilli Mbikëqyrës i Albpetrol SHA, të merren masa për të analizuar shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorim me efektivitet dhe ekonomicitet të fondeve publike në vlerën prej 2,195,168 lekë, vlerë e cila ka të bëjë me shkeljet e konstatuara në procedurën e prokurimit të zhvilluar me objekt: “Blerje veshmbathje për punonjësit”, si dhe të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse ligjore, në mënyrë që të parandalohen raste të tilla në të ardhmen.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

### **15. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi i listëpagesave të muajve mars-korrik 2018 rezultoi se, për vitin 2018 janë paguar dieta për trajtim ushqimor për të gjithë punonjësit në masën 500 lekë ndërkohë që me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 68, datë 7.2.2018 “Për kufijtë dhe kriteret e përcaktimit të shpërblimit që i përgjigjet pagës së përfitur në natyrë dhe që i shtohet pagës për pushimet vjetore”, pika 2, gërma a), kjo dietë është caktuar në masën 300 lekë. Në mënyrë të llogaritur nga listëpagesat e muajve të sipërpërmendur ky përfitim është në shumën është 47,761,367 lekë e cila përbën efekt financiar negativ për buxhetin e shoqërisë *(Trajtuar më hollësisht në pikën 3, të Raportit Përfundimtar)*.



**Rekomandimi:**

Administratori i Shoqërisë, Drejtoria e Financës të merren masat e duhura për ndryshimin e kontratës kolektive, dhe të nxjerrë urdhërin përkatës për mosvazhdimin e kësaj pagese më tepër nga vlera e përcaktuar në aktet ligjore.

**Menjëherë**

**16. Gjetje nga auditimi:**

Për periudhën nga data 01.01.2017 deri më datë 31.07.2018, kanë përfituar shpërblim si anëtarë të grupit të punës për përgatitjen e formatit të revistës “Nafta Shqiptare”, 6 punonjës në shumën totale 240,000 lekë. Këto pagesa janë përfituar padrejtësisht, pa asnjë bazë ligjore dhe të pa justifikuar, në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar e kontrollin”, neni 8, Përgjegjshmëria menaxheriale”, duke i krijuar buxhetit të shoqërisë efekt financiar negativ në shumë prej 240,000 lekë (*Trajtuar më hollësisht në pikën 3, të Raportit Përfundimtar*).

**Rekomandimi:**

Nga administratori i Shoqërisë Albpétrol SHA, të merren vendimet përkatëse ligjore ndaj personave përgjegjës, në mënyrë që të parandalohen raste të tilla në të ardhmen. Këto botime vleresohen të rëndësishme dhe duhet që në të ardhmen mbështeten në korpus të plotë vendimmarrës.

**Menjëherë**

**17. Gjetje nga auditimi:**

Me transksionin në BKT datë 09.05.2017, është paguar B. T. për faturën nr. 51, datë 28.04.2017, për shërbimin “Dreke pune”, në shumën 25,560 lekë. Kjo pagesë është kryer pas asnjë dokumentacion justifikues, në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, të datës 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2012, “Menaxhimi i aktiveve të njësitë e sektorit publik”, dhe shuma prej 25,560 lekë përbën efekt financiar për buxhetin e shoqërisë (*Trajtuar më hollësisht në pikën 6, të Raportit Përfundimtar*).

**Rekomandimi:**

Nga administratori i Shoqërisë Albpétrol SHA, të merren vendimet përkatëse ligjore ndaj personave përgjegjës, në mënyrë që të parandalohen raste të tilla në të ardhmen.

**Menjëherë**

**18. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Shërbimi i remonteve kapitale të puseve”, me fond limit 99,986,400 lekë pa TVSH për të dy lotet, datë zhvillimi tenderi 10.04.2017, sipas Urdhërit të Prokurimit të titullarit të autoritetit kontraktor nr. 312 Prot., datë 07.03.2017, për kontratën nr. 312/16 Prot., datë 25.07.2017 me vlerë 54,033,360 lekë me TVSH (për lotin 2), është konstatuar se, vlera prej 14,035,738 lekë përbën një shpenzim të paargumentuar ndaj buxhetit të kompanisë Albpétrol SHA. Kjo vlerë ka ardhur si rezultat i pagesës për zëra të cilët nuk janë parashikuar në kontratë, në kundërshtim kjo me kushtet e kontratës, termat e referencës dhe specifikimet teknike, si dhe me nenin 60 të LPP, ku personi përfitues është kontraktori (*Trajtuar më hollësisht në pikën 7, të Raportit Përfundimtar*).

**Rekomandimi:**

Nga Administratori i shoqërisë, si dhe Këshilli Mbikëqyrës i Albpétrol SHA, të merren masa për të analizuar shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorim me efektivitet dhe ekonomikitet të fondeve publike në vlerën prej 14,035,738 lekë, si rrjedhojë e pagesës për

zëra të cilët nuk janë parashikuar në kontratë, si dhe nuk provohet se janë kryer prej tij, si dhe të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse ligjore.

**Menjëherë**

## **D. MASA DISIPLINORE**

**D.1.** Mbështetur në Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës të Shqipërisë”, i ndryshuar, në “Rregulloren e Brendshme të Shoqërisë” nr. 1357, datë 22.04.2013 si dhe në “Kontratës Individuale të punës” miratuar me vendimin nr. 31, datë 13.06.2014 “Për unifikimin e kontratave Individuale të Punës”, Administratori i shoqërisë të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore nga:

**“Ulje në detyrë” deri në “Largim nga detyra”,** të cilat duhet të jenë në raport me shkeljet e kryera, për personat si më poshtë:

**1. Për z.S.K.,** me detyrë drejtor i Drejtorisë së Pronave, pasi:

-Veprimet për ndryshimin e të dhënave të programimit pa u bazuar në argumentime e llogaritje të kontrollueshme e të besueshme tregojnë se projekt-programet nuk janë kryer në studime dhe reflektime reale por kryhen në mënyrë sipërfaqësore.

-Nga shqyrtimi i projekt-programeve të dërguar nga qendrat e prodhimit u konstatua në pjesën më të madhe këto programe nuk argumentonin me shpjegime dhe llogaritje të kontrollueshme shpenzimet që kërkonin. Në pjesën më të madhe të projekt-programeve ishin paraqitur tabela me sasi të hekurit, saraçineskave, tubave, llamarina, profile hekuri, materiale të tjera si dhe shpenzime për riparime pa pasur detajet se çfarë do të bëhej me këto materiale si dhe cilat objekte do të riparoheshin, si dhe pa situacionet përkatëse.

-Programimi me rezerva, jo i argumentuar dhe i pa bazuar në llogaritje të kontrollueshme e të besueshme ka sjellë që të dhënat financiare-teknike që merr drejtimi i shoqërisë për vendim-marrje, të mos favorizojnë shfrytëzimin maksimal të kapaciteteve të Albpetrol, si dhe mungesën e evidentimit të përgjegjësive konkrete për mos realizimin e të ardhurave në prodhimin e naftës në sasinë 12,742 ton, me vlerë rreth 363,147,000 lekë.

-Ka vepruar në kundërshtim të plotë me legjislacionin në fuqi, lidhur me objektet të cilat shoqëria Albpetrol ka lënë me qira, si dhe nuk ka kryer asnjë verifikim mbi këto prona, sqaruar hollësisht në raport.

**2. Për z. D.S.,** me detyrë Drejtor në Drejtorinë e Marrëveshjeve Hidrokarbure pasi:

-Veprimet për ndryshimin e të dhënave të programimit pa u bazuar në argumentime e llogaritje të kontrollueshme e të besueshme, tregojnë se projekt-programet nuk janë kryer në studime dhe reflektime reale, por kryhen në mënyrë sipërfaqësore.

-Nga shqyrtimi i projekt-programeve të dërguar nga qendrat e prodhimit u konstatua në pjesën më të madhe se këto programe, nuk argumentonin me shpjegime dhe llogaritje të kontrollueshme shpenzimet që kërkonin. Në pjesën më të madhe të projekt-programeve ishin paraqitur tabela me sasi të hekurit, saraçineskave, tubave, llamarina, profile hekuri, materiale të tjera si dhe shpenzime për riparime pa pasur detajet se çfarë do të bëhej me këto materiale si dhe cilat objekte do të riparoheshin, si dhe pa situacionet përkatëse.

-Programimi me rezerva, jo i argumentuar dhe i pa bazuar në llogaritje të kontrollueshme e të besueshme ka sjellë që të dhënat financiare-teknike që merr drejtimi i shoqërisë për vendim-marrje, të mos favorizojnë shfrytëzimin maksimal të kapaciteteve të Albpetrol, si dhe mungesën e evidentimit të përgjegjësive konkrete për mos realizimin e të ardhurave në prodhimin e naftës në sasinë 12,742 ton, me vlerë rreth 363,147,000 lekë.

-Shoqëria ka paraqitur në zërin të drejta të arkëtueshme, në pasqyrën e pozicionit financiar më datë 31.12.2016 vlerën 3,348,670,119 lekë dhe më datë 31.12.2017 vlerën 2,497,785,582 lekë. Këto vlera përfaqësojnë vlerën përkatëse të sasisë së produktit, që është llogaritur sipas parashikimeve të kontratave hidrokarbure, por që nuk është lëvruar fizikisht në depozitat e Albpetrolit. Drejtimi i shoqërisë është justifikuar se për arsye të mos-pasjes të kapaciteteve magazinuese ose arsye të marrëdhënieve me shoqëritë kontraktore nuk është bërë e mundur tërheqja e produktit nga të tretët. Drejtimi i shoqërisë në këtë situatë duhet të merrte masat për shitjen e të gjithë produktit që është detyruar ta magazinon në shoqëritë kontraktore përkatëse. Si pasojë e këtyre veprimeve apo mosveprimeve nuk kanë hyrë të ardhura nga shitja e naftës bruto në llogaritë e Albpetrol SHA. Bazuar në ligjin Nr.48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet Kontraktore e tregtare" Neni 5, si dhe sipas Buletinit Zyrtar të Bankës së Shqipërisë, për vitin 2016, norma mesatare e REPO-s, është 1.25 %, si dhe për vitin 2017 kjo normë ka ngelur e pa ndryshuar. Në kushtet kur ortakët i shoqërisë i ka miratuar pasqyrat financiare të periudhës ushtrimore 2016, në dhjetor 2017, dhe për pasojë nuk janë shqyrtuar nga auditimi i mëparshëm, kryhet dhe vlerësimi i vitit 2016. Për vitin 2016, vlera e të ardhurës së munguar të shoqërisë është 309,751,986 lekë dhe për vitin 2017, kjo vlerë është 231,045,166 lekë.

**D.2.** Mbështetur në Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës të Shqipërisë”, i ndryshuar, në “Rregulloren e Brendshme të Shoqërisë” nr. 1357, datë 22.04.2013 si dhe në “Kontratës Individuale të punës” miratuar me vendimin nr. 31, datë 13.06.2014 “Për unifikimin e kontratave Individuale të Punës”, Këshilli Mbikëqyrës të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore nga:

**“Vërejtje me paralajmërim” deri në “Largim nga detyra”,** të cilat duhet të jenë në raport me shkeljet e kryera, për personat si më poshtë:

**1. Për z. K.B. ,** në cilësinë administratorit të Shoqërisë Albpetrol SHA. pasi:

- Nuk ka marrë masat e duhura për zbatimin e rekomandimeve të KLSH të lëna nga auditimi i mëparshëm;
- Nuk ka marrë masat e duhura për zbatimin e VKM nr. 68, datë 7.2.2018 “Për kufijtë dhe kriteret e përcaktimit të shpërblimit që i përgjigjet pagës së përfituar në natyrë dhe që i shtohet pagës për pushimet vjetore”;
- Nuk ka marrë masat e duhura për përmbushjen e detyrimeve të cilat rrjedhin nga Ligji nr. 7598, datë 01.09.1992 “Për krijimin e fondit të veçantë monetar për ish-të dënuarit e të përndjekurit politikë” dhe VKM nr. 392, datë 12.08.1999 “Për administrimin e fondit të veçantë monetar;
- Ka vepruar në kundërshtim të plotë me legjislacionin e prokurimit publik, për sa është trajtuar hollësisht në raportin përfundimtar të auditimit;
- Ka nënshkruar kontrata qiraje në kundërshtim me ligjin, pasi qiramarrësi shfrytëzon sipërfaqe më të mëdha se sa palët kanë rënë dakord në kontratë.
- Ka miratuar raporte përmbledhëse në kundërshtim me parashimet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

**D.3** Mbështetur në Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës të Shqipërisë”, i ndryshuar, në “Rregulloren e Brendshme të Shoqërisë” nr. 1357, datë 22.04.2013 si dhe në “Kontratës Individuale të punës” miratuar me vendimin nr. 31, datë 13.06.2014 “Për unifikimin e kontratave Individuale të Punës”, Administratori i Shoqërisë të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore nga:

“Vërejtje me shkrim”, “Ulje në detyrë” deri në “Largim nga detyra”, të cilat duhet të jenë në raport me shkeljet e kryera, për personat si më poshtë:

**1. Për z. A. B.** me detyrë me detyrë Drejtor i drejtorisë Juridike, në Shoqërinë Albpetrol SHA. pasi:

- Nuk ka marrë masat e duhura për zbatimin e VKM nr. 68, datë 7.2.2018 “Për kufijtë dhe kriteret e përcaktimit të shpërblimit që i përgjigjet pagës së përfutur në natyrë dhe që i shtohet pagës për pushimet vjetore” dhe implementimin e saj, në përmbushje të detyrave funksionale të tij, si dhe ka vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për pokurimin publik”, i ndryshuar, lidhur me procedurat e prokurimit, për sa është trajtuar hollësisht në raport.

**2. Për znj. ZH.N.**, me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Financës, pasi:

-Për vlerësimin e produktit të gatshëm gjendje në fund të vitit, nga hartuesit e pasqyrave financiare në zbatimin e SNK nr.2, nuk është përdorur çmimi mesatar i realizuar i vitit 2017, por vlera të ndryshme për kontraktorë të ndryshëm. Kjo metodë vlerësimi është e ndryshme nga viti ushtrimor 2016, si dhe ka sjellë një diferencë në rritje të vlerës së produktit të gatshëm me 143,000,000 lekë, si dhe të rezultatit financiar të shoqërisë.

-Zëri të drejta ndaj sigurimeve shoqërore në vlerën 116,255,571 lekë është i mbartur si vlerë kontabël nga bashkime që ka bërë shoqëria në vite dhe nuk përfaqëson një te drejtë reale.

-Ka vepruar në shkelje të legjislacionit të prokurimit publik, për sa është trajtuar hollësisht në raport.

-Shoqëria nuk ka marrë masa për kalimin në rezultatin financiar të vitit duke e kaluar në humbje.

**3. Për z. A.V.**, me detyrë Drejtor i Burimeve Njerëzore, pasi:

-Shoqëria “Albpetrol” sha., në kundërshtim me nenin nr.8, të VKM nr. 4, datë 19.06.2017, “Për miratimin e Rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë”, nuk ka kryer përpunimin tekniko-shkencor të dokumenteve të prapambetura, si përcaktimin e përkatësisë së fondit dhe klasifikimin e dokumenteve sipas fondit.

- Në kundërshtim me nenin nr.9, të VKM nr. 4, datë 19.06.2017, nuk është kryer ekspertiza e vlerës së ruajtjes.

- Në kundërshtim me nenin nr.10, të VKM nr. 4, datë 19.06.2017, nuk është kryer ruajtja e dokumenteve në përputhje me normativat.

- Në kundërshtim me nenin nr.11, të VKM nr. 4, datë 19.06.2017, nuk është kryer ruajtja e dokumenteve në përputhje me normativat lidhur me temperaturën e ambientit dhe lagështirën.

**4. Për z.E.M.**, me detyrë ish drejtor në Q.A.SH.N.G. Patos, pasi:

-Veprimet për ndryshimin e të dhënave të programimit pa u bazuar në argumentime e llogaritje të kontrollueshme e të besueshme tregojnë se projekt-programet nuk janë kryer në studime dhe reflektime reale por kryhen në mënyrë sipërfaqësore.

-Nga shqyrtimi i projekt-programeve të dërguar nga qendrat e prodhimit u konstatua në pjesën më të madhe këto programe nuk argumentonin me shpjegime dhe llogaritje të kontrollueshme shpenzimet që kërkonin. Në pjesën më të madhe të projekt-programeve ishin paraqitur tabela me sasi të hekurit, saraçineskave, tubave, llamarina, profile hekurit, materiale të tjera si dhe shpenzime për riparime pa pasur detajet se çfarë do të bëhej me këto materiale si dhe cilat objekte do të riparoheshin, si dhe pa situacionet përkatëse.

Programimi me rezerva, jo i argumentuar dhe i pa bazuar në llogaritje të kontrollueshme e të besueshme ka sjellë që të dhënat financiare-teknike që merr drejtimi i shoqërisë për vendim-marrje, të mos favorizojnë shfrytëzimin maksimal të kapaciteteve të Albpetrol, si dhe mungesën e evidentimit të përgjegjësive konkrete për mos realizimin e të ardhurave në prodhimin e naftës në sasinë 12,742 ton, me vlerë rreth 363,147,000 lekë.

Për shkelje të konstatuara në procedurat e prokurimit publik dhe pronat, në kundërshtim me LPP, sqaruar hollësisht në raport.

**5. Për z.E.M.,** me detyrë ish drejtor në Q.P.N., Patos, pasi:

-Veprimet për ndryshimin e të dhënave të programimit pa u bazuar në argumentime e llogaritje të kontrollueshme e të besueshme tregojnë se projekt-programet nuk janë kryer në studime dhe reflektime reale por kryhen në mënyrë sipërfaqësore.

-Nga shqyrtimi i projekt-programeve të dërguar nga qendrat e prodhimit u konstatua në pjesën më të madhe këto programe nuk argumentonin me shpjegime dhe llogaritje të kontrollueshme shpenzimet që kërkonin. Në pjesën më të madhe të projekt-programeve ishin paraqitur tabela me sasi të hekurit, saraçineskave, tubave, llamarina, profile hekuri, materiale të tjera si dhe shpenzime për riparime pa pasur detajet se çfarë do të bëhej me këto materiale si dhe cilat objekte do të riparoheshin, si dhe pa situacionet përkatëse.

Programimi me rezerva, jo i argumentuar dhe i pa bazuar në llogaritje të kontrollueshme e të besueshme ka sjellë që të dhënat financiare-teknike që merr drejtimi i shoqërisë për vendim-marrje, të mos favorizojnë shfrytëzimin maksimal të kapaciteteve të Albpetrol, si dhe mungesën e evidentimit të përgjegjësive konkrete për mos realizimin e të ardhurave në prodhimin e naftës në sasinë 12,742 ton, me vlerë rreth 363,147,000 lekë.

**6. Për z.E.SH.,** me detyrë ish drejtor në Q.F.M.T., Patos, pasi:

-Veprimet për ndryshimin e të dhënave të programimit pa u bazuar në argumentime e llogaritje të kontrollueshme e të besueshme tregojnë se projekt-programet nuk janë kryer në studime dhe reflektime reale por kryhen në mënyrë sipërfaqësore.

-Nga shqyrtimi i projekt-programeve të dërguar nga qendrat e prodhimit u konstatua në pjesën më të madhe këto programe nuk argumentonin me shpjegime dhe llogaritje të kontrollueshme shpenzimet që kërkonin. Në pjesën më të madhe të projekt-programeve ishin paraqitur tabela me sasi të hekurit, saraçineskave, tubave, llamarina, profile hekuri, materiale të tjera si dhe shpenzime për riparime pa pasur detajet se çfarë do të bëhej me këto materiale si dhe cilat objekte do të riparoheshin, si dhe pa situacionet përkatëse.

Programimi me rezerva, jo i argumentuar dhe i pa bazuar në llogaritje të kontrollueshme e të besueshme ka sjellë që të dhënat financiare-teknike që merr drejtimi i shoqërisë për vendim-marrje, të mos favorizojnë shfrytëzimin maksimal të kapaciteteve të Albpetrol, si dhe mungesën e evidentimit të përgjegjësive konkrete për mos realizimin e të ardhurave në prodhimin e naftës në sasinë 12,742 ton, me vlerë rreth 363,147,000 lekë, si dhe për shkelje të konstatuara në dhënien e pronave me qira.

**7. Për z.P. D.,** me detyrë anëtar i komisionit të shitjes, pasi:

-Albpetrol SHA gjatë vitit 2016-2017 i ka shitur produktin hidrokarbur, naftë bruto shoqërisë P. R. O. SHA, bazuar në kontratën me nr. 7805/15, datë 17.12.2016.

Lidhur me pagesat e kryera në shoqërinë Albpetrol SHA, u konstatua se kontraktuesi përveç një periudhe 1 javore në janar 2017, nuk e ka zbatuar asnjëherë kushtin e kontratës për pagesën e detyrimit paradhënie përpara lëvrimit të sasive të naftës. Theksojmë se kontraktuesi e kishte tërhequr të gjithë sasinë e kontraktuar brenda muajit të nëntë, pra me faturën e fundit nr. 150, datë 14.09.2017, ishte lëvruar sasia prej 170,344 ton naftë dhe saldo debitore ndaj Albpetrol SHA ishte 434,000,000 lekë. Saldo debitore e shoqërisë deri më datën 19.10.2018 është rreth 25,000,000 lekë, pra dhe pas një viti shoqëria P. R. O. SHA, nuk ka shlyer akoma detyrimet ndaj Albpetrol SHA

Veprimet e grupit të punës për shitjen e naftës pa u kryer më parë pagesa janë në kundërshtim me nenin nr.5.1, të kontratës dhe kanë krijuar rrisht për likuiditetin e shoqërisë si dhe mungesë të lëvrimit të fondeve nga kontraktori.

Të gjitha sasi të shitura janë kryer me urdhëra të ish administratorit z.E.P. , duke caktuar grupin e punës nga drejtorja e shitjes.

**8. Për z.B. S.,** me detyrë anëtar i komisionit të shitjes, pasi:

-Albpetrol SHA gjatë vitit 2016-2017 i ka shitur produktin hidrokarbur, naftë bruto shoqërisë P. R. O.SHA, bazuar në kontratën me nr. 7805/15, datë 17.12.2016.

Lidhur me pagesat e kryera në shoqërinë Albpetrol SHA, u konstatua se kontraktuesi përveç një periudhe 1 javore në janar 2017, nuk e ka zbatuar asnjëherë kushtin e kontratës për pagesën e detyrimit paradhënie përpara lëvrimin të sasive të naftës. Theksojmë se kontraktuesi e kishte tërhequr të gjithë sasinë e kontraktuar brenda muajit të nëntë, pra me faturën e fundit nr. 150, datë 14.09.2017, ishte lëvruar sasia prej 170,344 ton naftë dhe saldo debitore ndaj Albpetrol SHA ishte 434,000,000 lekë. Saldo debitore e shoqërisë deri më datën 19.10.2018 është rreth 25,000,000 lekë, pra dhe pas një viti shoqëria P. R. O. SHA, nuk ka shlyer akoma detyrimet ndaj Albpetrol SHA.

Veprimet e grupit të punës për shitjen e naftës pa u kryer më parë pagesa janë në kundërshtim me nenin nr.5.1, të kontratës dhe kanë krijuar rrisht për likuiditetin e shoqërisë si dhe mungesë të lëvrimin të fondeve nga kontraktori.

Të gjitha sasinë e shitura janë kryer me urdhëra të ish administratorit z.E.P. , duke caktuar grupin e punës nga drejtoria e shitjes.

**9. Për znj.E. V.**, me detyrë anëtare e komisionit të shitjes, pasi:

-Albpetrol SHA gjatë vitit 2016-2017 i ka shitur produktin hidrokarbur, naftë bruto shoqërisë P. R. O. SHA, bazuar në kontratën me nr. 7805/15, datë 17.12.2016.

Lidhur me pagesat e kryera në shoqërinë Albpetrol SHA, u konstatua se kontraktuesi përveç një periudhe 1 javore në janar 2017, nuk e ka zbatuar asnjëherë kushtin e kontratës për pagesën e detyrimit paradhënie përpara lëvrimin të sasive të naftës. Theksojmë se kontraktuesi e kishte tërhequr të gjithë sasinë e kontraktuar brenda muajit të nëntë, pra me faturën e fundit nr. 150, datë 14.09.2017, ishte lëvruar sasia prej 170,344 ton naftë dhe saldo debitore ndaj Albpetrol SHA ishte 434,000,000 lekë. Saldo debitore e shoqërisë deri më datën 19.10.2018 është rreth 25,000,000 lekë, pra dhe pas një viti shoqëria P. R. O. SHA, nuk ka shlyer akoma detyrimet ndaj Albpetrol SHA

Veprimet e grupit të punës për shitjen e naftës pa u kryer më parë pagesa janë në kundërshtim me nenin nr.5.1, të kontratës dhe kanë krijuar rrisht për likuiditetin e shoqërisë si dhe mungesë të lëvrimin të fondeve nga kontraktori.

Të gjitha sasinë e shitura janë kryer me urdhëra të ish administratorit z.E.P. , duke caktuar grupin e punës nga drejtoria e shitjes.

**10. Për Znj. L. M.**, me detyrë anëtare e njësisë së prokurimit, për arsye se:

-Ka vepruar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik, në cilësinë e anëtares së njësisë së prokurimit, ka hartuar kërkesa për kualifikim në kundërshtim me ligjin, si dhe nuk ka argumentuar dhe dokumentuar në një rast, përdorimin e procedurës me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës.

**11. Për Z. A. B.**, me detyrë anëtar i njësisë së prokurimit, për arsye se:

-Ka vepruar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik, në cilësinë e anëtares së njësisë së prokurimit, ka hartuar kërkesa për kualifikim në kundërshtim me ligjin, si dhe nuk ka argumentuar dhe dokumentuar në një rast, përdorimin e procedurës me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës.

**12. Për Z. B. Q.**, me detyrë anëtar i njësisë së prokurimit dhe përllogaritjes së vlerës së fondit limit, për arsye se:

-Ka vepruar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik, në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit, ka hartuar kërkesa për kualifikim në kundërshtim me ligjin, si dhe nuk ka argumentuar dhe dokumentuar në një rast, përdorimin e procedurës me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës. Gjithashtu, ka vepruar në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, lidhur me përllogaritjen e vlerës së fondit limit.

**13. Për Z. Sh. Xh.**, me detyrë anëtar i komisionit të vlerësimit të ofertave, pasi:

-Ka vepruar në kundërshtim të plotë me nenin 53/3 të LPP, lidhur me vlerësimin e ofertave pjesëmarrëse, si dhe ka kualifikuar në kundërshtim me LPP, operatorët ekonomikë pjesëmarrës.

**14. Për Z. E. L.,** me detyrë anëtar i komisionit të vlerësimit të ofertave, pasi:

-Ka vepruar në kundërshtim të plotë me nenin 53/3 të LPP, lidhur me vlerësimin e ofertave pjesëmarrëse, si dhe ka kualifikuar në kundërshtim me LPP, operatorët ekonomikë pjesëmarrës.

**15. Për Z. E. A.,** me detyrë anëtar i komisionit të vlerësimit të ofertave, pasi:

-Ka vepruar në kundërshtim të plotë me nenin 53/3 të LPP, lidhur me vlerësimin e ofertave pjesëmarrëse, si dhe ka kualifikuar në kundërshtim me LPP, operatorët ekonomikë pjesëmarrës.

**D.4.** Mbështetur në Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës të Shqipërisë”, i ndryshuar, në “Rregulloren e Brendshme të Shoqërisë” nr. 1357, datë 22.04.2013 si dhe në “Kontratës Individuale të punës” miratuar me vendimin nr. 31, datë 13.06.2014 “Për unifikimin e kontratave Individuale të Punës”, Administratori i shoqërisë të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore nga:

*“Vërejtje me shkrim” deri në “Ulje nga detyra”, të cilat duhet të jenë në raport me shkeljet e kryera, për personat si më poshtë:*

**1. Për z. N.N.,** me detyrë drejtor në drejtorinë e shërbimeve pasi:

-Nga shqyrtimi i projekt-programeve të dërguar nga qendrat e prodhimit u konstatua në pjesën më të madhe këto programe nuk argumentonin me shpjegime dhe llogaritje të kontrollueshme shpenzimet që kërkonin.

-Programimi me rezerva, jo i argumentuar dhe i pa bazuar në llogaritje të kontrollueshme e të besueshme ka sjellë që të dhënat financiare-teknike që merr drejtimi i shoqërisë për vendim-marrje, të mos favorizojnë shfrytëzimin maksimal të kapaciteteve të Albpetrol, si dhe mungesën e evidentimit të përgjegjësive konkrete për mos realizimin e të ardhurave në prodhimin e naftës në sasinë 12,742 ton, me vlerë rreth 363,147,000 lekë.

**2. Për z. B. L.,** me detyrë drejtor drejtorie në pasi:

-Veprimet për ndryshimin e të dhënave të programimit pa u bazuar në argumentime e llogaritje të kontrollueshme e të besueshme tregojnë se projekt-programet nuk janë kryer në studime dhe reflektime reale por kryhen në mënyrë sipërfaqësore.

-Nga shqyrtimi i projekt-programeve të dërguar nga qendrat e prodhimit u konstatua në pjesën më të madhe këto programe nuk argumentonin me shpjegime dhe llogaritje të kontrollueshme shpenzimet që kërkonin.

**3. Për znj. A. S.,** me detyrë Drejtore e Drejtorisë së Shitjeve dhe anëtare e komisionit të shitjes, pasi:

-Albpetrol SHA gjatë vitit 2016-2017 i ka shitur produktin hidrokarbur, naftë bruto shoqërisë P. R. O. SHA, bazuar në kontratën me nr. 7805/15, datë 17.12.2016.

Lidhur me pagesat e kryera në shoqërinë Albpetrol SHA, u konstatua se kontraktuesi përveç një periudhe 1 javore në janar 2017, nuk e ka zbatuar asnjëherë kushtin e kontratës për pagesën e detyrimit paradhënie përpara lëvrimin të sasive të naftës. Theksojmë se kontraktuesi e kishte tërhequr të gjithë sasinë e kontraktuar brenda muajit të nëntë, pra me faturën e fundit nr. 150, datë 14.09.2017, ishte lëvruar sasia prej 170,344 ton naftë dhe saldo debitore ndaj Albpetrol SHA ishte 434,000,000 lekë. Saldo debitore e shoqërisë deri më datën

19.10.2018 është rreth 25,000,000 lekë, pra dhe pas një viti shoqëria P. R. O. SHA, nuk ka shlyer akoma detyrimet ndaj Albpetrol SHA.

Veprimet e grupit të punës për shitjen e naftës pa u kryer më parë pagesa, janë në kundërshtim me nenin nr.5.1, të kontratës dhe kanë krijuar rrisht për likuiditetin e shoqërisë si dhe mungesë të lëvrimin të fondeve nga kontraktori.

Të gjitha sasisht e shitura janë kryer me urdhëra të ish administratorit z.E.P. , duke caktuar grupin e punës nga drejtoria e shitjes.

#### **D.5. MASA DISIPLINORE PËR PUNONJËSIT E LARGUAR.**

Për ish punonjësit e mëposhtëm, nuk rekomandojmë masë disiplinore edhe sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personi nuk është në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimin e tyre.

Nga ana jonë, në bazë të shkeljeve të konstatuara, masa disiplinore do të ishte **“Largim nga puna”**, përkatësisht:

1. **Z.E.P.** , në cilësinë e ish Administratorit të shoqërisë.
2. **Z. F. G.**, në cilësinë e ish Administratorit të komanduar të shoqërisë.
3. **Z.Y. Gj.**, nw cilësinë e ish Adminsitratorit të shoqërisë.

Nga ana jonë, në bazë të shkeljeve të konstatuara, masa disiplinore do të ishte **nga “Vërejtje” deri në “Largim nga puna”**, përkatësisht:

1. **Z. P.B.**, në cilësinë e ish shefit të financës.
2. **Z. F. B.**, në cilësinë e ish drejtorit të prokurimeve.
3. **Znj. A. P.**, në cilësinë e ish specialistes së financës.
4. **Z. A.S.**, me detyrë ish drejtor në drejtorinë e programimit.
5. **Znj. M. L.**, me detyrë ish kryetare e njësisë së prokurimit.
6. **Z. G. N.**, në cilësinë e ish anëtarit të KVO.

#### **E. KËRKESË PËR VLERËSIME TË MËTEJSHME TË RAPORTIT TE AUDITIMIT**

1. Në vlerësim të Raportit Përfundimtar të Auditimit të kryer në shoqërinë Albpetrol SHA dhe Vendimit të Kryetarit të KLSH, të përcillet në prokurorinë e rrethit Gjyqësor Fier dhe për dijeni në Prokurorinë e Përgjithshme, për njohje, studim dhe analizim, për shkeljet penale në gjetjet e konstatuara në procedurat e ankandëve dhe zbatimin i tyre (B1), dhënien e aseteve me qira dhe zbatimin e kontratave në këto vite periudhe auditimi (B2), **si dhe në Marrëveshjet Hidrokarbure (B1 dhe B3) duke filluar që nga viti 2004, vit në të cilin është bërë ndryshimi në lidhje me përcakimin e përqindjeve të prodhimit midis shoqërisë Albpetrol SHA dhe Operatoreve Ekonomikë koncesionarë.**

2. Nisur nga problematikat dhe shkeljet e konstatuara në auditimin e kryer, i kërkojmë Ministrin të Infrastrukturës dhe Energjitikës ndjekjen e vlerësimin e mëtejshëm nga Këshilli Mbikëqyrës i Albpetrol SHA dhe/ose struktura e auditit të brendshëm të MIE në bashkëpunim edhe me ekspertë në fushën e hidrokarbureve, për shqyrtimin/analizën e gjetjeve të konstatuara nga KLSH dhe të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit për koston e shitjes së naftës bruto (ankandet) (B.1), dhënien me qira të aseteve të shoqërisë dhe



zbatimit të kontratave (B2), si dhe problematikën e trajtuar në marrëveshjet hidrokarbure (B.1 dhe B.3) duke filluar që nga viti 2004, vit në të cilin është bërë ndryshimi në lidhje me përcakimin e dhe përqindjeve të prodhimit midis shoqërisë Albpetrol SHA dhe Operatorëve Ekonomik koncesionare.

**Shënim 1:** Lidhur me ankesën nr.4985 prot, datë 12.06.2018, të subjektit Z & G SHPK, për mosmarrëveshjet në marrëdhëniet kontraktuale për shërbimin e transportit të punonjësve të T. LTD, në vendburimin G-K, i kërkojmë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjise, të kryejë shqyrtimin dhe vlerësimin e problematikës së ngritur dhe të marrë masat përkatëse.

**Shënim 2:** Vendimi dhe rekomandimet përcillen në Albpetrol SHA, Ministrit të MIE-së, Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier dhe Prokurorisë së Përgjithshme më datën 05.01.2019.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim, ngarkohet Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja.

**Bujar LESKAJ**

**K R Y E T A R**